

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE
NUMËR 372-373 • VITI 35 • NËNTOR - DHJETOR 2021 • R. EVVEL - R. AHIR - XH. ULA 1443 • ÇMIMI 1 €



Shënohet shtatëdhjetë vjetori i themelimit të Medresesë "Alauddin"



Republika e Kosovës - Presidentja

MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE



i jepet

Medresesë "Alauddin"


PËR KONTRIBUTIN E VEÇANTË PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS
DHE ROLIN E ÇMUAR NË FORCIMIN E VLERAVE NJERËZORE,
TOLERANCËS NDËRFETARE DHE NDËRTIMIN E SHOQËRISË
DEMOKRATIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Vjosa Osmani - Sadriu
Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 22.12.2021

Në këtë numër:

Dashuria e Allahut të Gjithëmëshirshëm për robërit e Tij	4
- Fati i Medresesë "Alauddin" vazhdimisht ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës	5
- Kjo është vepra e parë me karakter enciklopedik e botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës	9
- Ky libër është një model i suksesshëm i punës që mund të zbatohet në kërkimet shkencore gjithandej lidhur me këtë problematikë	11
- Veprimtaria gjysmëshekullore e revistës "Edukata Islame" ka kaluar nëpër sfida, ashtu siç ka qenë historia dhe fati i populli tonë	13
- "Edukata Islame" ishte shkollë në vete për formësimin e elitës dhe ajkës intelektuale fetare	15
Mehmet Akifi është poet e intelektual i dy popujve	17
Sabri Bajgora	
Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (7)	19
Dr. Ajni Sinani	
Pse nuk gjejmë në Kuran tregime për Muhamedin a.s.? 23	
Mr. Fatmir Hadri	
Roli i Pejgamberit a.s. në sigurimin e unitetit social	24
Mr. Driton Arifi	
Vakëflënësi dhe implikimi i të drejtave të trashëgimtarëve të tij	26
Emad Hamdeh	
Tradicionalizmi dhe selefizmi, debati rreth pluralizmit ligjor (2)	29
Prof. asoc. Fadil Maloku	
Gjuha e urrejtjes në jetën publike	34
Mihana Goga-Bekteshi	
Fëmija, stolia më e bukur e familjes	36
Dr. Selim Selimi	
Flamuri dhe himni shqiptar (2)	38
Adnan Shala	
Nocioni njeri te Hajj ibën Jakdhani dhe iluminizmi perëndimor	40
Msc. Njomza Sadriu	
Hulumtim rreth përmbajtjes kimike të kungullit – bimë shëruese nga mjekësia e Pejgamberit a.s.	43
Agron M. Rexhepi, Ph.D. M.D.	
Çrregullimet e peshës trupore	46
Xhamia Qendrore e Kembrixhit	49
Aktivitetet	50

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Dashuria e Allahut të Gjithëmëshirshëm për robërit e Tij



“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Shumë falës, Mëshirues i madh.”

(Ali Imran, 31)

Marrëdhënia Zot – njeri në Islam bazohet në dashurinë hyjnore, në mëshirën dhe mirësinë e Tij. Allahu i Madhëruar krijoi gjithçka nga dashuria, duke përfshirë edhe njeriun si krijesën më të rëndësishme. Krijimi i njeriut ishte një shprehje e dashurisë së Zotit. E krijoi njeriun në formën dhe pamjen më të përsosur dhe i fryu atij shpirtin. Kjo dashuri shprehet edhe në urdhrin që Zoti u dha engjëjve dhe xhinëve për t’i rënë në sexhde respekti Ademit a.s.

Shpallja e Kuranit, si dhe pajisja e njeriut me aftësinë e të folurit, është manifestim i kësaj dashurie e mëshire: “I Gjithëmëshirshmi, Ai ia mësoi Kuranin, e krijoi njeriun, ia mësoi atij të folurit (të shqiptuarit).” (Err Rrahman, 1-4).

Kurani tregon se Dashuria e Zotit është:

Për ata që e besojnë dhe nuk i bëjnë ortak Atij: “Pra ju më përmendni Mua (me adhurime), Unë ju përmend juve. Më falënderoni e mos më mohoni!” (El Bekareh, 152);

Për ata që e pasojnë të Dërguarin dhe mesazhin e tij: “Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Shumë falës, Mëshirues i madh.” (Ali Imran, 31);

Për ata që ruhen e janë të devotshëm. Singëriteti, që është thelbi i besimit, kërkon devotshmëri dhe ruajtje nga mëkatet: “... dhe ruhet nga mëkatet, s’ka dyshim, Allahu i do ata që ruhen.” (Ali Imran, 76);

Për ata që qëndrojnë të durueshëm përballë vështirësive: “... ata nuk u dobësuan nga ana morale, e as ajo fizike dhe as nuk u përulën. Allahu i do durimtarët.” (Ali Imran, 146)

Për ata që mbështeten tek Allahu xh.sh.: “... e kur të vendosësh, atëherë mbështetu tek Allahu, se Allahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran, 159);

Për ata që janë të ndershëm e të drejtë me të tjerët: “... nëse gjykon mes tyre, gjyko drejt; Allahu i do të drejtin.” (El-Maideh, 42);

Për ata që janë të pastër dhe e duan pastërtinë: “...Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.” (El Bekareh, 222)

Dashuria e Zotit përfitohet përmes veprave të mira në rrugën e Allahut: “Dhe jepni për në rrugë të Allahut e mos e hidhni veten në rrezik dhe bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do bamirësit.” (El Bekareh, 195); si edhe përmes ruajtjes së premtimit dhe sjelljes së vërtetshme: “Allahu i do ata, që e ruajnë besën.” (Et-Tevbeh, 7)

Afërsia e ngushtë e marrëdhënies Zot – njeri shprehet përmes përvojës fetare. Prandaj, lidhja jonë me Allahun nuk duhet të jetë nga frika, por nga dashuria. Le të ketë frikë-respekt, por dashuria duhet të dominojë: “O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes), s’ka dyshim se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin)...” (El- Maideh, 54). Këto ajete tregojnë qartë se dashuria e Allahut është për disa robër dhe nuk është për të tjerë. Ashtu sikurse qenia dhe cilësitë, edhe dashuria e Allahut xh.sh. i përket madhërisë dhe përkryeshmërisë së Tij.

Prej fryteve të dashurisë së Allahut tek robi i Tij është se njerëzit e duan dhe e pranojnë atë në tokë. Muhamedi a.s. ka thënë: “Kur Allahu e do robin, thërret Xhibrilin dhe i thotë: “O Xhibril, Unë e dua filanin, prandaj duaje dhe ti!” dhe e do edhe Xhibrili. Pastaj ai thërret: “O banorë të qiellit! Allahu e do filanin, prandaj duajeni dhe ju!” dhe e duan edhe banorët e qiellit. Më pas bëhet i pranueshëm (i dashur) në tokë.” (Buhariu).

Allahu i dhuron shumë mirësi dhe është mbrojtësi i atij që e do. Ebu Hurejre r.a. tregon se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Allahu i Madhërishtëm tha: Do t’i shpall luftë atij që më armiqëson një mik! Robi Im nuk më afrohet në mënyrë më të mirë, përpos duke i kryer farzet. Ai vazhdon të më afrohet edhe më tepër me anë të veprave vullnetare, derisa ta dua atë, e kur e dua atë, atëherë bëhem veshi me të cilin dëgjon, syri me të cilin sheh, dora me të cilën godet dhe këmba me të cilën ecën. Nëse ky rob kërkon diçka prej Meje, Unë do t’ia jap, nëse kërkon strehimin Tim, Unë do ta strehoj atë.” (Buhariu).

Allahu xh.sh. mund të na kërkonte ta duam dhe të mos fliste fare për dashurinë e Tij për ne. Por Allahu tregon se e Ai e do robin e Tij. Muhammedi a.s. ka thënë: “Allahu i Madhërishtëm thotë: E meritojnë t’i dua ata që duhen për Mua, ata që janë të lidhur mes tyre për Mua, ata që e vizitojnë njëri-tjetrin për Mua dhe ata që harxhojnë për njëri-tjetrin për Mua.” (Transmeton Ahmed).

Dr. Ajni Sinani

Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnavë me rastin e shtatëdhjetë vjetorit të Medresesë "Alauddin"

Fati i Medresesë "Alauddin" vazhdimisht ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës



I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti;

I nderuari ish-president i Republikës së Kosovës, z. Behxhet Pacolli;

I nderuari përfaqësues i presidentes së Kosovës, z. Bekim Kupina;

I nderuari drejtor i Medresesë, Fadil Hasani;

I nderuari ambasador i R. Turqisë, Çagri Sakar;

I nderuari përfaqësues i Ambasadës Amerikane, z. Dominik;

I nderuari kryetar i Prishtinës, z. Përparim Rama;

Përfaqësues së Ministrisë së Arsimit;

Të nderuar deputetë të Parlamentit të R. Kosovës;

Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të vendit;

Drejtuës të institucioneve të Bashkësisë Islame;

Të nderuar ish-drejtorë të Medresesë; Përhëndes me këtë rast edhe përfaqësuesit e gjeneratës së parë të Medresesë së Ultë.

Të nderuar profesorë, pedagogë dhe personel i Medresesë;

Të dashur nxënës

Të nderuar të pranishëm

Motra e vëllezër

Zoti xh.sh. në ajetin e parë kuranor thotë: "Lexo në emër të Zotit, i Cili krijoi çdo gjë".

I Dërguari ynë i fundit Muhamedi a.s. thotë: "Kërkimi i diturisë është obligim parësor i çdo myslimani dhe myslimaneje".

Jemi tubuar sonte këtu për të shënuar një përvjetor të rëndësishëm, 70 vjetorin e punës dhe aktivitetit të një prej institucioneve tona më të rëndësishme arsimore fetare islame dhe kombëtare, të Medresesë "ALAUDDIN"

Tradita e aktivitetit arsimor fetaro-islam në Kosovë është e vjetër mbi gjashtë shekujllorë, kur filloi edhe procesi i përhapjes së qytetërimit islam. Si rrjedhim i kësaj, në Kosovë fillojnë të themelohen institucione të

karakterit fillor e të mesëm arsimor fetaro-islam.

Medresetë si institucione fetare, arsimore, kulturore dhe edukative, shërbyen si vatra të arsimimit dhe të edukimit të brezit të ri. Shqiptarët, të etshëm për dije, e priten me ngazëllim hapjen e këtyre shkollave, sepse në këto shkolla ata panë mundësinë për t'u arsimuar, meqë, krahas lëndëve fetare, në to mësoheshin edhe ato shkencore.

Pas Luftës së Dytë Botërore, kur udhëheqja e atëhershme komuniste mbylli të gjitha medresetë, populli shqiptar nuk kishte ku të edukonte brezin e ri në mësimet fetare. Kështu të shtyrë nga nevoja e kohës, Kryesia e Bashkësisë Islame me seli në Prishtinë, pas një analize të gjatë, mori vendimin për hapjen e medresesë "Alauddin" më 1 nëntor 1951. Kjo ishte Medreseja e parë në të gjitha trojet shqiptare që u hap pas Luftës së Dytë Botërore të shekullit që shkoj,

ku mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën shqipe.

Sot, shumë nga nxënësit e dikurshëm të kësaj vatre të arsimit, i gjejmë nëpër detyra të ndryshme, shumë prej tyre janë angazhuar nëpër Bashkësitë Islame të trojeve tona etnike, i hasim si teologë, profesorë universiteti, juristë, inxhinierë, mjekë, mësues, nëpunës administrativë nëpër shkolla e fabrika, nëpër arkiva e biblioteka, në politikë, F.S.K, në Sh.P.K, e vende të tjera, por gjithëherë me krenarinë e tyre se ishin dikur nxënësit të kësaj vatre të arsimit.

Nuk është e tepërt të potencohet fakti se fati i medresesë "Alauddin" vazhdimisht ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës. Ajo gjithmonë mori frymë me popullin, e kjo mori vlerën sidomos në periudhën 1989-99 të shekullit të shkuar me veprimtarinë e saj të suksesshme atdhetare.

Bashkësia Islame e R. Kosovës duke qenë e vetëdijshme për problemet, synimet, për rrezikun që i kanosej vendit, në të shumtën e rasteve ishte edhe më vizionare se ata të cilët kishin për objektiv vizionin. Ndaj që nga fillimi i vitit 1989 hapi dyert, hapi zemrën, për të afruar bujari e përzemërsi për të gjithë ata të cilët dëshironin dhe kishin mundësinë t'i shërbejnë atdheut.

Viti 1989 i shekullit të kaluar ishte viti i zhvillimeve të mëdha politike, ndërrimet kushtetuese të imponuara me dhunë, revokimi i autonomisë së Kosovës bëri që në Kosovë të përhapet edhe më shumë pakënaqësia e cila shpërtheu me organizimin e demonstratave të përgjithshme popullore, grevat e minatorëve, protestat e studentëve etj., e së fundi edhe me luftë, për t'i bërë me dije Serbisë se Kosova më nuk mund të jetoj e okupuar dhe nën thundrën e mizorive serbe.

Bashkësia Islame tërë infrastrukturën e saj në tërë vendin e ofroi në shërbim të çështjes kombëtare, e në veçanti do të jetë Medreseja "Alauddin" ajo e cila qysh me rastin e largimit të studentëve nga konviktet e tyre më 1989 do t'i strehoj një numër të konsiderueshëm të tyre dhe do të përkujdeset për ta. Qe këtu e tutje, Medreseja do të jetë pothuajse

adresa e të gjitha aktiviteteve politike, shkencore, sindikaliste, artistike, kulturore e sportive në nivel të Republikës së Kosovës.

Pikërisht në këtë vend ku jeni ulur sonte ju të nderuar të pranishëm, tash e tridhjetë vjet më parë saktësisht më 5 maj të vitit 1991, u mbajt Kuvendi i parë i LDK-së. Kurse më 16 qershor të vitit 1991, në këtë amfiteatër u mbajt edhe Kuvendi i Parë i Forumit të Rinisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Referendumi i shtatorit të vitit 1991 ku shumica e popullatës gati qind për qind u deklaruan për Republikën e Kosovës shtet sovran e të pavarur. Zgjedhjet parlamentare e presidenciale të 24 majit të vitit 1992, të përgatitura nën përkujdesjen dhe patronatin e ish-Presidentit dr. Ibrahim Rugova, bëri që të fillojnë përgatitjet për konstituimin e Parlamentit të Kosovës.

U mblodhën aktivist të shumë dhe u bënë të gjitha parapërgatitjet për konstituimin e Parlamentit të Kosovës. Më 23 qershor të vitit 1992 që lajmëruar se në lokalet e Medresesë "Alauddin" këtu pra ku jeni ju ulur sonte do të mbahej mbledhja themeluese e Kuvendit të Republikës së Kosovës si vazhdimësi e zgjedhjeve shumë partiake parlamentare e presidenciale të 24 majit të vitit 1992, për të ngritur zërin e tyre dhe për t'i bërë me dije botës mbarë se shqiptarët e Kosovës meritojnë lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Jehona e mbajtjes së këtij kuvendi dridhi themelet e Beogradit, tmerroi forcat serbe, ndaj forcat okupuese serbe, në orën 03 të mesnatës së 23 qershorit të vitit-1992 me 150 policë serb me autobllinda e tanke rrethuan Medresenë, hynë në Medrese, ndërprejnë përgatitjet, dhe me këtë rast maltretuan, rrahën e burgosën shumë aktivist të partive politike, dhe shumë nga personeli i Medresesë në krye me drejtorin e saj. Serbët penguan mbajtjen e këtij kuvendi, por ndjenja për pavarësi nuk mund të pengohet ajo edhe më rritej në zemrat dhe shpirtin e popullatës së Kosovës.

Duhet përmendur edhe me këtë rast, në përvjetorin e shtatëdhjetë të Medresesë "Alauddin" se edhe në

këto rrethana, dhe në këtë gjendje shumë të vështirë e të jashtëzakonshme, ku mund të them se i tërë populli i Kosovës hyri në një rezistencë paqësore aktive e mirë të organizuar kundër okupatorit klasik serb, Medreseja gjen fuqinë, motivin e dëshirën edhe më të madhe të jetë nikoqire e shumë aktiviteteve të karaktereve të ndryshme. Medreseja dhe tërë personeli i saj hapi dyert dhe ishte e gatshme të ofrojë çdo gjë për një të ardhme sa më të mirë të vendit.

Të shtyrë nga ndjenja e thellë islame dhe atdhetare e kalitur në zemrën dhe shpirtin e Bashkësisë Islame dhe të personelit të Medresesë, të nxënësve të saj, ata iu ofruan ndihmë shumë institucioneve të Republikës së Kosovës, si për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Ministrinë e Arsimit, Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, të gjitha partive politike të Kosovës. Medreseja i hapi dyert edhe për tribuna shkencore, të aspektit kulturor e sportiv, këtu në këtë amfiteatër u mbajtën shumë revista të recitatorëve të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës, u mbajtën tribuna, ligjërata të ndryshme. Në Medrese mbroheshin diplomat, magjistraturat, doktoratat, në një mënyrë Medreseja ishte një mësonjëtoare e madhe e Universitetit të Prishtinës. Këtu zhvilloi aktivitet edhe Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në Medrese në këtë amfiteatër me rastin e 30 vjetorit të themelimit të institutit Albanologjik për tri ditë radhazi. Këtu është mbajtur edhe simpoziumi shkencor me temën: "Shqiptarët në fund të shekullit XX", të organizuar nga Instituti i Historisë. Simpoziumi "Për kulturën e gjuhës shqipe" të cilin e ka organizuar Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Simpoziumi kushtuar "Isa Boletinit" e shumë të tjerë. Medreseja ishte edhe mikpritëse e shumë simpoziumeve e sesioneve shkencore, seminareve, manifestimeve kulturore, kuvendeve të shumta të partive politike, e shumë aktivitete të karaktereve të ndryshme qofshin ato politike kulturore, arsimore apo sportive mbi 1230 sosh...

Me daljen haptas të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë, dhe shpërthimit të luftës frontale në Kosovë me UÇK-së dhe forcave ushtarake policore, paramilitare dhe bandave serbe, Medresenë do ta gjen me shumë aktivist të saj të rrahur, të burgosur dhe të vrrarë nga dora serbe për shkak të aktiviteteve të tyre shumë dimensionale. Nxënësit e Medresesë të shtyrë nga ndjenja për liri, e cila ishte kalitur në shpirtrat e tyre të njomë nga edukatorët dhe profesorët e kësaj vatre të arsimit, e kësaj kështjelle të paepur, ishin prej të parëve që iu bashkëngjiten radhëve të Ushtrisë së lavdishme çlirimtare të Kosovës, u uniformuan me uniformën e UÇK, 87 nxënës, 14 prej tyre ranë dëshmorë, me gjakun e tyre të njom ujiten tokën e shenjët të pastër të Kosovës sonë ata ishin: Mustafë Veseli, Muhamet Bicku, Sami Plakolli, Arben Hyseni, Nysret Musa, Shefqet Zeka, Behar Abdulmexhidi, Selim Selimi, Muhamet Ukshini, Feti Sofiu, Habib Hoxha, Hysen Zeka, Halim Bajraktari dhe Jonuz Zejnullahu, ky i fundit në Koshare përsëriti heroizmin e Mic Sokolit. Këtyre Medresistëve dëshmorë iu bashkëngjiten edhe 23 imam të tjerë të cilët ranë dëshmorë për të mos vdekur kurrë.

Në këtë përvjetor të rëndësishëm, në këtë manifestim çmojmë, ndërrojmë, njohim e vlerësojmë me një mirënjohje të veçantë të gjithë drejtuesit, pedagogët, nxënësit dhe të gjithë ata që me angazhimin, punën, përkushtimin, sakrificën, dijen dhe kontributin e tyre punuan për ngritjen dhe zhvillimin e Medresesë, duke e bërë atë një qendër të rëndësishme së veçantë të edukimit dhe arsimit, e cila medrese jetoj e bashkëlidhur dhe e pandarë me fatin e popullit dhe të vendit tonë.

Duke e përmbyllur fjalën time, Medresesë i uroj nga zemra jetë të gjatë, suksese dhe veprimtari të begatë, si dhe përmbushje të plotë të misionit të saj hyjnorë, historik e kombëtarë.

*Myftiu, Naim ef. Tërnavë
Më 22.12.2021
Prishtinë*

Fjalimet e pjesëmarrësve me rastin e shënimit të 70-vjetorit të themelimit të Medresesë

Kryeministri Kurti

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, uroi për këtë përvjetor të pranishmit, dhe tha se besimi shërben si direktivë për çdo hap të jetës. Kryeministri Kurti në vazhdim tha se me Myftiun Tërnavë njihemi që nga shekulli i kaluar, për më shumë se një çerek shekulli, nga koha kur Medreseja "Alauddin" ishte vendi i kuvendit. I kuvendit politik e kombëtar për rezistencë, për liri. Sot, kur e shënojmë 70-vjetorin, këtë përvjetor jubilar të Medresesë "Alauddin", edhe Myftiu Tërnavë, e edhe unë, jemi plakur pak. Shumë më pak se sa vitet që kanë kaluar prej atëherë, mirëpo padyshim që asnjëri prej nesh nuk ka ndryshuar qëllim për të mirën e përgjithshme, të shoqërisë e të kombit tonë, e gjithashtu edhe nuk ka ndryshuar karakter të dashamirësisë për popullin të cilit duhet t'i shërbejmë pa rezervë dhe pa kursim. Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë si shembull për harmoni ndërfitare, shembull për demokraci dhe shembull që besimi dhe tradita fetare, çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne. Kurti, i cili përmendi fjalët e profetit Muhamed a.s., rreth kërkimit të diturisë deri në fund të botës, tha se në besim dhe në praktikë dhe në lutje, ka përpjekje për edukim të njerëzimit. Unë e di që sot, më shumë se një shekull pas, mes medresistëve këtu, ka nxënës po kaq të shkëlqyer dhe edhe më shumë të përkushtuar për dije. "Leximi", në formë urdhërore si fjala që hap tekstin e Kuranit dhe këshilla e Muhamedit për të kërkuar dijen deri në fund të botës, besoj se janë motiv nismëtar për medresistët këtu, bashkë me synimin për emancipim dhe kontributdhënie në shoqëri. Ai tha se tradita e besimit dhe ajo shqiptare janë në harmoni të ngushtë dhe duhet të mirëmbahen si të tilla. "Si një popull me shumicë myslimane,



shqiptarët ditën ta ruajnë Islamin mes tyre edhe gjatë këtyre dy dekadave të fundit kur për shkak të luftës globale kundër terrorizmit, të ishe mysliman ishte e vështirë sikur ta mbaje një gacë në dorë, saktë siç kishte parashikuar profeti i islamit, Muhamed. Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë dhe harmoninë ndërfitare, shembull për demokracinë dhe shembull që besimi dhe tradita fetare çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne", tha Kurti, për të përfunduar se shoqëria mund të presë nga edukimi fetar një direktivë të shpirtëritimit etik të saj, me mirësinë kundër zilisë, pjekurinë kundër ngutisë, me maturinë kundër makutërisë. Shpreh bindjen e fortë se tradita e popullit tonë dhe tradita e besimit do të jenë në një harmoni të ngushtë brenda institucionit tuaj.

Këshilltari i presidentes, z. Kupina

Presidentja Vjosa Osmani, për shkak të agjendes së saj të ngjeshur, nuk ka mundur të jetë prezent, por këshilltari i saj, z. Bekim Kupina mbajti një fjalë rasti dhe njëherësh



përcolli medaljen presidenciale “Për liri dhe pavarësi” për Medresenë “Alauddin” për kontributin e dhënë ndër vite. Medreseja “Alauddin” është një me historinë e shtetit tonë. Ajo nuk mund të shihet ndaras. Kontributi i saj në kohën e sistemit paralel nën udhëheqjen e presidentit historik, dr. Ibrahim Rugova, vazhdoi edhe gjatë periudhës së luftës. Të dhënat flasin për 37 hoxhallarë e medresistë dëshmorë të luftës së UÇK-së. Kjo Medrese na kthen në kohë, duke në rikujtuar rrugën tonë të zorshme për liri e pavarësi. Kjo ndërtesë i ruan rrëfimet e secilit për atë periudhë të lavdishme tonën. Kjo shkollë kërkon vëmendjen tonë, kultivimin e kujtesës historike, arkivimin e ngjarjeve, situatave dhe zhvillimeve të kohës. Roli i Medresesë është për t’u admiruar edhe në kultivimin e një klime të tolerancës ndërfetare, e cila shquan popullin tonë. Prandaj, funksioni i saj është shumëfunktional. Medreseja nuk është thjesht vetëm një shkollë, nuk është thjesht vetëm një objekt, por është një pikë ndalese për secilin prej nesh, një monument trashëgimie, një regjistruese besnike e një periudhe historike. Kjo Medrese prandaj është histori në vete, sepse ndodhitë brenda saj ishin të tilla. Prandaj, duke u bazuar në këto që thash më sipër, presidentja Vjosa Osmani ka dekoruar Medresenë “Alauddin”, me Medaljen Presidenciale të Meritave. “Muret e këtij objekti janë dëshmitarë

të kohës së një pjesë të lavdishme të historisë sonë, ku në këtë vatër diturie, mësimi dhe aktiviteti kombëtar ishin bërë një. Në këtë përvjetor Medreseja “Alauddin” meriton respekt për kontributin që ka dhënë në procesin e lirisë dhe pavarësisë së vendit. Historia dhe kontributi i Medresesë është i njëjtë me historinë e shtetit tonë, ajo nuk mund të shihet ndaras. Rol i kësaj shkollë është për t’u admiruar në krijimin e klimës së tolerancës ndërfetare e cila është e shquar në popullin tonë dhe ajo thjesht nuk është vetëm një shkollë, por është një pikë ndalese e secilit prej nesh, monument trashëgimie e një periudhe historike. Kjo Medrese është histori në vete” - tha Kupina.

Ish-presidenti Pacolli

Kryetari i AKR-së dhe ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një fjalë rasti, i ka uruar suksese të mëtutjeshme Medresesë “Alauddin”. Ai tha se: “Ju mësimdhënësit, akademikët e këtij tempulli na keni mësuar si të jetojmë, si të sillemi më njëri-tjetrin, si ta duam njëri -tjetrin. Ju na udhëzoni, e ne duhet t’ju dëgjojmë. Ju gjithmonë keni mësuar dhe mësoni se njeriu nuk duhet të bashkëjetojë me të keqën, e keqja duhet të jetë anash. Ju priftë e mbara dhe Zoti ju ruajte dhe të festoni edhe shumë përvjetorë të tjera” - tha ish-presidenti Pacolli.

Kryetari i Shoqatës së të burgosurve politik z. Novella

“Gjithnjë e kam theksuar se kur të shkruhet historiku i Prishtinës do të jetë i mangët dhe jo i plotë pa përfshirjen e rolit dhe kontributit të Medresesë “Alauddin” dhe kur të shkruhet historia e UÇK-së, posaçërisht ku shkruhet për logjistikën e UÇK-së, nuk mund të merret me mend se mund të shkruhet par praninë, aktivitetin, sakrificën e Medresesë “Alauddin”. Kjo shkollë ishte siç thoshte një ushtar magjia e UÇK-së. Andaj me kënaqësi ndaj mirënjohjen më me gëzim në emër të Kryesisë së Shoqatës së të burgosurve politikë për kontributin që Medreseja ka dhënë në Këshillin Republikanë për ndihmë emergjente. Për këtë ndjej mirënjohje të veçantë për krahun e djathtë që e kishte dërguar Zoti për neve si Këshill, e edhe për luftën, për drejtorin e atëhershëm të kësaj shkollë, Naim ef. Tërnavën dhe nuk kemi mundur të funksionojmë pa mbështetjen e tij dhe pa kontributin financiar. Medreseja gjatë kohës së luftës ka qenë spital, ka pranuar studentët me ditë e net të tëra dhe i ka strehuar ata të cilëve u janë djegur shtëpitë, UÇK-ja e ka pasur një adresë nëse mbyllen të gjitha rrugët dhe shpeshherë janë mbyll, dera e Medresesë ka qenë e hapur 24 orë për neve” - tha z. Novosella.

Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnavë në promovimin e veprës “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) – sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”

Kjo është vepra e parë me karakter enciklopedik e botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës

*I nderuar ministër, z. Hajrulla Çeku,
Të nderuar udhëheqës e drejtues të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës,*

Të nderuar profesorë të Universitetit të Prishtinës,

Të dashur studentë,

Të nderuar dashamirë të fjalës së shkruar,

Motra e vëllezër!

Kam nderin që t’ju përshëndes në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim, e në të njëjtën kohë të shpreh mirënjohjen time që jeni sot bashkë me ne për të promovuar monografinë “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) – sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman” të autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra, e cila ka parë dritën e botimit dhe tani është në duart e lexuesve, është pjesë e bibliotekave dhe auditorëve tona. Monografia që sot po e promovojmë, në të vërtetë, është realizim i një projekti për ndriçimin e personaliteteve tona të panjohura deri më tani që kanë jetuar e vepruar në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare. Pa dyshim, vëmendja e Bashkësisë Islame të Kosovës për personalitetet tona të dijes e të fesë ka qenë e fokusuar edhe më herët, ku janë mbajtur sesione e konferenca shkencore dhe po ashtu janë botuar edhe kontribute dhe monografi të veçanta. Megjithatë, botimi i vëllimit “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912), sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”, duhet thënë, me gojën plotë, se paraqet, - si për nga për-



mbajtja, ashtu edhe për nga rezultatet, pastaj për nga vëllimi dhe shtrirja e këtyre personaliteteve (që vijnë nga gjithë trojet shqiptare), - një ndër projektet më të rëndësishme në fushën e fjalës së shkruar dhe të studimeve që ka realizuar Bashkësia Islame e Kosovës në dekadat e fundit.

Themi kështu, sepse kemi parasysh faktin se kjo është vepra e parë me karakter enciklopedik e botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, por ajo është edhe e para edhe në Kosovë dhe në trojet shqiptare, në të cilën përfshihen dhe ndriçohen, - mbi bazën e dokumenteve osmane të kohës të pa trajtuara më parë, - biografite e dyqind personaliteteve shqiptare të shquar të dijes që i kanë takuar elitës intelektuale të kohës dhe që kanë vepruar në dekadat e fundit të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, shumica sosh, fare pak ose aspak të njohur më parë.

Jeta dhe veprimtaria e këtyre personaliteteve nga trojet tona të trajtuara në këtë vëllim, sikurse u tha, kanë qenë të panjohur deri më tani për opinionin shkencorë shqiptarë e më gjerë, prandaj ky botim, jep të dhëna për këta dijetarë shqiptarë myslimanë, për kontributin dhe për integrimin e tyre në elitën intelektuale të kohës, duke u bërë kështu pjesë e institucioneve më të larta arsimore e fetare.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës e ka botuar këtë vepër, sepse në të nuk trajtohen e ndriçohen vetëm biografite e dyqind dijetarëve tanë (ndonëse ata zënë pjesën më të madhe dhe janë subjekti i këtij studimi dhe kjo është e kuptueshme), por aty përmenden, zënë vend dhe jepen shënime edhe për mësuesit e tyre dhe jo vetëm. Aty dalin në pah edhe shumë të dhëna të tjera me rëndësi (e themi përsëri pak të njohura ose fare të panjohura) për një numër



të madh të institucioneve arsimore të kohës, siç janë mejtepet, medresetë, shkollat e mesme Rushdije e Idâdije, shkollat e larta pedagogjike-Dârulmuallimîn, për pedagogët e tyre, lëndët që janë mësuar në to e deri edhe te emrat e themeluesve dhe të vakëflënësve të ndryshëm, pa përmendur këtu edhe numrin e madh të lagjeve, të xhamive, fshatrave e vendbanimeve tona, që një pjesë e tyre, për shkak të rrethanave shoqërore e politike dhe zhvillimeve të ndryshme, sot nuk njihen, ose për më keq, një pjesë e tyre (xhamive, medreseve etj.) fatkeqësisht janë shkatërruar dhe më nuk ekzistojnë, madje as si emër, ose edhe për më keq, sot ato vendbanime nuk banohen dhe as administrohen nga shqiptarët, sepse janë marrë dhunshëm nga fqinjët tanë përgjatë viteve e dekadave. Aty lexojmë për përgatitjet shkollore dhe për karrierën aq të begatë akademike që kanë pasur këta shqiptarë, - duke filluar që nga mësues në fillore, myderrizë nëpër medrese të ndryshme brenda dhe jashtë trojeve shqiptare, myftinj, kadilerë me shërbime gjithandej Perandorisë Osmane, madje deri në Mekën e ndershme, pastaj profesorë të leksioneve publike, përkatësisht “myderrizë dersiâm” që mbanin ligjëratat për të gjitha lëndët në medresetë kryesore, kryesisht të kompleksit të famshëm të “Fâtihut” në Stamboll, nëpunës në Qendrën kryesore të Fetvave të Perandorisë

Osmane në Stamboll, ligjërues nëpër xhamitë më kryesore të Stambollit, redaktor të botimeve dhe Mus’hafëve, e deri në pozitën e ligjëruesit të sultanit dhe divanit të tij, - që s’kemi se si të mos ndjehemi krenar për këtë elitë intelektuale e akademike shkencore të kohës, të dëshmuar, mbi të gjitha dhe para se gjithash, me dokumente origjinale në gjuhën osmane të hartuar nga vetë institucionet ku kanë shërbyer e vepruar këta shqiptarë të rrallë.

Mirëpo, duhet thënë këtu se, sikurse del edhe nga këto dokumente, pas fillimit të copëtimit të trojeve tona më 1878 dhe krijimit të rrethanave të reja shoqërore politike jo vetëm tek ne, por edhe në gjithë perandorinë, kjo elitë e intelektualeve e jona përveç se detyrohet që të shpërndahet dhe të gjendet kush si mundet, ajo mbeti edhe e panjohur, e anatemuar dhe e harruar.

Prezantimi i biografive të përfshira në veprën “Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912), sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”, paraqet një kontribut me vlera shkencore për historinë e institucioneve, arsimit, kulturës e trashëgiminë islame në veçanti dhe për historinë tonë në përgjithësi. Mbesim me shpresë se jeta, veprimtaria dhe kontributi i tyre i gjithëmbarsuem dhe shumëdimensional do të jenë pjesë e interesimeve

të studiuesve tanë duke na sjellë rezultate të reja dhe duke i plotësuar këto personalitete shumica e të cilëve pa asnjë dyshim, meritojnë studime dhe monografi të veçanta. Iniciativat, projektet dhe ndërmarrjet e këtilla, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, i mirëprit dhe ajo zotohet se do të vazhdojë t’i përkrah, për aq sa ato janë me interes për kulturën, shkencën, fenë, trashëgiminë dhe historinë tonë. Është obligim e amanet i yni që të njohim të kaluarën, t’i njohim institucionet dhe pararendësit tanë, t’i vlerësojmë drejt dhe t’u japim vendin e merituar në historinë e popullit tonë. Sikundër që e kemi amanet që t’i korrigjojmë edhe gabimet që për arsye të ndryshme që janë bërë për gjatë kohëve në raport me të kaluarën tonë të begatë islame shqiptare. Me këtë rast, edhe një herë përgëzoj të gjithë ata që e bënë të mundur realizimin e këtij botimi dhe kontribuuan që ky libër të del në këtë format. Një mirënjohje të veçantë, përveç autorëve, meritojnë edhe redaktori, recensentët, redaktori gjuhësor, redaktori teknik dhe të gjithë ata që në një mënyrë a në një tjetër kontribuuan në këtë ndërmarrje. Ju faleminderit për praninë dhe vëmendjen tuaj

Prishtinë, 02.12. 2021
Myftiu Naim ef. Tërnavë

Fjala e recensentit Sabri ef. Bajgora në promovimin e veprës “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) – sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”

Ky libër është një model i suksesshëm i punës që mund të zbatohet në kërkimet shkencore gjithandej lidhur me këtë problematikë

Në këtë fjalë do të përqendrohemi që të flas diçka më shumë rreth përmbajtjes së librit *Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)*. Struktura e tij është dëshmi e qasjeje të hapur të autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra lidhur me hapësirat etnike shqiptare që atëbotë ishin të përfshira në kuadër të Perandorisë Osmane. Kjo është shpërfaqje e vetëdijes shkencore të autorëve që të përfaqësohen kapacitete intelektuale shqiptare nga të gjitha viset e asokohshme etnike. Është fakt se këta dijetarë, me origjinën dhe me përcaktimin e tyre etnik-kombëtar, ishin shqiptarë dhe pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore e diturore shqiptare. Përfshirja e këtillë pa dyshim se e ka një bazë reale të ekzistimit dhe është dëshmi e funksionimit të jetës arsimore, kulturore e diturore në mbarë hapësirën perandorake, pavarësisht faktit se ka ndonjë qendër që sot nuk e gëzon namin që e kishte dikur. Duke respektuar shtrirjen e sotme dhe pikënisjen e organizimit të trevave brenda shteteve shqiptare, autorët kanë prezantuar dijetarët sipas kësaj renditje të qendrave: Prishtina, që përfaqësohet me 11 personalitete, Mitrovica, Vushtrria, që përfaqësohen me nga 1 një personalitet, Peja me 3 tri personalitete, Gjakova me 11 personalitete



të dijes, Prizreni, përfaqësohet me 13 personalitete, Gjilani me dy personalitete diturake, Presheva me katër personalitete, Nishi me një, Novi Pazari me dy personalitete, Shkupi me pesë personalitete, Tetova me 12 personalitete, Kumanova dhe Kërçova me nga dy personalitete, Qyprilia me dy personalitete, Ohri me tri personalitete, Manastiri me shtatë personalitete, Dibra me 15 personalitete, Mati me një, Prilepi dhe Shtëpi me nga katër personalitete, Serfixhe me një, Ulqini dhe Gucia me nga dy personalitete, Podgorica me një, Shkodra me nëntë personalitete, Kruja me dy personalitete, Tirana me katër personalitete,

Durrësi me një, Kavaja me pesë personalitete, Elbasani me tri personalitete, Peqini dhe Berati me nga dy personalitete, Gjirokastra me 20 personalitete, Libohova me 10 personalitete, Korça përfaqësohet me 8 personalitete, Delvina me 2 personalitete, Janina me 11 personalitete, Ajdonati me 2 personalitete dhe Drama me 1.

Megjithëse shumica e këtyre dijetarëve shqiptarë kishin kryer shkollë të larta në Stamboll, ndër të cilat spikatnin medresetë e këtij qyteti dhe shumica po ashtu kishin ndjekur mësimet të dijetarët më në zë të Perandorisë, nuk duhet harruar faktin se, pothuajse pa përjashtim, të

gjithë këta dijetarë shqiptarë i kishin bërë mësimet fillestare në vendlindjet e tyre. Kjo është një dëshmi që ndërlidh shfaqjen e tyre në krejt hapësirën etnike me sistemin e zhvilluar arsimor gjithandej Perandorisë Osmane. Autorët e librit, duke ofruar të dhëna mbi shkollat që këta dijetarë kishin ndjekur në vendlindje, ofrojnë një pasqyrë mjaft të kompletuar të shkollave dhe të arsimit në viset shqiptare.

Dosjet e Meshihatit të Lartë Osman, krahas të dhënave të përgjithshme dhe atyre që lidheshin me shkollimin e kuadrove në fushë të dijes, përmbajnë edhe të dhëna sa u përket përgjegjësive që kishin bartur ata dhe vendit të shërbimit e në raste të caktuara edhe të rezultateve dhe të shpërblimit që kishin marrë për detyrën e kryer. Në planin e organizimit juridik shtetëror del se një numër i konsiderueshëm kryenin detyrën e kadiut, zëvendës kadiut, por edhe të naibit, sidomos në fillimet e karrierës, pa harruar faktin se kishte prej tyre edhe zyrtarë, anëtarë, sekretarë e kryetarë të Gjykatës së Sheriatit në nivele të ndryshme e madje-madje deri në Gjykatën e Lartë të Sheriatit. Merret vesh se kjo kategori përballej me një qarkullim më të shpeshtë nga një vend në një vend tjetër në përputhje me rregullativën ligjore perandorake. Megjithatë, bie në sy fakti se shumica e kadilerëve pavarësisht se karrierën e tyre profesionale e kishin ushtruar nëpër vende të ndryshme të Perandorisë, atë e kishin mbyllur në vendlindjen e tyre ose më afër saj, gjë që tregon se ata, pas pensionimit, kishin vendosur të shkonin në vendin e tyre ku do të kalonin pjesën e mbetur të jetës.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre dijetarëve ishte e lidhur me punën në procesin e ligjërimit, qoftë kur bëhet fjalë për punën në shkolla, qoftë kur bëhet fjalë për ligjërimitin në institucione e në detyra fetare. Kështu, në mesin e këtyre dijetarëve shqiptarë kishte “myderrizë dersi-âmë”, përkatësisht profesorë që

mbanin ligjërata për të gjitha lëndët në medresetë më të rëndësishme, që bënë pjesë në kompleksin e “Fâtihut” në Stamboll. Këtë status tejet të veçantë ditoror e gëzonin: Haxhi Iljaz ef. Prishtina, Bajram ef. Peja, Haxhi Abdurrahim ef. Gjakova, Adem Nuri ef. Gjakova, Haxhi Zejnel ef. Prizreni, Hysen Nexhmedin ef. Prizreni, Adem ef. Tetova, Rexhep ef. Tetova, Mustafë ef. Peqini, Aliriza ef. Qypriiliu, Iljaz ef. Ohri, Ismailhaki ef. Manastiri, Vildan ef. Dibra, Hafiz Xhemal ef. Dibra, Hafiz Rexhep ef. Prilepi, Jusuf ef. Shkodra, Ibrahim ef. Kavaja, Ibrahim ef. Elbasani, Isa ef. Delvina, Mehmet Nedim ef. Libohova, Ahmet ef. Gjirokastra, Azem ef. Gjirokastra etj. Është me interes të theksohet edhe fakti se ndër shqiptarët e dijshtëm të asaj kohe kishte edhe të tillë që e mbanin pozitën e ligjëruesit të sulltanit, të cilët ligjëronin para autoritetit më të lartë perandorak dhe njëkohësisht para autoritetit më të lartë fetar dhe kjo doemos kërkonte një përgatitje superiore profesionale e intelektuale. Ndër ta veçojmë: Haxhi Iljaz ef. Prishtinën, Bajram ef. Pejën, Haxhi Abdurrahim ef. Gjakovën, Hysen Nexhmedin ef. Prizrenin, Rexhep ef. Tetovën, Aliriza ef. Qypriiliun, Vildan ef. Dibrën etj. Përtej roleve të përmendura më lart, ndër këta dijetarë kishte edhe redaktorë botimesh dhe të Mus’hafëve, por edhe funksionarë në Qendrën Kryesore të Fetvave të Perandorisë Osmane në Stamboll etj. Disa prej tyre që kishin funksione të ndryshme në Qendrën Kryesore të Fetvave të Perandorisë Osmane në Stamboll, të njohur si “Fetvâhânja e Lartë”, pastaj ishin profesorë nëpër shkolla publike e deri në pozitën e ligjëruesit të sulltanit etj. Është me rëndësi të theksohet se në mesin e këtyre dijetarëve kishte edhe të tillë që kishin arritur të bëheshin myderrizë dhe kadilerë deri në Mekën e bekuar. Nuk duhet harruar faktin se ndër dijetarët shqiptarë kishte ligjërues në xhamitë kryesore të Stambollit etj. Ndër ligjëruesit në ditën e xhuma

dhe në bajrame nëpër xhamitë kryesore të Stambollit, veçoheshin edhe këta dijetarë shqiptarë: Arnaut Mehmet Vehbi ef. Tetova, Mehmet Hurshid ef. Tetova, Aliriza ef. Qypriiliu, Ismailhaki ef. Manastiri, Ibrahim ef. Kavaja, Ibrahim ef. Elbasani, Isa ef. Delvina etj. Kishte nga dijetarët shqiptarë edhe të tillë që kishin arritur statusin e anëtarit të Komisionit për përmirësimin e çështjeve studentore dhe për hartimin e planprogrameve mësimore për studentët e Medreseve të Fâtihut, ku veçoheshin Hysen Nexhmedin ef. Prizreni, Rexhep ef. Tetova etj. Ndër ata që shërbenin një kohë të gjatë në rolin e myderrizëve kishte të tillë që, në saje të autoritetit të fituar për shërbimin profesional, korrekt e të drejtë, nga masat e gjera popullore zgjidheshin për myftinj të vendeve të tyre. Përveçse në vendlindjet e tyre, ku kishin shërbyer si myftinj dhe myderrizë, vërehet një prirje që disa nga dijetarët shqiptarë t’i ushtronin këto detyra edhe nëpër vende të tjera jashtë trojeve shqiptare, sidomos pas viteve 1912-1913, kur nga dhuna sllave u detyruan që të shpërnguleshin. Duke përfunduar këtë fjalë vlerësoj se puna e bërë nga autorët Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra është një nismë e mbarë në drejtim të dokumentimit të së kaluarës sonë, veçmas të asaj të periudhës osmane. Gjithashtu është edhe një model i suksesshëm i punës që mund të zbatohet në kërkimet shkencore gjithandej lidhur me këtë problematikë, pra edhe në kuadër të projekteve që do të realizohen në kuadër të Institutit të Studimeve Islame. Bashkësisë Islame të Kosovës si botuese dhe mbështetëse e këtij projekti madhor dhe autorëve u uroj sukses në realizimin e projekteve të mëtejme në këtë fushë me interes për studimet tona të periudhës osmane.

*Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në hapjen e Konferencës shkencore
“Revista “Edukata Islame” – 50- vjet mision në fjalën e shkruar shqipe”*

Veprimtaria gjysmëshekullore e revistës “Edukata Islame” ka kaluar nëpër sfida, ashtu siç ka qenë historia dhe fati i populli tonë

*Të nderuar studiues nga Kosova, Shqipëria,
Maqedonia e Veriut dhe Malit të Zi,
Vëllezër e motra,
Mysafirë të nderuar!*

Këtë vit janë mbushur plot pesëdhjetë vjet, që kur ka nis misionin e saj te ne “Edukata Islame” - si revistë e parë islame në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në të gjitha trevat shqiptare jashtë Shqipërisë administrative, andaj kam nderin që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t’ju përshëndes e t’ju falënderoj që sot jeni këtu me ne për të shënuar këtë përvjetor të rëndësishëm së veçantë për literaturën islame në gjuhën shqipe e me theks të veçantë për periodikun islam tek ne dhe jo vetëm.

Një falënderim të veçantë kam për studiuesit që kanë marrë mundin dhe në këtë përvjetor i janë përgjigjur nismës tonë në Konferencën vlerësuese për revistën “Edukata Islame” dhe, të cilët, me kontributet e tyre, do vënë në pah rolin, rëndësinë, sfidat dhe sukseset që ka shënuar revista “Edukata Islame” përgjatë rrugëtimit të saj gjysmëshekullore në mesin e besimtarëve islam të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Luginës së Preshevës dhe të Diasporës.

Të nderuar të pranishëm

Veprimtaria gjysmëshekullore e revistës “Edukata Islame” ka kaluar nëpër sfida dhe në plotë kthesa, ashtu siç ka qenë historia dhe fati i populli tonë. Mirëpo, revista, me gjithë vështirësitë me të cilat u përball, ajo fal vizionit, urtësisë e vendosmërisë së drejtuesëve të saj, arriti ta zhvilloj misionin e saj dhe si e tillë është një dëshmi e përpjekjeve vetëmohuese për të qëndruar me integritet të pacenuar përball çdo sfide e pengese.



Revista “Edukata Islame” misionin e saj, sikurse u tha, e ka nisur këtu e pesëdhjetë vjet më parë, pra më 1971, kur pa dritën e botimit numri i parë i revistës. Revista atëkohë ishte organ i ish-Shoqatës Ilmije, që më vonë u quajt Shoqata e Ylemave.

Vet dalja e një reviste të tillë, këtu e pesë dekada më parë ishte sukses i prekshtëm i vizionit të udhëheqësve të Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilët pas Luftës së Dytë Botërore u përballën me regjimin e filozofinë komuniste, në njërin anë, dhe me dhunën serbe, në anën tjetër.

Megjithëkëtë, pas disa ndryshimeve që ndodhën asokohe në kuadër të ish-federatës jugosllave, sidomos pas atij që njihet si Plenumi i Brionëve, edhe për Kosovën filloi, si të thuash, të fryjë një lloj klime më liberale, dhe në këtë kontekst, si të gjitha institucionet e tjera në Kosovës, edhe Bashkësia Islame e shfrytëzoi këtë ndryshim duke vënë në funksion të gjitha kapacitetet e saj, me gjithë që ishin të pakët, por me vullnet të madh, nxori akte e vendime, për të

themeluar institucione e për të bërë vepra, të cilat jo vetëm se do t’i rezistojnë kohës, por do bëhen bartëse të identitetit e subjektivitetit institucional, nacional, kulturor, fetar e arsimor.

Në vazhden e këtyre vendimeve që kishte marrë asokohe udhëheqja e Bashkësisë Islame, që edhe vendimi për nxjerrjen e revistës “Edukata Islame”, e cila që në embrion ishte dizajnuar si revistë fetare islame. Ishte fati i madh, që në këtë kohë, në krye të Shoqatës së Ulemave ishte vizionari e pedagogu i shquar, myderrizi ynë i njohur haxhi Sherif Ahmeti, i cili jo vetëm që kishte vizionin për revistën, por ai në atë kohë bëri projektin dhe mori përsipër edhe drejtimin e revistës, pra Haxhi Sherifi është edhe kryeredaktori dhe drejtuesi i parë i revistës “Edukata Islame”.

Haxhi Sherifi me vullnet e dëshirë të pashoqe arriti që afër vetës t’i tubonte ato pak quadro që njihnin mjaftueshëm kulturën e shkrimin në gjuhën shqipe, ai arriti t’i jepte jetë, formë, fizionomi e tematikë. Me pakë bashkëpunëtor, por për të parën herë në gjuhën shqipe, në

kryeqendrën administrative të Kosovës, në Prishtinë, lëshon shtratin e saj “Edukata Islame”, e cila përveç se është një akt historik vet themelimi i saj, sepse ajo shpejt bëhet shkruese e historisë në misionin e fjalës së shkruar islame, dhe, si e tillë, me kalimin e kohës, e sidomos në vitet e ‘70 dhe të ‘80 të shekullit të shkruar shndërrohet në tryezën e mendimit islam te ne dhe jo vetëm.

Në revistën “Edukata Islame”, të udhëhequr nga myderrizi Haxhi Sherif ef. Ahmeti e të mbështetur nga drejtuesit e BI, sprovajnë vetën në fjalën e shkruar kuadrot e para që kishin kryer medresetë e pas Luftës së Dytë Botërore, siç ishin Hajrullah ef. Hoxha, hfz. Avi Aliu, Jashar ef. Jashari, Jetish ef. Bajrami etj. Mirëpo, jo vetëm kaq, prijësit e “Edukatës...” krijuan klimë e premisa për bashkëpunëtorët e jashtëm, dhe sidomos për nxënësit e studentët të cilët do të thyenin akullin dhe përmes “Edukatës islame” do të hynin në botën e gjerë të fjalës së shkruar, gjithnjë nën kujdesin e kryeredaktorit e redaktorit të “Edukatës...”, H. Sherif ef. Ahmetit, përkatësisht Hajrullah ef. Hoxhës.

Rrita e “Edukatës Islame”, shënon edhe daljen në shesh të kuadrove të reja, sidomos kuadrove që tanimë kthehen nga studimet jashtë vendit e të cilët i dhanë shtytje, vlerë e rëndësi revistës “Edukata Islame”, për ta bërë atë një misionare të denjë të fesë e besimit islam në ditë e kohë të vështira për besimet e fetë në sistemin socialist të udhëhequr nga komunistët që nuk njihnin as din e as iman, por angazhoheshin për krijimin e njeriut të ri, për krijimin e vlerave komuniste të mbështetur në doktrinën ateiste.

Mirëpo, përveç këtyre që thamë, revista “Edukata Islame” ka në vetë edhe misionin e saj historik, megjithëqë është e para e kësaj fushe në gjuhësh shqipe në Kosovë dhe në trevat tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. Kështu që “Edukata Islame”, me plotë të drejtë mund të quhet vazhdimësi e periodikut islam në gjuhën shqipe që ishte botuar nga Komiteti Mysliman i Shqipërisë gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe gjatë periudhës mes dy luftërave, siç janë revistat e njohura “Zani i Naltë” dhe “Kultura Islame”, e të cilat paraqesin një trashëgimi të pa çmuar për kulturën e historinë tonë, por që fatkeqësisht ndaluan së daluri.

E themi këtë, ngase vërehet ndikimi i këtyre dy revistave në konceptin dhe tematikën e “Edukatës Islame”, dhe kjo është krejt e kuptueshme, sepse dihet mirëfilli që fillimisht “Zani i Naltë” e më vonë “Kultura Islame” në origjinën e tyre qenë ideuar e projektuar për të gjithë hapësirën shqiptare, mirëpo zhvillimet e mëvonshëm e pamundësuan një mision të tillë. Kjo nuk do të thotë assesi që paria islame në Kosovës që nuk i ka njohur dhe nuk i ka shfrytëzuar revistat në fjalë, përkundrazi me gjithë rrezikun që ka bartur me vete literatura në gjuhën shqipe për shqiptarët që ngelen jashtë Shqipërisë administrative të vitit 1913, ajo gjeti rrugë e kanale që të jetë e pranishme në bibliotekat e parisë e ulemasë shqiptare të cilët e shfrytëzuan, e konsultuan dhe e ruajtën me kujdes maksimal për t’ua lënë trashëgimi brezave të rinj.

Përveç kësaj, një dimension tjetër historik që bartë në vete Revista “Edukata Islame” qëndron në faktin se pikërisht “Edukata...” është pararendëse e periodikut që do të lind më vonë në kuadër të Bashkësisë Islame shqiptare, siç fjala vjen “Ditura Islame”, në Prishtinë, “Hëna e Re” në Shkup, pastaj “Elif” në Podgoricë, po pse jo edhe në ri-ngritjen e periodikut të Komitetit Shqiptar Mysliman pas viteve të ‘90, e para së gjithash e revistës “Drita Islame”.

Dimensioni historik i revistës “Edukata Islame” është i shumanshëm, mirëpo më lejoni që shkurtimisht të theksoj edhe një segment të rëndësishëm. Suksesi i revistës “Edukata Islame” krijoi vetëbesim, kushte e premisa për zhvillimin e literaturës islame në gjuhën shqipe, e në këtë kontekst shqipja do të bëhet në vitet e ‘80 gjuhë që e njej Kuranin të përkthyer në shqip, pastaj në vitet e ‘90 të njej të përkthyer “Sahihun e Buhariut” e kështu me radhë me veprat kapitale nga disiplinat e doktrinës islame, me vepra nga kultura, qytetërimi e trashëgimia islame.

Aq sa, sot, fatbardhësisht, vetëm në kuadër të edicioneve tona botuese janë botuara mbi 200 tituj në gjuhën shqipe, pa përfshirë këtu periodikun islam.

“Edukata Islame”, me sukses vazhdon misionin e saj edhe sot e kësaj dite, por tani me përmbajte e fizionomi të përshtatur për rrethanat e kohës. Nëse “Edukata Islame” në origjinë ishte vetëm revistë fetare, ajo me kalimin e kohës

mori edhe dimension kulturor e shkencor, dhe ka vite të tëra që ajo editohet si revistë shkencore, kulturore islame.

“Edukata Islame” prapa vetes ka histori të ndritshme, trashëgimi të begatë, ndikim në rritjen dhe zhvillimin e fjalës së shkruar islame tek ne.

Revista “Edukata Islame”, siç u theksua, është revista e parë islame në gjuhën shqipe që vepron 50-vjet pa ndërprerje, dhe lirisht mund të themi se “ajo është pasqyra më e mirë, historia më reale e krijimit të qarkut intelektual pranë Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht qarkut intelektual të Prishtinës.

Të nderuar pjesëmarrës

Për kontributin e Revistës sigurisht që më me kompetencë do të flasim studiuesit e fushave përkatëse, por mua më lejoni që në këtë përvjetor të “Edukatës Islame” të shprehi konsideratën time më të thellë dhe të gjitha institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës, por edhe të lexuesve tanë të çmuar, për drejtuesit, kryeredaktorët e para së gjithash, për kryeredaktorët Haxhi Sherif ef. Ahmetin e Hajrullah ef. Hoxhën, pastaj për kryeredaktorët Resul ef. Rexhepin, Qemajl Morinën si dhe kryeredaktorin aktual Sabri Bajgorën, të cilit me punën angazhimin dhe kontributin e tyre i dhanë jetë revistës, shkruan historinë e periodikut islam dhe kështu ne sot kemi në trashëgim një pasuri që s’ka çmim.

Po ashtu kujtojmë e ju jemi mirënjohës e falënderues të gjithë bashkëpunëtorëve që kontribuuan në rritjen dhe zhvillimin e revistës “Edukata Islame”. Mirënjohje edhe për lexuesit tanë që tërë kohën qenë dhe janë me “Edukatën Islame”. Pa ta, revista s’do të kishte kuptim dhe s’do të kishte jetë.

Sot po shënojmë përvjetorin e 50-të të veprimtarisë së revistës sonë të parë “Edukata Islame” me shpresën se revista që po hynë në dekadën e gjashtë do të vazhdoj edhe për shumë dekada misionin e saj.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës do mbështesë “Edukatën Islame” në rrugëtim e saj, ashtu siç e ka mbështetur edhe deri më tani.

Duke ju falënderuar për durimin, më lejoni që t’i uroj suksese Konferencës.

Ves-selamu alejkum e punë të mbarë!

Prishtinë, 15 dhjetor 2021

Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnav

Referati i kryeredaktorit së revistës "Edukata Islame", prof. Sabri ef. Bajgora, me titull "Edukata Islame – Tribunë e mendimit islam"

"Edukata Islame" ishte shkollë në vete për formësimin e elitës dhe ajkës intelektuale fetare

*I nderuari Myfti Tërnavaj,
Të nderuar studiues
Të nderuar të pranishëm*

Ky vit, 2021, është vit i dy përvjetorëve mjaft të rëndësishëm për Bashkësinë Islame të Kosovës. Fillimisht është ky i sotmi, pesëdhjetëvjetori i daljes në dritë të numrit të parë të revistës më jetëgjatë islame në trojet shqiptare - Edukatës Islame, revistë e cila akoma vazhdon të botohet sot e kësaj dite katër herë në vit, si dhe 70 vjetori i fillimit të punës së Medresesë "Alaudin" në Prishtinë.

Në vitin tashmë të largët 1971, këtu e 50 vite më parë, nga dëshira që në Kosovë të vihen bazat e një publicistike të qëndrueshme islame në Kosovë, Bashkësia Islame e atëhershme përkatësisht Shoqata e Ulemave, vendosën të themelonin

një revistë fetare me qëllim të vetëm që ta përcillnin mesazhin e dritës dhe të udhëzimit islam në formë të shkruar, në mesin e popullatës shqiptare të besimit islam në Kosovë, dhe përgjithësisht në hapësirat shqiptare, që atëbotë gjendeshin nën shtetin e ish-Jugosllavisë.

Ashtu siç pritej, Kryeredaktori i parë i revistës Edukata Islame u zgjodh Haxhi Sherif Ahmeti, i cili vuri bazat e publicistikës së mirëfilltë islame në shqip, në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë londineze. Sherif ef. Ahmeti, ishte njeri vizionar dhe një intelektual shumë largpamës, i cili afër vetes në rritjen e Edukatës do të tubonte ata pak kuadro që ishin në Kosovë e që njihnin mjaftueshëm kulturën e shkrimit në gjuhën shqipe, si Hajrullah Hoxha, Avni Aliu, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti, Jashar

Jashari, Ibrahim Spahiu, Qazim Qazimi e ndonjë tjetër. Në anën tjetër, Kosova kishte mjaftueshëm ulema e hoxhallarë që shquheshin për dije të thella e erudite në fusha të ndryshme islame, por që nuk kishin traditë të shkrimit në gjuhën shqipe, qoftë për shkak se ishin shkolluar në medresetë klasike në gjuhët orientale, ose qoftë edhe sepse kishin kultivuar dhe kultivonin shkrimin e gjuhës shqipe me grafi arabo-osmane.

Revista "Edukata Islame" shumë shpejt do ta bëhej prijatë e fjalës së shkruar islame në shqip, dhe u prit me shumë entuziazëm nga hoxhallarët dhe imamët e kohës. Edukata thjesht u shndërrua në një tribunë e vërtetë e mësimin dhe e kultivimin të mendimit islam në Kosovë dhe në të gjitha trojet shqiptare në ish-Jugosllavi.



“Edukata Islame” e pa dritën dhe rritën e saj në kohën më të vështirë, atëherë kur komunizmi ishte në kulmin e fuqisë dhe ajo mbijetoi, siç thamë, vetëm falë vullnetit dhe përpjekjeve të këtij grupi të vogël, por që kishin besim të plotë se fjala e shkruar islame shqip megjithatë do të triumfoje. Vetëm duhej prituri dhe pasur durim, dhe, koha e vërtetoi se ata patën të drejtë.

Revista Edukata Islame kaloi në tri etapa të rritës dhe zhvillimit të saj, nga themelimi më 1971 e deri në fund të viteve të 80-ta, pastaj ish-in vitet e rënda 90-99, dhe në fund, vitet nga 2000 e deri sot.

Sot, vështruar nga spektri analitik, mund të konstatojmë se me gjithë vështirësitë dhe sfidat me të cilat u ballafaqua “Edukata Islame” gjatë këtyre pesëdhjetë viteve, ajo arriti jo vetëm të mbijetojë, por edhe të trasojë rrugën e saj duke u bërë tribunë e vërtetë e shprehjes së mendimit islam. Prandaj, me plot të drejtë sot mund të thuhet se “Edukata Islame”, përgjatë këtyre 50 viteve, është histori e gjallë e kulturës sonë islame dhe kronikë e jetës sonë shpirtërore. Për këtë arsye, çdo hulumtues dhe studiues i zhvillimit të jetës fetare-islame në këto troje e ka vështirë të bëjë atë pa iu referuar “Edukatës Islame”.

Që në zanafillën e saj misioni i “Edukatës Islame” ishte hapja e rrugës dhe krijimi i hapësirës së duhur për njohjen e vlerave e virtyteve hyjnore, humane si dhe krijimin e hapësirës për emancipimin, përparimin dhe edukimin e drejtë e të duhur të masës së gjerë në frymën islame.

Tematikat e botuar në revistën “Edukata Islame” deri në fillim të viteve 90, i përkasin disiplinave fetare, si tefsir e akaid - rubrika këto thuhet të përhershme, të cilat i ka mbajtur myderrizi H. Sherif Ahmeti, pastaj kontribute nga ahlak, hadithi, fikhu etj. Duhet thënë se revista i kushtoi një rëndësi temave nga historia islame, ku spikasin autorët Hajrullah ef. Hoxha dhe Bajrush Ahmeti.

Një segment shumë i rëndësishëm i “Edukatës”, është edhe fakti se përmes përkthimeve nga gjuhë të huaja ka botuar edhe kontribute të penave të shquara të hapësirave ballkanike dhe të Botës Islame, si Sinanudin Sokolli, Husein Xhoza, Muhamed Gazali, Muhamet Tantavi, Jusuf Kardavi, Mustafa Mahmud, Hasan Kaleshi, Enes Kariq, Muhamed Sharavi etj.

Ndërsa në mesin e kuadrove që përgjatë këtyre 20 viteve të fundit i dhanë ngjyrë revistës me punimet e tyre janë Qemajl Morina, Resul Rexhepi, Nexhat Ibrahim, Miftar Ajdini, dr. Abdullah Hamiti, Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, autori i këtyre rreshtave, e së fundmi, kanë filluar të katapultohen në orbitën e kësaj reviste emrat si Ejup Haziri, Driton Arifi, Ekrem Maqedonci, Besim Mehmeti, Besir Neziri, Sedat Islami, Ilir Rruga, Feim Gashi, dhe shumë të tjerë që premtojnë një të ardhme të ndritshme të publicistikës islame në shqip.

Të nderuar të pranishëm!

Edukata Islame si revista e parë islame në gjuhën shqipe që nga fillimi i ka dhënë një vend meritore aktiviteteve fetare në vend. Një rëndësi të veçantë këtu i është kushtuar aktiviteteve të Medresës së Mesme “Alauddin”, ku thuhet në çdo numër, sidomos në ata të fillimit, gjejmë kronika e lajme që kanë të bëjnë me dhe për medresenë, për të diplomuarit dhe për rrugëtimet jetësore të nxënësve të saj, duke u bërë kështu edhe një kronikë e kohës.

Edhe nga vetë emri i revistës “Edukata Islame”, shihet se kjo revistë mëton në radhë të parë edukimin e mirëfilltë fetar të popullatës, dhe ishte shkollë në vete për formësimin e elitës dhe ajkës intelektuale fetare tek ne dhe më gjerë.

Ajo ishte pararendëse e shumë e shumë botimeve të tjera të cilat do të shihnin dritën përgjatë viteve të 80-90 dhe pastaj pas luftës në Kosovë, e ndër të tjera edhe i përkthimit të plotë të Kuranit në

shqip, sepse në faqet e Edukatës në vitet e 80-ta janë përkthyer dy suret më të gjata në Kuran, ajo El-Bekare dhe Ali Imran. Temat islame në gjuhën shqipe të botuara në “Edukatë...” po t’i vështrojmë del se kanë për synim që tek lexuesit të sjellin saktësisht përmbajtjen fetare, duke nisur nga parimet themelore islame e deri tek mendimi filozofik e shkencor islam, pastaj të paraqesin shpjegimet e duhura e kompetente të mendimeve të paraqitura, përfshirë këtu edhe shpjegimet plotësuese, të përcaktojnë elementet origjinale të përshkrimeve dhe të shpjegimeve, saktësinë gjuhësore të përmbajtjeve të përkthyer dhe të mendimeve origjinale të formësuar dhe të shprehura në gjuhën shqipe etj. Bazën e këtyre kontributeve të paraqitura në literaturën e botuar në “Edukata Islame” e kanë në burimet islame, në Kuranin e madhërisht dhe shpjegimin e tyre, pastaj Synetin e Pejgamberit a.s., që paraqiten në përkthimin e Haditheve në gjuhën shqipe.

Të theksojmë këtu edhe faktin se shkrimet e botuara nga fusha e islamologjisë në revistën “Edukata”, përveçse shënojnë hapin e parë në këtë fushë, sot ato paraqesin vlera të shtuara në literaturën islame në gjuhën shqipe dhe janë me rëndësi të posaçme për bibliotekën tonë, sidomos për qëllime hulumtuese, studime historike e kritike.

Në fund, duke mos dashur të marr më shumë nga koha Juaj, dhe duke ditur se studiuesit në seancat e këtyre dy ditëve do të merren më detajisht me historikun, rritën dhe zhvillimin e revistës Edukata Islame, unë në emër të Redaksisë do të doja të falënderoj të gjithë Juve që na nderuat me praninë tuaj në këtë përvjetor, e pastaj edhe të gjitha bashkëpunëtorët përgjatë këtyre 5 dekadave, që i dhanë krah rritës së kësaj reviste, dhe shumë prej tyre vazhdojnë të jenë akoma bashkëpunues të zellshëm e të palodhshëm. Ju falemdir! Sabri Bajgora

Fjala e Myftiut Tërnavë me rastin e seminarit shkencor me titull "Kontributi dhe veprat e Mehmet Akif Ersoj - Pejani" me rastin e 100 vjetorit të miratimit të himnit të Republikës së Turqisë

Mehmet Akifi është poet e intelektual i dy popujve

*Të nderuar të pranishëm;
I nderuari dekan i FSI-së;
Të nderuar drejtues të strukturave të BIK-ut;
Të nderuar pedagogë e studentë të FSI-së;
Vëllezër e motra!*

Kam kënaqësinë që sot, në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, t'u drejtohem në këtë tubim për ta kujtuar e vënë në pah kontributin e poetit të madh Mehmet Akif Ersojit, me rastin e 100 vjetorit të himnit kombëtar të Turqisë moderne, autor i të cilit ishte vetë Mehmeti.

Mehmet Akif Ersoji, me krijimtarinë e tij ka zënë vend meritore në antologjinë e intelektualëve e krijuesve të popullit turk, e në këtë rrafsh njihet dhe çmohet, e madje edhe merret për krenari edhe të popullit shqiptar. Pra, përderisa ai ka jetuar e krijuar në Turqi, gjë që e bën poet e intelektual turk, origjina e tij në të njëjtën kohë e bën edhe poet e intelektual tonë, apo thënë më mirë, Mehmet Akifi është poet e intelektual i dy popujve dhe si i tillë është në vargun e zinxhirit të gjatë intelektual shqiptarë, të cilët kanë kontribute të çmuara në kulturën turke, e njëkohësisht paraqesin një urë lidhëse të fortë ndërmjet popullit turk dhe popullit shqiptar.

Veprimtaria e Mehmet Akifit është shumëdimensionale, mirëpo këtë vit, e edhe në këtë rast, në këtë sesion, kujtohet para së gjithash me krijimin e tekstit të himnit turk dhe pikërisht



kjo e bën Mehmet Akifin të dashur e të respektuar, të nderuar e të vlerësuar nga populli turk. Bir yni, biri i këtij dheu, në një konkurs të hapur doli fitues për tekstin e himnit, andaj që atëherë e deri më sot, me vargjet e poetit tonë – poetit të dy popujve, nderohet flamuri, nderi, krenaria e shtetësia e Turqisë së madhe, moderne e demokratike.

Kështu, që një shekull, me gjithë fatet e ndryshme historike që patën dy popujt, Mehmet Akifi, ishte pika që bashkonte në mënyrën më të mirë dy popujt tanë, dhe kështu shprejsojmë që të jetë edhe në të ardhmen, duke njohur avancim e rritje të bashkëpunimit e bashkëveprimit. Formimi dhe edukimi i Mehmet Akifit e brumosën atë me njohuri të dijeve fetare, e sidomos të gjuhës arabe. Kjo vërehet edhe në krijimtarinë e tij poetike, ku

dominon fryma islame, madje shumë nga poemat e tij për moto kanë ajetet e Kuranit dhe hadithet e Pejgamberit Muhamed.

Mehmet Akifi, është poeti që në letërsinë turke e futi realizmin, përshkrimin e drejtpërdrejtë të ngjarjeve të përditshme, të jetës dhe me problemet e shumta që qau e vajtoi bashkë me myslimanët e përvuajtur e të persekutuar të gjithë botës. Prandaj, ai, u kërkoi myslimanëve që të zgjohen nga gjumi i thellë, ta luftojmë dembelinë e injorancën dhe thërret:

O popull, zgjohu, injorancës tënde po i bëhesh fli!

Edhe islamini po e merr me vete e po e shemb si ti! (Fletët, fq. 290)

Mehmet Akifi, përmes poezive, shkrimeve, ligjërimeve, qëndrimeve dhe ideve të tij, u mësoi shumë gjëra

muslimanëve, shoqërisë turke, shoqërisë ballkanase dhe të gjithë njerëzimit. Mehmet Akifi dha një kontribut të pazëvendësueshëm në luftën kombëtare që bëri populli turk për ta shpëtuar atdheun e tyre nga pushtuesit. Ai, përmes poezive, ligjëratave dhe shkrimeve të tij nëpër gazeta, inkurajoi dhe i dha mbështetje morale e shpirtërore popullit turk për të luftuar për këtë kauzë, çlirim dhe pavarësinë e tokave të tyre. Për këtë kontribut kaq të madh dhe me vlerë që dha poeti shqiptar, Mehmet Akif Ersoji u shpall nga populli turk “Heroi shpirtëror” i luftës kombëtare.

Fryma dhe motivet fetare ndjehen edhe te Marshi i Pavarësisë – poezia e Mehmet Akifit, të cilën më 12 mars 1921, Kuvendi Popullor Turk, zyrtarisht e shpalli himn kombëtar të Turqisë. Tema e Marshit të Pavarësisë është dashuria ndaj atdheut, lirisë dhe fesë, si edhe lavdërimi i virtyteve si shpresa, përkushtimi dhe flijimi në kërkim të lirisë, e cila sipas poetit do të lind shumë shpejt:

Do të arrijmë për ty ditët që Zoti t'i ka premtuar...

Kush e di? Mbase nesër, mbase më herët do të arrijmë! (Fletët, fq. 568)

Në këtë përvjetor, Mehmet Akifi, na rishfaqet edhe njëherë si vlerë e përbashkët kombëtare dhe shpirtërore e dy popujve, duke kujtuar e përcjell te gjeneratat e reja, sepse ai në mënyrën më të mirë përshkruan elementet themelore të unitetit dhe solidaritetit kombëtar, të dëshirës së popullit tonë për pavarësi, atdhe e flamur.

Me ç' rast mbillte shpresë se liria do të arrijë shumë shpejt dhe se nuk ka vend për pesimizëm e pikëllim. Përveç kësaj, Mehmet Akifi kishte

një lidhje të fortë e të madhe me trojet shqiptare, nga të cilat vinte babai i tij, Tahir Efendiu, i cili në moshën shumë të vogël, nga fshati Shushicë e Pejës shkoi në Stamboll për studime dhe i cili u bë një nga dijetarët më të njohur të kohës. Mehmet Akifi shprehu dhimbje e vuajtje për tokat shqiptare, të cilat mbetën pas vitit 1912 të okupuara nga fqinjët e tyre serb, grek e bullgar. Në këtë përvjetor, Mehmet Akifi, na rishfaqet edhe njëherë si vlerë e përbashkët kombëtare dhe shpirtërore e dy popujve, duke kujtuar e përcjell te gjeneratat e reja, sepse ai në mënyrën më të mirë përshkruan elementet themelore të unitetit dhe solidaritetit kombëtar, të dëshirës së popullit tonë për pavarësi, atdhe e flamur.

Për kontributin dhe veprimtarinë e Mehmet Akifit, më me kompetencë do të flasim studiuesit në seancat shkencore, e mua më mbetet t'ju falënderojë për durimin dhe përgëzojë organizatorët për këtë aktivitet që e forcon miqësinë ndërmjet dy popujve.

Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavë Prishtinë, 28 dhjetor 2021



Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (7)

Rrëfimi i Hudit me popullin e tij Adin

وَأذْكُرْ أَخَا عَادٍ إِذْ أُنذِرَ قَوْمَهُ بِالْأَحْقَافِ وَقَدْ خَلَتِ النُّذُورُ مِنْ
بَيْنِ يَدَيْهِ وَمَنْ خَلْفَهُ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ
عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿21﴾ قَالُوا أَجِئْتَنَا لِنَأْفِكَنَا عَنِ آلِهَتِنَا فَأْتِنَا
بِمَا تَعَدُّنَا إِنْ كُنْتُمْ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿22﴾ قَالَ إِنَّمَا الْعِلْمُ عِنْدَ
اللَّهِ وَأُبْلَغُكُمْ مَا أُرْسِلْتُ بِهِ وَلَكِنِّي أَرَأَيْتُمْ قَوْمًا تَجْهَلُونَ ﴿23﴾
فَلَمَّا رَأَوْهُ عَارِضًا مُسْتَقْبِلَ أُوْدِيَّتِهِمْ قَالُوا هَذَا عَارِضٌ مُّمْطِرُنَا
بَلْ هُوَ مَا اسْتَعْجَلْتُمْ بِهِ رِيحٌ فِيهَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿24﴾ تَدْمُرُ
كُلَّ شَيْءٍ بِأَمْرِ رَبِّهَا فَأَصْبَحُوا لَا بَصِيرًا إِنْ كُنْتُمْ إِلَّا مَسَاكِينُهُمْ كَذَلِكَ نَجْزِي
الْقَوْمَ الْمُجْرِمِينَ ﴿25﴾ وَلَقَدْ مَكَّنَّاهُمْ فِيمَا إِنْ مَكَّنَّاكُمْ فِيهِ
وَجَعَلْنَا لَهُمْ سَمْعًا وَأَبْصَارًا وَأَفْئِدَةً فَمَا أَغْنَى عَنْهُمْ سَمْعُهُمْ
وَلَا أَبْصَارُهُمْ وَلَا أَفْئِدَتُهُمْ مِنْ شَيْءٍ إِذْ كَانُوا يَجْحَدُونَ بِآيَاتِ
اللَّهِ وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿26﴾ وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا مَا
حَوْلَكُمْ مِنَ الْقُرَىٰ وَصَرَّفْنَا الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿27﴾ قَالُوا
نَصْرَهُمُ الَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ قُرْبَانًا آلِهَةً بَلْ صَلُّوا عَلَيْهِمْ
وَذَلِكُمْ إِفْكُهُمْ وَمَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿28﴾

“Kujtoje vëllain e fisit Ad (Hudin), kur e paralajmëroi popullin e vet në Ahkaf! Para dhe pas tij, pati paralajmërues, (kur u tha): “Të mos adhuronit asgjë tjetër veç Allahut! Unë, vërtet kam frikë se do t’ju godasë dënimi i Ditës së Madhe!” Ata i thanë: “Vallë, a ke ardhur të na largosh ne prej zotave tanë?! Na e sill tani atë (dënim) me të cilin na kërcënon, nëse thua të vërtetën!” Ai tha: “Dijeninë për të e ka vetëm Allahu, ndërsa unë po ju kumtoj vetëm atë për çka jam i dërguar, por unë po ju shoh se jeni popull injorant”. Dhe kur panë një re që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: “Kjo re do të na sjellë shi!” “Jo!” (tha Hudi), “Por kjo është ajo që ju e kërkoni me ngut. Është një erë (shtrëngatë) që mbart një dënim të dhembshëm, që, me urdhrin e Zotit të saj, shkatërron çdo gjë.” E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre (të zbrazëta). Ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës (zullumqarë). Ne u patëm mundësuar atyre gjëra (fuqi, pasuri, jetë të gjatë), që nuk jua mundësuar juve. Ne u dhamë atyre dëgjim, shikim dhe zemër, por atyre nuk u bëri dobi asgjë, as të dëgjuarit, e as të parit e as zemrat e tyre, e meqë mohonin argumentet e Allahut, i përfshiu ajo me të cilën talleshin. (Edhe më parë) Ne kemi shkatërruar vendbanime përrreth jush dhe ua kemi shpjeguar atyre Argumentet (Shpalljet) Tona, që ata të mund të ktheheshin (në rrugën e drejtë). (Atëherë) Përse nuk u erdhën atyre në ndihmë idhujt që i adhuruan si zota krahas Allahut, për t’u afruar tek Ai?! Përkundrazi, ata (idhujt) u zhdukën prej (syve të) tyre. Këto ishin vetëm gënjeshtra dhe shpifje të tyre (idhujtarëve).” – (El-Ahkaf, 21-28)

Lidhja e këtyre
ajeteve më ato
paraprake

Në ajetet paraprake, pamë qartë kërcënimin kundër jobesimtarëve dhe përfundimin e tyre të dhimbshëm në zjarrin e Xhehenemit, kurse tash në këto ajete, Allahu xh.sh. na sjell shembuj konkret të ndëshkimit të Tij në këtë botë ndaj popujve jobesimtarët e të poshtër, në të kaluarën. Nëse ajetet paraprake, flisnin për përfundimin në Xhehenem të këtyre të pabindurve, tash në këto ajete kemi tërheqje të vërejtjes, se para dënimit në Ahiret, jobesimtarët kryeneçë ndaj të vërtetës mund t’i godasë edhe dënimi tokësor,



ashtu siç e kishin përjetuar popujt e pejgamberëve të mëhershëm, e në rastin konkret populli Ad, te të cilët ishte dërguar Hudi a.s..

Koment:

21. Kujtoje vëllain e fisit Ad (Hudin), kur e paralajmëroi popullin e vet në Ahkaf! Para dhe pas tij, pati paralajmërues, (kur u tha): "Të mos adhuronit asgjë tjetër veç Allahut! Unë, vërtetë kam frikë se do t'ju godasë dënimi i Ditës së Madhe!"

Rëfimi i Hudit a.s. me popullin e tij Adin, është përmendur në disa sure kuranore: El Araf, Hud, Esh-Shuara, e në mënyrë të tërthortë është përmendur në suren El-Mu'minun dhe në këtë sure El-Ahkaf: "Kujtoje vëllain e fisit Ad (Hudin)". Madje edhe një sure e plotë e Kuranit, ajo e njëmbëdhjeta, është emërtuar me emrin e këtij pejgamberi - surja "Hud".

Sipas komentatorëve të Kuranit, përmendja e shpesh të rrëfimeve të pejgamberëve në Kuran, si ajo e Nuhit, Hudit, Salihut, Shuajbit, Lutit etj., prapa vetes ka një urtësi e cila shpërfaqet në disa dimensione, e një prej këtyre urtësive është qetësimi i zemrës së Muhamedit a.s., që të mos ligështohet e as të mos pikëllohet përgjatë misionit të tij të thirrjes. Allahu xh.sh. dëshiron ta vërë në dijeni, se edhe para tij, pejgamberët e Zotit nëpër kohë, u përgënjeshtruan nga popujt e tyre, por ata të dërguar, vazhduan stoikisht rrugën në të cilën i kishe urdhëruar Zoti i Plotfuqishëm.

Hudi a.s. ishte dërguar me mision pejgamberik, te populli i Adit shumë kohë pas Nuhit a.s.. Tashmë kishin kaluar gjenerata e gjenerata dhe njerëzit pothuajse kishin harruar porositë dhe këshillat e Nuhit a.s.. Shumë prej tyre iu rikthyen sërish adhurimit të idhujve, duke devijuar nga besimi i drejtë në Allahun Një. Mashtrimi i moçëm djallëzor po rikthehej sërish në skenë dhe populli i Hudit a.s. kishte rënë pre e këtyre intrigave djallëzore. Vendbanimi i këtij fisi ishte vendi i quajtur "Ahkaf". Ishte kjo një shkretëtirë që karakterizohej me duna rëre të pjerrëta, që zgjateshin deri në bregdet. Nga

këto duna rëre, ka ardhur edhe emri i kësaj sureje "El-Ahkaf", emërtim i cili është përmendur vetëm njëherë në Kuranin fisnik, pikërisht në këtë sure. Thuhet se vendbanimi Ahkaf është në Hadramevt të Jemenit. 1

Populli Ad ishin njerëzit më të mëdhenj të kohës së tyre nga konstrukti fizik, si nga gjatësia ashtu edhe nga forca. Ata ishin viganë e të fuqishëm dhe askush nuk ishte sikur ata në atë kohë. Por edhe pse ishin shtatartë, mendjet e tyre ishin të errësuar. Adhuronin idhujt dhe mbronin me ngulm këtë bindje të tyre, sa që verbëria që i kishte kapluar sytë dhe mendjet e tyre, nuk i linte të shihnin asgjë tjetër përveç mendjemadhësisë dhe fudullëkut të tyre. Për më keq, ata talleshin me të dërguarin e Allahut te ta, Hudin a.s., i cili po i thërriste në besimin e pastër: "Të mos adhuronit asgjë tjetër veç Allahut! Unë, vërtetë kam frikë se do t'ju godasë dënimi i Ditës së Madhe!"

Kjo thirrje e tij e sinqertë, është ripërsëritur në disa sure kuranore si f.v. në suren Hud, ajeti 50: "...O populli im adhuronit Allahun, ju nuk keni zot tjetër pos Tij, ju vetëm po hutoheni me trillime".

22. Ata i thanë: "Vallë, a ke ardhur të na largosh ne prej zotave tanë?! Na e sill tani atë (dënim) me të cilin na kërcënon, nëse thua të vërtetën!"

Një popull i mbrapshtë siç ishte Adi, ishin mashtruar nga fuqia e tyre, duke menduar se askush nuk mund të matet me ta, prandaj edhe i folën me arrogancë dhe në formë kërcënuese Hudit a.s.: A mos vallë ke ardhur të na largosh nga ata zota që i besuan edhe të parët tanë? Si ke guxim të akuzosh zotat tanë të cilët i adhuronin etërit dhe gjyshërit tanë?

Ata vazhdimisht talleshin me predikimet e Hudit a.s., prandaj me tone ironie e përqeshjeje i thanë: Ne nuk do të të besojmë ty në atë që po na thërrret, prandaj, sillna dënimin të cilin po pandeh se mund të na godasë. Ja ky ishte niveli i këtij populli të mbrapshtë. Meqë nuk po arrinin t'i kundërviheshin Hudit a.s. me argumente logjike, ata filluan ta përqeshnin dhe të kërkonin prej tij që t'ua sillte dënimin të cilin po ua premtonte. Çfarë mendjemadhësie,

çfarë mjerimi për cektësinë e mendjeve të tyre. E njëjta fjalë që nuk ndryshon te asnjë popull jobesimtar përgjatë historisë, të verbuar nga krenaria e tyre.

Duke mos besuar fare në mundësinë e një dënimi, ata nga Hudi a.s. kërkuan përshpejtimin e tij, duke qenë të bindur se një gjë e tillë është e pamundur të ndodhte. Kërkesë të tillë kishin bërë popujt e ndryshëm zullumqarë e jobesimtarë, 2 gjë të cilën e ka portretizuar edhe Kurani famëlartë në shumë ajete, si f.v.: "Ata kërkojnë shpejtimin e dënimit, dhe sigurisht Xhehenemi ka për t'i rrethuar jobesimtarët nga të gjitha anët" – (El-Ankebut, 54); "Dhe ata (jobesimtarët) thanë: "O Zoti ynë! Përshpejtoje pjesën tonë (të dënimit) përpara Ditës së Gjykimit" – (Sad, 16), etj..

Hudi a.s., edhe pas këtij përgënjeshtrimi dhe mospërfilljeje, sërish nuk po hiqte dorë nga këshillimi i tyre. Ai ua bëri të ditur se besimi dhe bindja se ekziston Dita e Gjykimit, besimi në ringjallje pas vdekjes, qëndrimi para Krijuesit për të dhënë llogari, e pastaj pranimi i shpërblimit ose i ndëshkimit dhe hyrja në Xhenet ose Xhehenem, që të gjitha këto janë çështje të cilat Allahu ka dashur t'i tërheq vëmendjen njerëzimit dhe t'i lidhë ata me faktin se pas jetës në këtë tokë, ekziston edhe jeta e përhershme e Ahiretit. Prandaj, ua përsëriste vazhdimisht atyre që mos t'i robëronte lakmia e as mos t'i pushonte egoizmi, sepse një ditë jeta e tyre do të merrte fund, e do të dilnin para Krijuesit të tyre për të dhënë llogari.

23. Ai tha: "Dijeninë për të e ka vetëm Allahu, ndërsa unë po ju kumtoj vetëm atë për çka jam i dërguar, por unë po ju shoh se jeni popull injorant".

Megjithatë, edhe përkundër të gjitha përgënjeshtrimeve, Hudi a.s. nuk u zmbars për asnjë çast. I mbështetur te Zoti Fuqplotë, me këtë iman të pastër e të patundur në Allahun, me bindje në premtimin e Tij, dhe besimin e thellë në ndihmën dhe ngadhënjimin nga ana e Tij, ai pa iu trembur fare syri po u fliste jobesimtarëve. Po e bënte gjithë këtë përkundër faktit se ishte i vetëm, i papërkrahje dhe i pafuqishëm, por

me vetëdije të plotë që me vete kishte fuqinë dhe sigurinë e vërtetë të Allahut, Fjalët e të Cilit po i përcillte-transmetonte.

Edhe pse para vetes kishte një popull të pabindur e arrogant, ai ua bëri të qartë se ky ndëshkim përshpejtimin e të Cilit po e kërkonin në tone ironike e shpotie, gjithsesi do të vinte, ndonëse për këtë është në dijeni vetëm Krijuesi Fuqiplotë. Ai me urtësinë e Tij e sjell atë kur të dojë, kurse detyrë e imja është vetëm t'ua përcjell mesazhin nga Zoti im dhe juaji, sepse për këtë gjë edhe jam dërguar te ju, por me sa po shoh, mendjet tuaja të errësuar, vështirë se do të këndellen ndonjëherë, sepse ju jeni një popull që fuqia dhe pasuria e juaj ua ka verbuar sytë dhe iu ka larguar nga e vërteta.

Kurani e ka përjetësuar këtë dëshmi të tij të sinqertë kur ai tha popullit të vet: "...Ai tha: "Unë dëshmitar e kam Allahun, e ju dëshmoni se unë jam larg nga ajo çka ju i shoqëroni. (larg adhurimit) Pos Tij. Ju pra, të gjithë përpikuni kundër meje e mos më jepni afat. Unë iu kam mbështetur Allahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim, vërtet Zoti im është i drejtë. Nëse kundërshtoni, unë ju kumtova atë me të cilën jam dërguar te ju. Zoti im do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, Atij nuk mund t'i bëni kurrfarë dëmi. Vërtet, Zoti im është përcjellës i çdo sendi." - (Hud, 54-57)

Hudi a.s. me fjalët e tij ua bëri me dije popullit të vet se tashmë e kishte kryer amanetin dhe ua kishte përcjellë mesazhin. Hudi a.s. nuk i kishte mbetur rrugë tjetër përveç tërheqjes së vërejtjes së fundit, e cila vërejtje përfshinte kërcënimin e tmerrshëm për të përgënjeshtuarit. Pasi që ata e kishin mohuar sërish, Hudi a.s. ua bëri me dije se Allahu në vend të tyre, do të bënte mëkëmbës dhe trashëgues të tokës, njerëz të tjerë. Kjo nënkuptonte faktin se ata do ta prisnin ndëshkimin hyjnor.³

Në këtë mënyrë, Hudi a.s. proklamoi haptazi shfaqësinë dhe distancimin e tij nga ata dhe nga zotat e tyre, duke u mbështetur në Allahun e Plotfuqishëm. Hudi a.s. e kuptoi se ndëshkimi mbi jobesimtarët



e popullit të tij do të ndodhte gjithsesi. Ky është një prej ligjeve të jetës, kur Allahu dënon jobesimtarët, sado të fuqishëm, të pasur, tiranë apo diktatorë të jenë.

24. Dhe kur panë një re që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: "Kjo re do të na sjellë shi!" "Jo!" (tha Hudi), "Por kjo është ajo që ju e kërkonit me ngut. Është një erë (shtrëngatë) që mbart një dënim të dhembshëm, 25. që, me urdhrin e Zotit të saj, shkatërron çdo gjë." E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre (të zbrazëta). Ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës (zullumqarë).

Ndëshkimi i Allahut për popujt jobesimtarë përgjatë historisë ndryshoi nga njëri te tjetri. Disa i shkatërroi me përmytje, disa me britma shurdhuese e disa me gurë që shkatërronin çdo gjë, ndërsa këtij populli, të Hudit a.s. ia kishte dërguar erën (frymën) si ndëshkim. Pas refuzimit të pejgamberit të Allahut, Hudi a.s., tokën e Ahkafit, e kishte pllakosur thatësia e madhe në çdo cep të saj. Për muaj të tërë nga qielli nuk kishte pikuar asnjë pikë e vetme

shiu. Dielli po përcëllonte pa mëshirë dunat e rërës së shkretëtirës, sa që edhe pemët e gjelbra kishin filluar të zverdheshin e të thaheshin e së bashku me të edhe të gjitha të mbjellat e tjera. Pas disa muajsh, befaz, qiellin mbi luginën e Ahkafit e mbuloi një re e madhe.⁴ Populli i Hudit u gëzua shumë dhe thanë: Më në fund, kjo re do të na sjellë shiun e shumëpritur. Por Hudi a.s. iu tha: Jo, kjo re nuk do t'ua sjell shiun që po dëshironi, por është erë që me vete bart dënimin e tmerrshëm të Allahut për Ju.

Pas asaj vape të madhe, tash filloi një acar dhe i ftohtë i ashpër. Erërat filluan të frynin me tërbim, sa që çdo gjë filloi të dridhej, pemët, bimët, burrat, gratë dhe tendat e tyre. Njerëzve filloi t'u ngjetej lëkura, mishi, eshtrat dhe palca. Erërat nuk kishin të ndalur, as natën e as ditën, e acari vetëm sa po shtoej.

Populli i Hudit a.s. morën arratinë. Shpejtuan nëpër tendat gjigante për t'u fshehur brenda tyre, ndërkohë që erërat e stuhishme po harliseshin si të çmendura duke shkukur e copëtuar tendat e tyre. Erërat rrëmbyese,

përveçqë shqyenin rrobat e tyre, copëtonin e çanin edhe lëkurat e tyre, duke depërtuar në çdo pore dhe vrimë të trupit, e duke shkatërruar çdo gjymtyrë deri në palcë. Këto erëra të tërbuara, me lejen e Zotit, çdo gjë që preknin, e mbytnin pa mëshirë, e shkatërronin duke ia tharë zemrën e duke e bërë hi e pluhur. Këto erërat të dërguara si ndëshkim ndaj popullit të Hudit a.s. vazhduan pandërprerë për shtatë net e tetë ditë, net e ditë të cilat kurrë më parë s'i kishin përjetuar njerëzimi.⁵

Allahu xh.sh. në kaptinën El-Hakkah thotë: "Ndërsa Adi u shkatërrua me një stuhi të fuqishme e të zhurmshme, që Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht. Sikur t'i shihje njerëzit që shembeshin përdhe si të ishin trupa hurmash të zgavruara (kalbura)." - (El-Hakkah, 6-7)

Nga populli i Hudit a.s. nuk mbijetoi asnjë prej jobesimtarëve. Ata ishin kalbur sikur që kalben trupat e tharë të palmave. Kishin mbetur vetëm si mbështjellës i jashtëm. Sapo ta prekje ndonjë prej këtyre trupave, ai shkapërderdhej në ajër në mija grimca. Hudi a.s. dhe ata të paktët që i besuan Allahut shpëtuan, kurse u shkatërruan tiranët dhe mendjemëdhenjtë.

26. *Ne u patëm mundësuar atyre gjëra (fuqi, pasuri, jetë të gjatë), që nuk jua mundësua juve. Ne u dhamë atyre dëgjim shikim dhe zemër, por atyre nuk u bëri dobi asgjë, as të dëgjuarit, e as të parit e as zemrat e tyre, e meqë mohonin argumentet e Allahut, i përfshiu ajo me të cilën talleshin.*

Ky ajet u drejtohet idhujtarëve të Mekës si formë qortimi dhe tërheqje e vërejtjes, se populli i Adit që e shkatërruan me ndëshkim të tmerrshëm, ishte shumëfish më i fuqishëm sesa ju, shumëfish më të pasur se ju, me jetëgjatësi të pakrahasueshme me ju⁶ dhe me begati të pakufishme të Allahut, dhe ndonëse i kishim pajisur me dëgjim, shikim e me dije, ata megjithatë, refuzuan udhëzimin e Allahut dhe u ndëshkuan për mohimin e tyre. Ata u tallën me mesazhin hyjnor që ua përcollti vëllai i tyre Hudi a.s., prandaj mbetën për-

jetësisht në histori si popull keqbërës dhe ngatërrestar, që përjetuan ndëshkimin e Allahun edhe në këtë botë, e në botën tjetër do të jenë përjetësisht në zjarr të Xhehenemit.

27. *(Edhe më parë) Ne kemi shkatërruar vendbanime përreth jush dhe ua kemi shpjeguar atyre Argumentet (Shpalljet) Tona, që ata të mund të ktheheshin (në rrugën e drejtë).*

Edhe ky ajet vazhdon me qortimin e mekasve, që të kthjelleshin nga verbëria që i kishte pllakosur e të merrnin mësim nga fati i keq i popujve që ishin në fqinjësi të tyre që ishin shkatërruar me ndëshkime të tilla hyjnore. Të tillë ishin populli i Shuajbit në Medjen, populli i Salihut, shumë afër tyre, pastaj populli i Lutit te Deti i Vdekur, populli i Sabeit në Jemen,⁷ gjurmët e shkatërrimit të të cilëve, kurejshët i shihnin vazhdimisht gjatë udhëtimeve të tyre tregtare dimrit dhe verës. Allahu i Madhërihëm, ua bën me dije idhujtarëve mekas se ashtu sikur juve, edhe atyre popujve u dërguan udhëzimet tona, që të përdhën në rrugën e drejtë, por refuzuan dhe pësuan poshtërim në këtë botë, e do të jenë të poshtëruar përjetësisht edhe në Ahiret.

28. *(Atëherë) Përse nuk u erdhën atyre në ndihmë idhujt që i adhuruan si zota krahas Allahut, për t'u afruar tek Ai?! Përkundrazi, ata (idhujt) u zhdukën prej (syve të) tyre. Këto ishin vetëm gënjeshttra dhe shpifje të tyre (idhujtarëve).*

Pyetjet ndaj idhujtarëve mekas, por edhe ndaj mohuesve të çdo kohe vazhdojnë në formën ironike se përse ata idhuj dhe zota të rremë, nuk iu erdhën në ndihmë popullit të Hudit, që ishin populli më i fuqishëm në fytyrë të Tokës. Nëse ata idhuj ishin kaq të fuqishëm e me kaq ndikim, përse nuk i shpëtuan dot popullin e Hudit nga hidhërimi dhe ndëshkimi i Allahut, por nuk u panë gjëkund.⁸ Këto ajete, do të duhej t'u shërbenin si mësim kurejshëve dhe idhujtarëve të tjerë, që të mos e refuzonin udhëzimin e Allahut, por të pranonin ftesën e sinqertë të Muhamedit a.s., për t'i

shpëtuar nga errësitat e kufrit në dritën dhe mirësinë e të Madhit Zot.

Sidoqoftë, është vërtetuar sa e sa herë nga pësimet e popujve mëkatarë e të prishur, se besimi i tyre në idhuj, ishte i bazuar në gënjeshttra, shpifje e blasfemi ndaj të vërtetës, andaj edhe ndëshkimi hyjnor nuk vononte.

Porosia e këtyre ajeteve

- Rëfimi i Adit, popullit tek i cili u dërgua Hudi a.s. është një prej ngjarjeve me ndikimin më të madh në tërë Kuranin fisnik. Peripecitë e këtij Pejgamberi të Allahut janë përmendur në disa sure kuranore. Ngjarjet e tilla të shkatërrimit të popujve të kaluar, prapa vetes lënë mësim dhe tërheqje të vërejtjes për njerëzit të cilëve iu drejtohen, në këtë rast idhujtarëve mekas, dhe të gjithë atyre që do të vijnë pas tyre me mohim e rebelim ndaj të së vërtetës.

- Kryeneçësia e popullit Ad në refuzimin e udhëzimit të Allahut, bëri që ata të ndëshkoheshin me dënim të tmerrshëm në këtë botë. Fat të tillë kishin pasur shumë popuj para dhe pas tyre.

- Erërat të cilat u dërguan si ndëshkim për ta shkatërruar popullin e Hudit a.s., janë ushtri prej ushtrive të shumta të Allahut.

- Sado që kufri dhe e keqja të jetë të fortë, fundin e kanë humbje dhe shkatërrim, sepse besimi i pastër në Allahun, gjithmonë do të ngadhënjejë ndaj kotësisë dhe injorancës. - *vijon* -

1. Et-Tefsiru-l Munir, 26/322. 2 Et-Tes'hil li te'vili-t-tenzil - Tefsir Xhuz'u-l Ahkaf fi sualin ve xhevabin, f. 54. 3. Ahmed Behxhet, Të Dërguarit e Allahut, Prishtinë, 2009, f. 107. 4. Ebul Hasen Alij ibn Feddal El-Muxhashi 'ij, En-Nuket fi-l Kurani-l Kerim, Bejrut, 2007, f. 447. 5. Et-Tefsiru-l Vesit li-l Kurani-l Kerim, Grup i përzgjedhur nga dijetarët e Az'harit, Kajro, 1992, vëll. 8-10, f. 929. 6. El-Imam Ebu Ishak Ahmed, i njohur si El-Imam Eth-Tha'lebi, El-Keshfu ve-l Bejan, (redaktuar nga Muhamed Ibn Ashur), Bejrut, 2002, vëll. IX, f. 18. 7. Ibn Adil ed-Dimeshki, El-Lubab fi Ulumi-l Kitab, Bejrut, 1998, vëll. XVII, f. 411. 8. Fi Rihabi-t-Tefsir, vëll. 26. f. 5568.

Dr. Ajni Sinani

Pse nuk gjejmë në Kuran tregime për Muhamedin a.s.?

Mbase shumë njerëz që nuk e njohin Islamën do të prisnin të gjenin në Kuran tregime për situatat e vështira me të cilat që ballafaquar i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., si vdekja e bashkëshortes (Hadixhes) apo vdekja e djemve dhe e vajzave të tij, mirëpo në të nuk gjendet diçka e tillë.

Nëse Muhamedi a.s. do të ishte një pretendues, pse në Kuran nuk përmendet asgjë për vendin e lindjes të Muhamedit a.s., për fëmijërinë, adoleshencën, rininë e tij dhe as për atë që i ndodhi në dyzet vitet para se të vinte shpallja!

Njeriu për nga natyra e tij ndikohet nga mjedisi, shoqëria, kultura dhe ajo që sheh përreth tij. Prandaj është dashur që ta shohim Pejgamberin a.s. duke folur për atë që ai shihte dhe dëgjonte nga trashëgimia dhe mendësia e poezive para-islamike, të luftërave dhe tregimeve të panumërta në kohën para-islamike. Kurani nuk përmend asnjë prej tyre! Madje, ku është rrëfimi i Pejgamberit a.s. për veten e tij në Kuran? A është normale kjo?

Nëse Kurani Fisnik do të ishte libër i Muhamedit a.s., pse ai nuk i përmendi asnjëherë me emër shokët e tij më të dashur si Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin, Aliun etj.?!
 Ku është hazreti Hatixheja r.a. që qëndroi me të në kohërat më të vështira dhe duroi në vuajtje, rrethim dhe uri? Pse nuk e përmendi emrin e Hatixhes goftë edhe një herë nëse ai do të ishte autor i Kuranit?!

Ku janë vajzat e Pejgamberit? Pse ai nuk e përmendi kurrë ndonjërin prej tyre? Ku është nëna e tij, Emine? Asnjë përmendje e saj! Madje, në Kurandin fisnik ekziston një sure e tërë në emër të Merjemit a.s., nënës së Isait a.s.

Me të vërtetë është e çuditshme të gjejmë një libër për të cilin skeptikët dhe dyshuesit thonë se është shkruar nga Muhamedi a.s. dhe aty nuk gjen një sure të emëruar në emër të hazreti Emine, në



emër të h. Hatixhes, në emër të h. Aishes ose një sure me emër të h. Fatimes.

Ndërkaq, gjejmë një sure të emëruar Merjem!

Nëse Muhamedi a.s. do të ishte autori i Kuranit Fisnik, a nuk është logjike që ai t'i anashkalonte dhe të mos i përmendte pejgamberët më të afërt të kohës së tij, veçmas Isain a.s., në mënyrë që njerëzit ta harronin atë?¹

Mirëpo në Kuran Isai a.s. përmendet 25 herë. Kurse Muhamedi a.s. përmendet vetëm pesë herë! Katër herë me emrin Muhamed dhe një herë me emrin Ahmed.

Dr. Gary Miller, autori i "Kurani i Mrekullueshëm", thotë:

"Kur lexova për herë të parë Kurandin, prisja të gjeja fjalë për shkretëtirën, zakonet dhe traditat lokale në atë mjedis të thjeshtë të shkretëtirës. Prisja të lexoja për disa ngjarje të vështira që kishte kaluar Pejgamberi Muhamed a.s., siç është vdekja e gruas së tij Hadixhes r.a. ose vdekja e vajzave dhe djemve të tij, por nuk gjeta asnjë prej tyre.

Ajo që më hutoi dhe më bëri të hamendësohem në çështjen time ishte se gjeta një sure të plotë në Kuran, të quajtur Merjem, ku flitej me respekt për Merjemin a.s., gjë që nuk ekziston në librat e të krishterëve apo në Biblat e tyre!

Në të njëjtën kohë, nuk gjeta një sure me emrin e Aishes r.a., apo me emrin e Fatimes r.a.

Gjithashtu, zbulova se Isai/Jezusi, paqja e Allahut goftë mbi të, ishte përmendur 25 herë në Kuran, ndërsa Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi

qofshin mbi të, përmendej vetëm 5 herë, kështu që konfuzioni im u rrit!"²

Të shtojmë gjithashtu se Musai a.s. është përmendur në Kuran më shumë se 130 herë!

O skeptikë dhe dyshues, pse u desh që Muhamedi a.s., i cili ishte në Mekë, të përmendte 130 herë Musain në Egjipt, i cili kishte jetuar dy mijë vjet para tij?!

Do të mjaftonte që Muhamedi a.s. ta përmendte Musain a.s. një ose dy herë, pastaj në pjesën tjetër të Kuranit të fliste për veten e tij, për familjen dhe shokët e tij, për historinë e Mekës dhe trashëgiminë e saj, për poetët e periudhës para-islamike, si Imrul Kajs dhe Antara dhe poezitë e tyre.

Këto poezi vlerësoheshin nga njerëzit e epokës para-islamike deri në atë shkallë sa ato u quajtën mualakat – të varura, ngase zemrat e

njerëzve të epokës para-islamike ishin të varura dhe të lidhura me ato poezi dhe ishin poezi që shkruheshin në muret e Qabesë.

Natyrë e shpirtit njerëzor është që ai të flasë për ato që sheh dhe dëgjon. Por ajo që prezantoi dhe solli Kurani është në kundërshtim me ato që Muhamedi a.s. pa dhe dëgjoi. Padyshim kjo është dëshmi se Kurani i Shenjtë është nga Zoti i Plotfuqishëm.

1. Matematicienti Gary Miller, i cili u përpoq të argumentonte "gabimet" në Kuran, përfundoi duke pranuar Islamën!, shih: <https://ekuiliber.com/2020/01/17/matematicienti-gary-miller-u-perpoq-te-argumentoj-gabime-ne-kuran-perfundoi-duke-pranuar-islam-in>. 2. Gary Miller, Kurani i mrekullueshëm (1), Dituria Islame, Revishtë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 367, viti 34, Prishtinë, Qershor 2021, Dhul Ka'de, f.43.

Mr. Fatmir Hadri

Roli i Pejgamberit a.s. në sigurimin e unitetit social

A shtu siç u përpoq Pejgamberi a.s. ta përhapte besimin e teuhidit në mesin e njerëzve, i cili rregullon marrëdhënien ndërmjet Allahut dhe njeriut, ai gjithashtu u përpoq të përhapte edhe unitetin ndërmjet shoqërisë.

Kjo përpjekje e Pejgamberit a.s. nuk është kufizuar vetëm në periudhën e Islamit. Ai, para se të emërohej si pejgamber, ndërmori hapa për sigurimin e unitetit dhe solidaritet shoqëror edhe gjatë periudhës së injorancës. Ai në këtë drejtim, për të kontribuar në unitetin shoqëror u angazhua në punë dhe aktivitete të ndryshme si “Anëtarësimi në organizatën Hilfu'l-fudul”, arbitrazhi - gjykimi për rindërtimin e Qabesë dhe projekti për vëllazërim.

Anëtarësimi në organizatën “Hilfu'l-fudul”

Luftërat e bëra në muajt e ndaluar, arabët i quanin “luftëra fixhar” – “luftëra mëkatore”. Luftërat fixhar kanë ndodhur katër herë. Në luftën e zhvilluar ndërmjet fiseve Kurejsh dhe Kinane, nga njëra anë, dhe fisit Hevazin, në anën tjetër, pati marrë pjesë edhe Pejgamberi a.s..

Ai pati marrë pjesë gjithmonë vetëm në anën e së drejtës, në krah të të drejtës dhe viktimës. Në këtë luftë ai ishte në moshën njëzetvjeçare, së bashku me të ungjin, por nuk derdhi gjakun e askujt. Vetëm mblodhi

shigjetat e hedhura nga armiku dhe ua dha ungjijve.

Organizata “Hilfu'l-fudul” e nisi veprimtarinë për mbrojtjen e të drejtave të të shtypurve. “Hilfu'l-fudul” është e vetmja organizatë e kohës pagane para islamike që i Dërguari i Allahut a.s. e ka miratuar dhe ka marrë pjesë në të, sepse kjo ishte një organizatë që mbronte drejtësinë. Ajo ishte ngritur për ta penguar padrejtësinë dhe dhunën. Pas pejgamberisë, Pejgamberi a.s. është shprehur kështu për këtë organizatë: “Kam marrë pjesë së bashku me ungjit e mi në Hilfu'l-fudul në shtëpinë e Abdullah bin Xhudasë. Aq i kënaqur mbeta nga ai kuvend, sa nuk do të mbetesha i kënaqur e i gëzuar edhe sikur të më falnin deve të kuqe në vend të tij. Edhe sikur të thirresha përsëri sot për një marrëveshje të tillë, do të merrja pjesë.”²

Arbitrazhi për rindërtimin e Qabesë

Në Mekë pati ndodhur një shtrëngatë, një përmytje, e si pasojë e saj Qabeja qe dëmtuar mjaft. Pas kësaj, fiset vendosën të punonin së bashku për ta meremetuar Qabën. Në meremetimin e Qabesë mori pjesë edhe Pejgamberi a.s. së bashku me të ungjin Abasin. Por, kur erdhi puna për ta vënë në vend Gurin e Zi, meqë secili fis kërkonte ta kishte vetë nderin për një gjë të tillë, u shkaktua një grindje e madhe. Ndërmjet tyre nisën konflikte të ashpra. Çështja u kthye në smirë dhe pasion. Ishte gati të derdhej gjak. Të bijtë Abdudar sollën një çanak plot me gjak, bënë marrëveshje me të bijtë Adij bin Ka'b se do të luftonin gjer në vdekje dhe u përgatitën për të luftuar. Dhe, për t'i përforcuar betimet e tyre, i ngjyen



duart me gjak. Kjo gjendje e tensionuar vazhdoi për katër-pesë net.

Më në fund, më plaku i Kurejshve, Ebu Umejje, u foli me zë të lartë: “O fisi im! Ne duam vetëm të mirën, nuk duam të keqe! Mos hyni në garën e zilisë për këtë gjë! Lëreni zënien! Meqë këtë çështje nuk mundëm ta zgjidhnim mes nesh, le ta caktojmë gjykatës mes nesh të parin njeri që ka për të hyrë tani nga porta e Qabesë dhe ta pranojmë vendimin e tij.” Dhe tregoi me dorë portën Beni Shejbe të Qabesë. Mu në ato fjalë, u duk në portë Muhamedi a.s.. Fytyrën e secilit e mbuloi një buzëqeshje lehtësimi, se ai që po hynte e që do të bëhej gjykatës mes tyre, ishte Muhamed Emini, Muhamedi i besueshëm! Dashuria, respekti dhe besimi i Kurejshve për të ishte shtuar e forcuar çdo ditë e më tepër.

Prandaj, sapo e panë, Kurejshët thanë: “Ja, el-Emini! Të gjithë jemi dakord që ai të gjykojë mes nesh!” Dhe ia treguan se si qëndronte çështja. Ai zgjodhi nga një person prej çdo fisi, pastaj hoqi mantelin e vet dhe e shtroi përdhe dhe urdhëroi që Gurin e Zi ta vendosnin në mes. Pastaj u tha njerëzve të zgjedhur prej çdo fisi që ta kapnin secilin rrobën në një cep. Guri i Zi u bart nga të gjithë. Kurse në vend e vendosi Muhamedi a.s. me duart e tij. Kështu u parandalua një grindje e mundshme ndërmjet fiseve.

Falë moralit të tij të mirë, besueshmërisë dhe personalitetit të ndershëm që kishte fituar besimin e një shoqërie politeiste, e cila nuk njihte të drejta dhe ligje, Pejgamberi a.s., parandaloi konfliktin duke vepruar si arbitër në mosmarrëveshjen ndërmjet tyre. Kjo sjellje e Pejgamberit a.s. është një qëndrim që duhet të merret si shembull për të gjithë myslimanët, veçanërisht myslimanët që jetojnë në shoqëritë jomyslimane. Bazuar në faktin se Pejgamberi a.s. ishte arbitër ndërmjet politeistëve, mund të thuhet se pavarësisht se në cilën shoqëri jetojnë, myslimanët nuk duhet të largohen nga e vërteta, drejtësia dhe ndershmëria dhe se ata duhet t'i japin rëndësi unitetit shoqëror më shumë sesa konflikti social.

Projekti për vëllazërim

Në përgjithësi, ekzistojnë katër lloje të vëllazërisë. Vëllazëria njerëzore, vëllazëria e gjakut, vëllazëria e qumështit dhe vëllazëria e fesë.³ Feja islame, anëtarët e saj i shpall si vëllazër fetarë në përputhje me ajetin “Në të vërtetë, besimtarët janë vëllazër”⁴ dhe favorizoi vëllazërinë fetare ndaj vëllazërive të tjera.

Pas migrimit të Pejgamberit a.s. në Medine, një nga problemet më të rëndësishme ishte integrimi i mekasëve në shoqërinë e medinasëve, kjo sepse mekasit do ta kishin vështirë të mësoheshin me klimën e Medinës dhe të integroheshin me shoqërinë në Medinë. Për këtë arsye, një nga gjërat e para që Pejgamberi a.s. bëri kur emigroi në Medine ishte zbatimi i projektit të vëllazërimit ndërmjet muhaxhirëve të Mekës dhe ensarëve të Medinës.⁵

Se çfarë vëllazërie të fort krijoi Pejgamberi a.s. në mes muhaxhirëve të Mekës dhe ensarëve të Medinës shihet më së miri në luftën e Bedrit. Si rezultat i vëllazërimit, muhaxhirët dhe ensarët u shkrinë dhe u integruan me njëri-tjetrin, derisa u bënë një trup, u formua një identitet i përbashkët mes tyre dhe u arrit një unitet i mentalitetit. Kjo në përhapjen e Islamit i ka ndihmuar myslimanët jashtëzakonisht shumë për të siguruar integritet kundër armikut brenda dhe jashtë.

Prandaj historia e vëllazërimit në mes muhaxhirëve dhe ensarëve përbën një shembull që nuk mund të gjendet në histori. Kjo praktikë e Pejgamberit a.s. hedh dritë mbi qëndrimin e myslimanëve në solidaritet, bashkëpunim dhe unitet në kohë të vështira dhe të trazura.

Uniteti për edukim dhe trajnim

Një çështje tjetër që Pejgamberi a.s. e theksoi për sigurimin e unitetit shoqëror është uniteti për arsim dhe trajnim, ngase sigurimi i unitetit dhe solidaritetit në shoqërinë e formuar nga njerëz që besojnë në të njëjtat

vlera është më i lehtë. Për këtë arsye, edhe në kushte shumë të vështira, Pejgamberi a.s. u përpoq të integrojë shoqërinë islame përmes edukimit dhe trajnimit me qendrat arsimore që krijoi si në Mekë, ashtu edhe në Medinë pas migrimit.

Qendra e parë arsimore-trajnuese “Daru'l-Erkam”

“Daru'l-Erkam” është emri i qendrës që Pejgamberi a.s. krijoi për edukimin dhe trajnimin e myslimanëve të parë. “Daru'l Erkam” (porta ose shtëpia e Erkamit) e njohur si “Daru'l Islam” (porta ose shtëpia e Islamit), ndodhej pranë kodrës Safa. Duke u ruajtur nga politeistët mekas, Pejgamberi a.s. shkante në këtë shtëpi, u fliste për Islamin të ardhurve, u këndonte Kuran dhe u fliste për përmbajtjen dhe kuptimin e tij. Të pranishmit aty falnin namaz së bashku, dhe shumë njerëz aty u njohën me Islamin.

Prandaj i Dërguari i Allahut a.s. është një udhërrëfyes i cili na paraqet shembujt idealë në fushën e edukimit dhe trajnimit. Bashkimi i njerëzve që ndajnë të njëjtin besim dhe mendim rreth një qendre është ndër përparësitë e të gjitha lëvizjeve që duan të arrijnë transformimin shoqëror. Një nga aktet e para të Pejgamberit a.s. në shoqërinë mekase, e cila ishte në prag të politeizmit, ishte krijimi i një qendre ku ai mund të përcillte me lehtësi vargjet e Kuranit te myslimanët. Pra krijimi i një qendre të tillë, Pejgamberit a.s. ia mundësoi më lehtë stërvitjen e besimtarëve të tij mendërisht dhe shpirtërisht.

Shkolla “Suffa”

Një nga institucionet e para që Pejgamberi a.s. themeloi kur emigroi në Medine ishte shkolla “As'habu Suffa” (shokët e sofas). Në këtë qendër u edukuan dhe arsimuan sahabët, ku më vonë u bënë perso-

nalitete shumë të rëndësishëm në historinë islame. Në këtë shkollë, sahabët merrnin një edukim të nivelit të lartë e pothuajse të sforsuar. Kështu, sahabët që kanë përcjellë më shumë hadithe (të quajturit mukthirun), përgjithësisht kanë dalë prej tyre. Më i shquari prej tyre, Ebu Hurejre, thotë kështu: “Njerëzit thonë me çudi se Ebu Hurejre përcjell shumë hadithe! Mirëpo, ndërsa vëllezërit tanë muhaxhirë ishin të zënë me tregti në treg, vëllezërit ensarë, me bujqësi e pemëtarë në arë e në kopshte, Ebu Hurejre që kishte hall vetëm të mos mbetej pa ngrënë, ndodhej pranë të Dërguarit të Allahut, bëhej dëshmitar i sa e sa gjërave që ata s’i përjetonin dot, mësonte përmendësh gjëra që ata s’i mësonin dot!”⁶

Duke u nisur nga këto fakte që u treguan më lartë, kuptohet se Pejgamberi u përpoq të siguronte kohezion shoqëror gradualisht, duke marrë parasysh nevojat dhe përparësitë e shoqërisë në proporcion me mjetet dhe fuqinë e tij.

Sot, njerëzimi në përgjithësi dhe myslimanët që jetojnë në pjesë të ndryshme të botës janë në depresion të madh. Pushtimi i tokave islame, situata e myslimanëve që jetojnë si pakica në shtetet jomyslimane, paqëndrueshmëria politike në vendet islame, ndarjet mendore, ndarjet shoqërore, problemet ekonomike dhe problemet e migrimit dhe refugjatëve ndërkombëtarë qëndrojnë para nesh si probleme të rëndësishme me të cilat përballen myslimanët. Strategjitë dhe metodat që Pejgamberi a.s. ndoqi kur ishte i dobët dhe i fortë do t’i shpëtonin myslimanët në kapërcimin e të gjitha këtyre problemeve.

1. Aleanca për mbrojtjen e të drejtave. 2. *Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 295.* 3. *Saffet Köse, “Kardeşlik Hukuku Fıkah Boyutu, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 123.* 4. *Huxhurat, 10.* 5. *Ibën Hisham, Sire, 433-435.* 6. *Buhariu, Ilm, 42.*

Mr. Driton Arifi

Vakëflënësi dhe implikimi i të drejtave të trashëgimtarëve të tij

Njëra prej çështjeve që Ligjvënësi i Drejtë i dha hapësirë të gjerë në Librin e Tij - Kuranin fisnik është edhe bartja dhe kalimi i pasurisë prej një brezi te një brez tjetër, pra transferimit të saj nga brezi i kaluar deri te brezi i ardhshëm.

Dhe meqë pasuria është një çështje që lakmia e njerëzve rreth saj është shpeshherë e shfrenuar dhe e pakontrollueshme, Allahu mori përsipër që shumë prej dispozitave e normave juridike që ndërlidhen me shpërndarjen e pasurisë, t’i shtjellojë e t’i detajojë Vetë Ai.

Kështu që edhe kur çështja ndërlidhet me vakëflënësit, me gjithë dëshirën dhe aspiratën e çiltër që ata kanë për të lënë pas vetes një fon-

dacion rrjedhës, nga i cili do të përfitojnë shpërblime edhe pas vdekjes së tyre, prapë edhe këtu ka disa kodifikime juridike islame që duhen sqaruar për ta, në veçanti ato që rregullojnë raportin e tyre me trashëgimtarët që ata po i lënë pas vetes.

Fillimisht, për të qenë vakëflënia e ligjshme, vetë vakëflënësit duhen plotësuar disa kushte apo kriteret të cilat kanë relevancë shkencore që t’i theksojmë këtu. Ato kushte janë:



a) Që personi të jetë pronar i asaj pasurie që po dëshiron ta lejë si vakëf. Ngase asnjë njeri nuk mund të shprehë zemërgjerësi me djersën e huaj e as me pasurinë e tjetrit.

b) Që vakëflënësi të jetë i lirë nga robëria por edhe i lirë – jo i imponuar nga çfarëdo lloj trysnie a presioni që do të mund ta shtynte pronarin në formë abuzive deri te ndonjë vakëflënie e padëshiruar.

c) Që të jetë i mençur mentalisht dhe në moshën madhore, kështu që nuk lejohet që as i çmenduri e as i mituri të lejë diç nga pasuria e tyre vakëf. Ata nuk kanë kompetencë juridike që të zhvillojnë ndonjë aktivitetet në pasuritë e tyre sepse nuk perceptojnë pasojat e veprimeve që ata i bëjnë. Në fakt, janë kujdestarët e tyre – tutorët ata që konsiderohen mbikëqyrës të asaj pasurie.

d) Që të ketë pjekuri të mjaftueshme ose kompetencë juridike, e të mos jetë person që njihet për pakujdesinë e mendjehetësinë e tij në shpenzime të pasurisë e të parasë së tij. Pra, pos për shkak të çmendurisë, një person mund të jetë jo kompetent edhe për shkak të pamaturisë e mendjehetësisë që e bëjnë atë të rrezikojë atë që të tjerët kanë grumbulluar nga pasuria dhe tashmë ai e ka në pronësi, apo edhe atë pasuri që vetë ai ka mundur eventualisht që ta ketë fituar në ndonjë formë të ligjshme.

e) Që vakëflënësi të mos jetë person që i është bllokuar pasuria për shkak të obligimeve financiare ose borxheve të tij të shumta.

E këtu duhet theksuar faktin që dijetarët islamë e kanë futur edhe borxhliun e kapitulluar ose falimentuar, i cili edhe nëse do që të lejë ndonjë pjesë të pasurisë si vakëf, atij nuk do t'i lejohej një gjë e tillë. Është kështu, sepse ajo pasuri, apriori duhet që të shpenzohet në kryerje të borxheve të personit në fjalë, e s'ka hapësirë aty për dhurata vullnetare e as për vakëflënie. Sipas hanefive, për të qenë e ligjshme vakëflënia e këtij personi duhet që personat të cilëve ai ia ka borxh, t'ia lejojnë borxhliut të

bamirësia, si dhe dëshira e njeriut për të lënë pas vetes llogari rrjedhëse të shpërblimeve e cila do të ishte për të si një gurrë e gjallë profitprurëse edhe pas vdekjes, duhet të vihet në peshojën e drejtë të urtësisë hyjnore dhe të shihet nëse e njëjta është duke e dëmtuar dikë nga të gjallët apo jo.

tyre një veprim të tillë. Përndryshe ajo vakëflënie nuk i ekzekutohet.¹

Pra, nëse vakëflënësi ka borxhe, duhet të shihen borxhet e tij se deri në çfarë niveli kanë arritur, nëse ato ia gëlltisnin tërë pasurinë, atij fare nuk i merret parasysh, pra i anulohet vakëflënia e tij në tërësi, sepse kthimi i borxhit është detyrim, dhe s'ka mundësi që t'i jepet përparësi një veprë vullnetare sado me vlerë që të jetë ajo, përpara asaj që është e detyrueshme.

E nëse personi i tillë lë vakëf, por borxhet e tij nuk ia gëlltisnin tërë pasurinë, atëherë vakëflënia e tij është e vlefshme vetëm në atë pjesë që i mbetet pas kryerjes së borxheve të tij. Por këtu duhet theksuar se edhe ajo pjesë që dëshirohet të lihet si vakëf, nuk bënë ta tejkalojë $\frac{1}{3}$ e pasurisë së atij personi. Nuk bënë ta tejkalojë këtë hise, ngase në po të njëjtën pasuri të atij personi kanë të drejtë trashëgimtarët të cilët nuk bënë t'i privojë ai nga e drejta e tyre që të trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit të vet.² Pra nga këtu shihet se edhe bamirësia, si dhe dëshira e njeriut për të lënë pas vetes llogari rrjedhëse të shpërblimeve e cila do të

ishte për të si një gurrë e gjallë profitprurëse edhe pas vdekjes, duhet të vihet në peshojën e drejtë të urtësisë hyjnore dhe të shihet nëse e njëjta është duke e dëmtuar dikë nga të gjallët apo jo.

Vakëflënia gjatë periudhës së sëmundjes dhe implikimet e trashëgimtarëve në këtë të drejtë

Bazuar në kriteret e kristalizuara më sipër, duhet theksuar se nëse personi ka lënë vakëf ndonjë pasuri, sado qoftë ajo, gjatë kohës kur nuk është i sëmurë dhe kur ai nuk ndien fare afërsinë e vdekjes, e as nuk ka borxhe ndaj askujt, ajo vakëflënie është e ligjshme. Natyrisht, ai mund ta lejë atë pasuri qoftë për ndonjë institucion-person juridik ose person fizik të caktuar si përfitues të vakëfit të tij, dhe nuk mund të ndërhyjë askush, qoftë nga trashëgimtarët apo kushdo qoftë tjetër në vendimin e tij. E tërë kjo vlen kështu nëse vakëflënësi veç i ka përmbushur kriteret e theksuara në fillim të këtij punimi, pa të cilat çdo vakëflënie do të mbetet e paligjshme dhe rrjedhimisht nuk do të ekzekutohej.

Por, sipas juristëve islamë, situata që ka implikime të personave të tjerë, respektivisht të trashëgimtarëve të tij, është atëherë kur vakëflënia ndodhë gjatë kohës së sëmundjes së vakëflënësit.

Dijetarët pothuajse nga të katër shkollat juridike islame, e kanë trajtuar vakëflënie si testament, dhe ia kanë dhënë po të njëjtin tretman juridik, nëse pronari i asaj pasurie (vakëflënësi) është i sëmurë me ndonjë sëmundje të rëndë nga e cila ai ka frikë se edhe mund të vdesë.³ Arsyetja pse vakëflënia në kohën e sëmundjes së vakëflënësit nga e cila sëmundja ai ka frikë se edhe mund të vdesë trajtohet sikur testament-vasijjet është sepse edhe kjo vakëflënie sikurse edhe testamenti sipas gjasave optimale duhet të zbatohet vetëm pas vdekjes së vakëflësit. Dhe ai dhurim i pasurisë që bëhet para vdekjes së pronarit, por që duhet të ekzekutohet pas vdekjes natyrisht që quhet testament.

Kështu në këtë situatë kemi edhe implikimin e të drejtave të trashë-

gimtarëve të cilët janë përfituesit e drejtpërdrejtë nga pasuria e trashëgimlënësit të tyre pas vdekjes së tij.

Nisur nga principi i ndarjes së balancuar të pasurisë të cilën e porositë Ligjvënësi i Urtë, trashëgimtarët kanë të drejtë që të pengojnë trashëgimlënësin cilido qoftë ai (qoftë babai, vëllai apo dikush tjetër) si dhe të sanksionojnë mundësinë e tij për vakëflënie ta pa limituar. Ky madje është qëndrimi juridik i katër imamëve të shkollave juridike në parim.⁴

E gjithë kjo mbështetet në hadithin, ku i Dërguari i Allahut pyetet nga Sead ibën Ebi Vekkasi r.a. nëse atij do t'i lejohej që të lejë tërë pasurinë si testament. Pra këtë ngjarje e rrëfen vet Ibën Ebi Vekkasi r.a. i cili thotë: "I Dërguari i Allahut a.s. më vizitonte shpesh gjatë vitit, në kohën që ai e kishte bërë haxhin lamtumirës, për shkak se unë (asokohe) vuaja nga një sëmundje e rëndë, e një herë i thash: "O i Dërguar i Allahut, e sheh që më është rënduar dhimbja - sëmundja dhe unë kam mjaft shumë pasuri, por unë nuk kam askënd nga trashëgimtarët që do të më trashëgojë pasurinë time pos një vajze, kështu që a mund të lë tërë pasurinë time si testament? Ai tha: "Jo". A mund të lë gjysmën e pasurisë sime testament? Ai tha: "Jo". A mund të lë 1/3 e saj? Ai tha: "1/3 mundet, porse edhe ajo është shumë. Ngase që të lësh trashëgimtarët e tu të pasur, është më mirë për ty se sa që t'i lësh ata të varfër që do t'ua shtrijnë dorën njerëzve e do t'iu lypin atyre..."⁵

Nga ky hadith po nënkuptohet se dëshira për të lënë një llogari rrjedhëse

Për 1/3 e pasurisë, vakëflënësi edhe në atë gjendje të sëmundjes nuk detyrohet ta pyesë a as të marrë leje nga askush prej trashëgimtarëve, sepse atë hise, ai e ka të drejtë juridike që ta shfrytëzojë si të dojë, dhe s'ka askush që mund të vendosë pengesë për dëshirën e tij në këtë situatë.

për veten duket në pamje të parë si krejt e shëndoshë dhe legjitime, mirëpo ajo për më tepër ngjall edhe një lloj skepticizmi se mos ai po e fshehë tendencën e privimit të trashëgimtarëve të tij nga e drejta e tyre legjitime në trashëgimi. Andaj, për këtë arsye, vakëflënia gjatë kohës së sëmundjes, nga e cila sëmundje, personi i sëmurë ka frikë që edhe mund të vdesë, e merr tretmanin juridik të testamentit, dhe po i njëjti hadith na tregon se mundësia e vakëflënësit është e përkufizuar dhe e ngushtuar, prandaj ai në këtë situatë ka mundësi që të lejë më së shumti

1/3 e pasurisë së tij si vakëf, por jo më shumë se kaq.

Për 1/3 e pasurisë, vakëflënësi edhe në atë gjendje të sëmundjes nuk detyrohet ta pyesë a as të marrë leje nga askush prej trashëgimtarëve, sepse atë hise, ai e ka të drejtë juridike që ta shfrytëzojë si të dojë, dhe s'ka askush që mund të vendosë pengesë për dëshirën e tij në këtë situatë.

E nëse vakëflënësi dëshiron që në atë situatë të lejë më shumë se 1/3, këtë mund ta bëjë vetëm me lejen e trashëgimtarëve ligjorë të tij. E kur ata të jenë pajtuar, pra që të gjithë trashëgimtarët, vakëflënësi mund të lejë edhe më shumë se kjo hise, sepse ai që ishte subjekt i së drejtës hoqi dorë nga e drejta e tij, andaj u lejua. Por, edhe në situatën hipotetike kur vakëflënësi nuk ka askënd nga trashëgimtarët e tij të ligjshëm, do t'i lejohej vakëflënia në një sasi mbi 1/3, sepse me ata që ndërldhet e drejta e tyre me pasurinë e tij, nuk ekzistojnë fare.

Krejt në fund, nëse vakëflënësi, gjatë kohës kur është me shëndet të mirë, e jo i sëmurë, përcakton se pasuria e tij është vakëf për të varfëritë e këtij vendi, atëherë pas vdekjes së tij, sipas juristëve islamë, të parët që mund të hyjnë në kuadër të përfituesve të atij vakëfi janë vetë trashëgimtarët e tij, nëse ata janë të varfër.⁶ Këtë gjë në fakt e sinjalizon edhe vetë hadithi i lartcekur i Muhamedit a.s., ku në të, qartazi preferohej që më së miri është që trashëgimtarët të mbesin të pasur, se sa që të dalin e të shtrijnë dorën për të lypur, përderisa trashëgimlënësi i tyre ka lënë pasuri si vakëf.



1. Dr. Vehvetu Ez Zuhejli, *El Fikh El Islamiy Ve Edil-letuhu*. (10/7624). Bot. i katërt, Daru El Fikr, Damask, 2004. 2. Abdulxhelil Ashub, *Kitab El Vakf*, (fq. 16). Bot. i parë, Daru El Ajak el Arabijije, Kajro, 2000. 3. Damad Efendi, *Mexhmeu El Enhur sherh Multeka El Ebhur* (1/749). Bot. i parë, Daru El Ihja Et Turath El Arabijij. Pa vit botimi. 4. Shih: *El Meusuatu El Fikhijje El Kuvejtijje* (44/126). E përgatitur nga një grup ekspertësh e dijetarësh islamë. Boton: *Vizaretu El Evkaf ve Esh Shu'un El Islamiyje*. Bot. i dytë. Viti 1427 lunar. 5. Buhariu e evidenton në "Sahih" të tij (nr:2742), Muslim po ashtu në "Sahih" të tij (nr:1628). E shumë koleksionues të tjerë të haditheve. 6. Ed Dehlevij el Hindij, *Fetava Et Tatarh'anijje* (4/146). Bot. i parë, Daru El Kutub el Ilmijje. Pa vit botimi.

Emad Hamdeh

Tradicionalizmi dhe selefizmi, debati rreth pluralizmit ligjor (2)

Selefite puritanë për pjesën më të madhe të teksteve thonë se janë të drejtpërdrejta dhe të qarta, ndërkohë që tradicionalistët pohojnë se tekstet janë të ndërlikuara dhe me shtresa të shumta kuptimore, apo multivalentë.

A është i qartë shkrimi i shenjtë?

Pohimi i selefite se ndjekin kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të qartë të teksteve luan një rol shumë të rëndësishëm në joshjen që shkakton mesazhi i tyre. Njerëzit e thjeshtë janë të papërgatitur për të përthithur argumente dijetarësh. Ka një shkallë skepticizmi dhe mosbesimi ndërmjet njerëzve të thjeshtë dhe tradicionalistëve. Në krahun tjetër, joshja që shkakton metodologjia ligjore selefite shtrihet në parapëlqimin e saj për thjeshtësinë para kompleksitetit dhe e paraqet Islamit si të thjeshtë, të drejtpërdrejtë, dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Diskursi skolastik që gjendet brenda *medhhebeve* nuk i ka lejuar tradicionalistët që të bëjnë një pretendim të ngjashëm dhe të ofrojnë përgjigje absolute, gjë që ishte në disavantazhin e tyre. Të ofruarit e teksteve "të qarta" njerëzve të thjeshtë i pajisi selefite puritanë me një mjet për të sfiduar autoritetin e tradicionalistëve, duke kërkuar që çdo fetva të jetë e mbështetur në njërin prej këtyre teksteve të qarta.¹

Për shembull, Albani beson se ka vetëm një të vërtetë dhe nuk e paraqet opinionin e tij si *dhann*; më saktë, ai i konsideron rezultatet e interpretimit të tij si dije definitive dhe, rrjedhimisht, si të barabartë me vetë Kuranin dhe Sunetin. Për shkak se ai i cilëson tekstet e shenjta si shprehim të qarta, metodologjia e tij ligjore shpeshherë i përqaset Kuranit dhe Sunetit si ligj, dhe jo si burime të

Pohimi i selefite se ndjekin kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të qartë të teksteve luan një rol shumë të rëndësishëm në joshjen që shkakton mesazhi i tyre.

ligjit. Nëse ligji kuptohet si një korpus faktesh që janë të pavarura nga mendja, atëherë këto ligje, interpretuesi thjesht i gjen ose i zbulon. Megjithatë, në qoftë se ligji kuptohet se është i lidhur me kontekstin historik dhe institucional, atëherë ai lë shteg për kreativitet konstruktiv brenda kufijve të traditës ligjore.² Me fjalë të tjera, a iu dha ligji islam si shabllon, si një korpus rregullash, myslimanëve? Apo mos vallë fillimisht u dhanë burimet e ligjit dhe më pas nga myslimanët lypsej që t'i përdornin këto burime për të sendërtuar ligjin dhe për të përcaktuar arsyetimin që shtrihet në themel të tij?

Për tradicionalistët, ushllë fikhu (metodologjia ligjore islame) është një përpjekje për të kuptuar implikimet e thella të shkrimeve të shenjta, të jurisprudencës, njerëzores, dhe kontekstit në të cilat këto ligje duhen zbatuar. Këmbëryerazi, selefite puritanë e shohin ligjin si kuptimi i drejtpërdrejtë i shkrimit të shenjtë.

Maksimumi që dikush guxon të bëjë përtej kuptimit të dukshëm të shkrimit të shenjtë është që të analizojë autenticitetin e tekstit, gjuhën e tij, sintaksën e tij, si dhe tekste të ngjashme me të. Ka shumë pak metodologji apo konsiderata hermeneutike për kontekstin social në të cilin zbatohet ligji. Muhamed Avameh i kritikon selefite se e barazojnë fikhun e tyre me Kuranin dhe Sunetin. Duke qenë se fikh do të thotë dije, atëherë fikhu i medhhebeve nënkupton kuptimin që medhhebet kanë pasur për Kuranin dhe Sunetin.

Avameh thotë: "Në përputhje me këtë, ne vërejmë një keqkuptim të rrezikshëm dhe të qartë në gjirin e njerëzve, një keqkuptim ky që nuk vihet re, dhe që për të cilin askush nuk tërheq vërejtjen. Kjo shfaqet kur njëri prej tyre e etiketon 'fikhun' dhe 'dijen' e tij dhe e paraqet atë para njerëzve si '*fikh el-Sunna*' apo '*fikh el-Sunna uel-kitab*'. Fikhu i Kuranit dhe Sunetit nënkupton kuptimin e Kuranit dhe Sunetit, dhe kuptimin e kujt po paraqet ai në këtë rast? Ai është kuptimi i filanit dhe i fistekut që nuk janë askush. Megjithatë, ata e kanë fryrë kuptimin e tyre dhe e kanë bashkëlidhur atë me 'Kuranin dhe Sunetin' për t'ua bërë mendjen çorbë njerëzve që të mendojnë se atyre po iu paraqitkan versionet e kulluara dhe autentike të Islamit. Si rezultat i kësaj, ata i largojnë njerëzit nga fikhu i Ebu Hanifes, Shafiut, Malikut dhe Ahmed ibën Hanbelit, Allahu qoftë i kënaqur me ata!, dhe ata e lartësojnë veten duke iu thënë njerëzve: "O njerëz, a doni fikhun e Muhamedit, alejhi selam, apo fikhun e Ebu Hanifes dhe të Shafiut?"³


Avameh argumenton se selefitë nuk bëjnë tjetër, vetëm se i bëjnë medhhebet që të duken të huaja për Islamin, kur ata fikhun selefi ia mveshin Kuranit dhe Sunetit, dhe fikhun e Ebu Hanifes thjesht Ebu Hanifes dhe jo Kuranit e Sunetit. Ai shpjegon se ndërkohë që tradicionalistët janë të qartë në lidhje me orientimin e tyre interpretativ dhe animet e mundshme, selefitë, nga krahu tjetër, nuk e bëjnë një gjë të tillë, për shkak se ata pretendojnë se ndjekin drejtpërdrejt Kuranin dhe Sunetin. Kjo krijon përshtypjen se kuptimi që ata kanë për shkrimin e shenjtë është fjala përfundimtare, dhe të gjitha opinionet e tjera janë të pabaza dhe të pavlefshme. Tradicionalistët e cilësojnë të pamundur që ndokush të zotërojë kuptimin absolut të teksteve të shenjta në të gjitha gjykimet ligjore, për shkak se kjo mohon elementin njerëzor të interpretimit. Për tradicionalistët, pretendimi i dikujt se zotëron të vërtetën absolute në çështjet ligjore është problematik, pasi një njeri nuk ka të ngjarë të jetë i sigurt se ajo çka ai ka kuptuar është ajo çka Zoti ka pasur për qëllim, me përjashtim të rastit kur ka konsensus.⁴

Selefitë puritanë heqin një dallim ndërmjet medhhebeve dhe Kuranit e Sunetit, duke i bërë këto të dyja të duken sikur janë krejtësisht të ndryshme. Për shembull, Albani ka thënë se “shumica e dijetarëve mbështeten mbi njërin prej katër medhhebeve... kurse sa i përket Sunetit, ai është harruar prej kohësh prej tyre nëse nuk është në interesin e tyre që ta marrin atë parasysh.”⁵ Ajo çka Albani nënkupton faktikisht këtu është se kur ka një hadith, asnjë thënie apo opinion i një dijetari nuk mund ta konkurrojë atë. Kjo sërish bazohet mbi kuptimin se tekstet janë të qarta dhe se mund të mbartin një kuptim të vetëm. Medhhebet janë një përpjekje për të kuptuar tekstet kur ato nuk janë shprehimisht të qarta. Ajo çka Albani mund ta cilësojë tekst të qartë, nuk është i qartë për dijetarë të tjerë apo madje edhe për selefi të tjerë. Së këndejmi lindin edhe mosmarrëveshjet apo mospajtimet në opinione. Kur tekstet janë të qarta pa asnjë ndërdyshje,

ata e kanë fryrë kuptimin e tyre dhe e kanë bashkëlidhur atë me ‘Kuranin dhe Sunetin’ për t’ua bërë mendjen çorbë njerëzve që të mendojnë se atyre po iu paraqitkan versionet e kulluara dhe autentike të Islamit.

atëherë duhet të ketë konsensus lidhur me kuptimin e tyre. Në mungesë të këtij konsensusi, një tekst dhe kuptimi për të do të mbetet në rrafsh probabiliteti (*dhanijun*).

Interpretimi i teksteve të shenjta Sipas selefive puritanë, kur interpretohen tekstet, përdorimi i arsyes dhe gjithçkaje tjetër përtej tekstit duhet të minimizohet. Hadithet duhet të vendosen në zemër të procesit të gjetjes së përgjigjeve që nuk janë të qartësuara në Kuran. Nuk ekziston diçka e quajtur fikh, por vetëm *fikh el-hadith*.⁶ Me fjalë të tjera, metodologjia e tyre ligjore është e bazuar vetëm mbi një kuptim të



drejtpërdrejtë të hadithit ndërkohë që njëkohësisht ata flakin tutje pjesën më të madhe të mjeteve interpretative dhe opinionet e mëparshme të dijetarëve që mund të çojnë në një konkluzion që vije ndesh me kuptimin e drejtpërdrejtë të një teksti. Të gjitha parimet dhe mak-simat ligjore duhet të nxirren drejtpërdrejt nga Kurani dhe hadithi. Intelekti, i pavarur nga tekstet parë-sore, nuk ka asnjë rol në përcaktimin e ligjit dhe mund të përdoret për të kuptuar në mënyrë pasive atë se çfarë shkrimi i shenjtë thotë se është ligji. Nëse shfletohen argumentet ligjore të selefive puritanë, ka fort të ngjarë që të ngelesh i befasuar nga thjeshtësia e qasjes së tyre ndaj çështjeve ligjore. Përgjigjet e tyre konsistojnë kryesisht në citimin e argumenteve tekstuale (*delileve*), gjë që e merr si të mirëqenë se tekstet janë të qarta dhe se nuk ka kurrfarë nevojë për një interpretim të gjerë ligjor. Duke qenë se tekstet janë të drejtpërdrejta dhe të qarta, selefitë puritanë e shohin rolin e dijetarit si thjesht të një personi që përçon argumentin tekstual (*delilit*). Qasja e tyre e palëkundur, e orientuar kah hadithi, ndaj ligjit islam shmang pothuajse çdo përmendje të debateve ndër-medhhebove dhe brenda-medhhebove që nuk janë kurrsesi të thjeshta. Është më e rëndësishme që të kuptosh burimet tekstuale mbi të cilat bazohen shkollat ligjore se sa të jesh i informuar lidhur me opinionet e ndryshme në gjirin e medhhebeve.⁷ Këmbyerazi, tradicionalistët pretendojnë se parimet dhe maksimat ligjore të medhhebeve janë të bazuara mbi Kuran dhe hadith, ata e konsiderojnë metodologjinë e selefive puritanë se i nxjerr gjykimet nga hadithi, pa pasur njëkuptimësi rreth teorisë ligjore.

Kriticizmi selefi ndaj medhhebeve kuptohet më së miri në dritën e bindjes së tyre se rezultatet e ixhtihadit të tyre janë autentike dhe të çlirëta nga njëanshmëritë me të cilat janë mbrujtur ata të cilët iu qëndrojnë besnikë medhhebeve. Një dallim parësor ndemjet selefive puritanë dhe tradicionalistëve është se selefitë nuk e pranojnë që ka një subjektivitet të qenësishëm në procesin e interpretimit të shkrimeve të shenjta.

Tradicionalistët e pranojnë se interpretimi që ata i bëjnë Islamit nuk e përjashton mundësinë që të jetë i pasaktë, ndonëse atë mundësi e cilësojnë se mund të jetë fare e vogël. Tradicionalistët rrallëherë pretendojnë siguri absolute në fikh. Kjo është e qartë nga zbatimi prej tyre i termave operues si opinioni ku mund të mbështetesh (*el-mu'temed*), opinioni më i fortë (*el-akva*), opinioni më i saktë (*el-assah*).⁸ E nënkuptuar në pretendimin selefi se “ata të cilët ndjekin dijetarët nuk ndjekin Kuranin dhe Sunetin” është se ata po mohojnë vetë shkrimet e shenjta. Ndonëse e përmbajnë veten nga nxjerrja prej feje, apo ekskomunikimi, qëndrimi i selefivë përfaqëson një rrëpirë të paqëndrueshme për nxjerrje nga feja dhe anatëmim. Në përputhje me këtë, kritikët tradicionalistë i cilësojnë selefitë puritanë se janë një tendencë e pashëndetshme që ushqen një kulturë të intolerancës.

Ata argumentojnë se selefitë, pa një proces interpretimi, nuk ka të ngjarë që të jenë duke ndjekur Kuranin dhe Sunetin. Habib el-Rahman el-Adhami thotë se pavarësisht që Albani ka pretendime se ndjek kuptimin e drejtpërdrejtë të shkrimeve të shenjta, ai faktikisht ndjek interpretimin e vet të tekstit. Për shembull, Albani i cilëson të gjitha imazhet dhe shëmbëlltyrat, qofshin ato statuja me tre dimensione apo fotografi, piktura dhe vizatime dy-dimensionale, si të ndaluara. Ka një transmetim në të cilin Aisheja, bashkëshortja e Pejgamberit, thotë se ajo e ka parë Profetin të mbështetur mbi një jastëk që kishte një imazh sipër. Sahabiu që përcjell hadithin, thotë: “Me të vërtetë, unë e kam parë të mbështetë mbi një të tillë dhe aty kishte një imazh.” Ky hadith e kundërshton ndalimin e imazheve nga ana e Albanit dhe, rrjedhimisht, vetë Al-bani e interpreton atë si më poshtë: “Ndoshta imazhi që përmendet në fundin e hadithit “Me të vërtetë, unë e kam parë të mbështetë mbi një të tillë dhe aty kishte një imazh” është këputur në mes, kështu që ai ka humbur trajtën e tij.”⁹ Adhami e sulmon Albanin për këtë interpretim:

Selefitë puritanë ose e mohojnë aspektin njerëzor të interpretimit dhe e cilësojnë të kuptuarin që ata kanë për shkrimin e shenjtë si të drejtpërdrejtë, ngjashëm me atë se si Profeti a.s. do ta kishte kuptuar atë. Ose ata e fshehin metodologjinë e tyre për të injektuar opinionet e tyre me një sens objektiviteti në mënyrë që të shesin edhe më tutje markën e tyre të selefizmit.

“Në qoftë se ky lloj interpretimi do të ishte bërë nga njëri prej atyre që ndjekin një medhhebe, ai do ta kishte akuzuar atë për shkelje të hadithit nëpërmjet thënies së imamit të tij dhe për shkak se ka preferuar një opinion përpara fjalëve apo vepërimeve të Profetit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të. Sikur ai të kishte pasur sadopak kuptim dhe turp, ai nuk do t’ia kishte lejuar vetes që ta refuzonte këtë hadith me anë të këtij interpretimi të shtrembëruar. Në qoftë se ai imazh do të ishte prerë në mes, gjysma e sipërme do të kishte qenë mbi një jastëk dhe gjysma e poshtme do të kishte qenë në një jastëk tjetër, dhe është e pasaktë që të përdoret fjala imazh për të përshkruar çdonjërin prej tyre.”¹⁰

Adhami orvatet që të përcaktojë se duke qenë që Albani e interpreton shkrimin e shenjtë si çdokush tjetër, kuptimi i tij është një lloj subjektiv dhe i gabueshëm. Adhami argumenton se ndonëse Kurani dhe Suneti janë “të pagabueshëm”, mënyra se si kuptohen ato nuk është e tillë. Selefitë puritanë ose e mohojnë aspektin njerëzor të interpretimit dhe e cilësojnë të kuptuarin që ata kanë për shkrimin e shenjtë si të drejtpërdrejtë, ngjashëm me atë se si

Profeti a.s. do ta kishte kuptuar atë. Ose ata e fshehin metodologjinë e tyre për të injektuar opinionet e tyre me një sens objektiviteti në mënyrë që të shesin edhe më tutje markën e tyre të selefizmit. Në qoftë se selefitë puritanë do të pranonin se ata po ndjekin interpretimin e tyre të shkrimit të shenjtë dhe jo vetë shkrimin e shenjtë, ata do të rrezikonin që të humbnin kredibilitetin për shkak se kjo do të nënkuptonte që ata po rikrijnë rrotën dhe ndërkohë thjesht po ndërtojnë një medhhebe tjetër.

Përpyekja për të rrokur kuptimin e drejtpërdrejtë të shkrimit të shenjtë pa një proces interpretimi nuk është e mundur. Çdo tekst që lexohet dhe çdo kuptim që përfitohet së andejmi arrihet nëpërmjet agjentit njerëzor të interpretimit, që ndikohet nga dija dhe kontekstet moderne dhe historike. Pavarësisht nga kjo, për shkak se selefitë puritanë besojnë që qëllimi i Zotit është i shprehur qartë në shkrimin e shenjtë, ata pohojnë se shkrimi i shenjtë ka vetëm një interpretim të vlefshëm dhe ata e refuzojnë pluralizmin ligjor.

Zhdukja e mospajtimit ligjor (ikhtilaf)

Për shkak se, të paktën në retorikën e tij, Albani beson se tradicionalistët kanë një besnikëri të verbër ndaj medhhebeve, ai merr përsipër që të rishqyrtojë gjithçka në dritë të teksteve të shenjta. Ai beson se pikëpamjet e medhhebeve nuk janë të bazuara mbi Kuran apo Sunet, për shkak se ato përfshijnë arsyen të bazuar mbi evidenca dhe nuk kanë një theks ekskluziv mbi autoritetin e teksteve të shenjta. Secilin opinion fikhu që nuk përputhet me kuptimet e “qarta” të teksteve të shenjta, ai e sheh si të pasaktë. Kjo është arsyeja përse ai i referohet selefizmit si kuptimi “autentik” dhe “i saktë” i teksteve të shenjta. Në fakt, selefitë puritanë e kuptojnë selefizmin sikur ai nuk është asgjë më tepër se sa Islami në formën e tij të kulluar dhe burimore.¹¹

Selefite puritanë thonë se mospajtimet në opinione janë pasojë e largimit të myslimanëve nga kuptimet fillestare dhe të qarta të argumenteve tekstualeve (*delileve*). Ata pohojnë se këto mospajtime janë shkatërrimtare për bashkësinë myslimane dhe janë burim i përçarjeve dhe i mosmarrëveshjeve. Ata argumentojnë se në qoftë se ndjekësit e medhhebeve do të dëshironin me të vërtetë, ata mund t'i kishin kufizuar dallimet e tyre lidhur me pjesën më të madhe të çështjeve duke iu referuar argumenteve tekstuale, e më pas ata mund t'ia falnin njëri-tjetrit dallimet e vogla. Albani shtron pyetjen se përse tradicionalistët do të bënin një përpjekje të tillë kur ata *ikhhtilafin* e cilësojnë burim mëshire?

Mospajtimet mbi *ikhhtilafin* kanë implikime të thella që shkojnë përtej teologjisë dhe ligjit. Në qoftë se dikush nuk e pranon vlefshmërinë e *ikhhtilafit*, ai i sheh ata që janë në kundërshtim me opinionin e tij se janë drejtpërdrejt kundër Zotit. Në krahun tjetër, të quash të vlefshme pikëpamjet e kundërta mbi elementët themeltarë kërcënon thelbin e fesë. Kriticizimi i Albanit ndaj mospajtimeve në opinionin buron nga një preokupim lidhur me autoritetin e teksteve të shenjta. Nëse të gjitha opinionet janë të vlefshme, dhe dallimet janë mëshirë, atëherë kjo do të thotë se Islami vuan nga një mungesë e qartë e drejtimit.

Udhëheqësit e selefizmit puritan si Albani, e pranojnë se të bashkosh të gjithë në një opinion të vetëm nuk është diçka e mundur, por ai orvatet që të minimizojë numrin e opinioneve të ndryshme duke kundërshtuar gjithçka që bie ndesh me delilet, apo argumentet tekstuale. Si rrjedhojë, ai pa dyshim e pranon përdorimin e arsyes njerëzore dhe domosdoshmërinë e saj për arsytimin ligjor. Problemi, në këndvështrimin e tij, është se dallimet në mesin e tradicionalistëve nuk janë shfaqur për shkak të arsyeve legjitime, por për shkak se ata ndjekin shkollat e ligjit me verbëri.

Tradicionalistët i akuzojnë selefitë puritanë se tregojnë mungesë të plotë respekti dhe se janë metodologjikisht rebelë karshi imamëve pasi preten-

Titulli i librit të Albanit nënkupton se në qoftë se dikush ndjek Malikun apo dijetarët e tjerë nga të cilët kanë marrë emrin shkollat e tjera, ai nuk po e fal namazin siç ka bërë Pejgamberi, pavarësisht se Maliku kishte një hallkë të drejtpërdrejtë lidhëse me Pejgamberin.

dojnë se opinionet e këtyre të fundit janë të bazuara mbi ndjekjen e verbër të medhhebeve (*taklid aima*). Mirëpo, edhe tradicionalizmi gjithashtu ka pjesën e vet të dijetarëve të cilët mund të kenë pranuar praninë e subjektivitetit në qasjen e tyre, por megjithatë kanë pretenduar se të tjerët e kanë absolutisht gabim. Për shembull, hanefiu Ibën Abidini ka thënë "Medhhebi ynë është i saktë dhe ka mundësinë që ta ketë gabim. Kur ne pyetemi lidhur me medhhebin e të tjerëve, ne themi se ata e kanë krejtësisht gabim."¹² Albani i fajëson tradicionalistët se kanë standarde të dyfishta për shkak që ata i akuzojnë selefitë se tregojnë mungesë respekti kur të tjerët i shpallin si absolutisht në gabim, e megjithatë ata nuk flasin kur po të njëjtën gjë e bëjnë tradicionalistët të dorës së parë si Ibën Abidini.¹³

Në mendimin puritan selefi, respekti i thellë për dijetarët nuk i pengon ata që të rishikojnë disa prej opinioneve të tyre në dritë të teksteve të shenjta. Ata e shohin si përgjegjësi të tyre si dijetarë që të ndreqin dhe të anashkalojnë opinionet e dijetarëve kur ato bien ndesh me një thënie të

Profetit apo me një ajet të Kuranit. Pranimi nga ana e tradicionalistëve i opinioneve të ndryshme pasqyron kuptimin që ata mbrojnë lidhur me natyrën e dijes dhe se si kohëra dhe rrethana të ndryshme i kanë shtyrë dijetarët që të dalin në përfundime të ndryshme. Tradicionalistët përpjekjet e selefite për të fshirë dallimin në opinione i cilësojnë si të kota, për shkak se këta të fundit përpiqen që të gjejnë sigurinë në një lëmi që nuk e ofron atë. Në kundër dallim, selefizmi autentik dhe i orientuar kah bindja është joshës për ndjeshmërinë moderne, të cilat shpeshherë janë të mbarsura me një ndjesi që kërkon siguri të qartë.¹⁴

Njëra prej veprave selefite më me ndikim që përpiqet të promovojë këtë tip të sigurisë është ajo e Albanit me titullin "*Asl Sifat Salāt al-Nabi Min al-Takbīr ilā al-Taslim Ka'anna-ka Tarā-hā*" (Përshkrimi origjinal i namazit të Pejgamberit, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, nga fillimi deri në fund sikur ta kesh para syve).

Kjo është njëra nga veprat më të famshme në qarqet selefite dhe është përkthyer në disa gjuhë (përfshirë dhe shqip, shënim i përkthyesit). Për shembull, në vitet 80-ta shumë gra selefite në Britani e falnin namazin sipas medhhebit hanefi, por kur libri i Albanit u përhap në vitet 1990 ato filluan të faleshin sipas Sunetit "autentik". Ky libër u bë popullor për shkak se ai iu jepte atyre siguri në lidhje me faljen e namazit, njëri nga elementët më të rëndësishëm të Islamit.¹⁵

Mirëpo, për shkak të akuzave që hidheshin aty kundër medhhebeve, ky libër gjithashtu u bë edhe shumë kontravers. Tradicionalistët e kanë marrë si fyerje titullin e librit. Për shembull, tradicionalisti amerikan Hamza Jusuf ka shënuar se Malik ibën Enesi (vd. 179/795) kishte një hallkë (sened) të drejtpërdrejtë lidhëse me Pejgamberin për shkak se mësuesi i tij, Nafiu, ishte student i Sahabiut të shquar Ibën Omerit. Titulli i librit të Albanit nënkupton se në qoftë se dikush ndjek Malikun apo dijetarët e tjerë nga të cilët kanë marrë emrin shkollat e tjera, ai nuk po e fal namazin siç ka bërë Pejgamberi, pavarësisht se Maliku kishte një

hallkë të drejtpërdrejtë lidhëse me Pejgamberin.¹⁶ Në vlerësimin e Albanit, vetëm njëri mendim në lidhje me namazin mund të jetë i saktë. Ai shpjegon përse e shkroi këtë vepër:

“Këtë libër e kam shkruar për shkak se njohuritë e hollësive të namazit janë të padeshifrueshme për pjesën më të madhe të njerëzve, madje edhe në gjirin e dijetarëve të shumtë, për shkak të taklidit të tyre ndaj një medhhebi specifik. Është e njohur për çdokënd që punon në shërbimin e Sunetit të pastër, i cili e mbledh dhe e kupton atë, se në çdo medhheb ka sunete që nuk gjenden në medhhebe të tjera. Dhe ato të gjitha përmbajnë atë çka nuk mund t’i atribuohet me saktësi Pejgamberit, paqja dhe mëshira qofshin mbi të.”¹⁷

Me fjalë të tjera, nëse një njeri e fal namazin sipas njërës prej katër shkollave ligjore, ai po ndjek diçka që nuk gjendet në tekstet e shenjta, dhe kjo për shkak se ato përmbajnë opinione që janë të ndryshme nga Suneti. Tradicionalistëve kjo u duket problematike për shkak se namazi është njëra nga shtyllat më të rëndësishme të Islamit dhe mbi këtë temë kanë shkruar mijëra dijetarë. Kritika e tyre ndaj Albanit buron pjesërisht nga sinqeriteti i tij kur ai e shpall librin e vet si teksti që ngërthen më së miri Sunetin. Ai shpjegon: “Duke qenë se unë nuk gjeja dot një libër që të përmbante gjithçka mbi këtë temë, unë vura re se e kisha detyrim që t’u jepja vëllezërve të mi myslimanë, të cilët e kanë preokupim që të ndjekin udhëzimin e Profetit në adhurimin e tyre, një libër që është sa më gjithëpërfshirës për gjithçka që ka të bëjë me përshkrimin e namazit të Profetit.”¹⁸

Bindja e Albanit është kaq totale sa që ajo nënkupton zhdukjen e menjëhershme të të gjitha perspektivave të tjera si rezultat ideal. Kritikët e tij jo domosdoshmërisht janë kundër përmbajtjes së librit në fjalë, por më saktë kundër qëndrimit që Albani ka shfaqur aty. Ata e akuzojnë atë se e sheh librin e tij se është kriteri përfundimtar mbi mënyrën e saktë e faljes së namazit dhe se ai i kritikon medhhebet për shkak se ato kanë

opinionë që bien ndesh me konkluzionet e tij. Për shembull, Albani hyn në debat me ndjekësit e medhhebit maliki të cilët falen me duart e lëshuara anash dhe nuk i mbajnë ato sipër njëra-tjetrës. Kuptimi i tij është se ata e bëjnë këtë thjesht e vetëm se këtë e thotë medhhebi dhe kjo nuk është e bazuar mbi ndonjë argument tekstual (*delil*). Albani thotë: “Përse falen ata kështu?! Sepse ky është medhhebi!”¹⁹ Ndonëse pjesa më e madhe e juristëve jo maliki, përfshirë dhe Albanin, nuk pajtohen me opinionin maliki, tradicionalistët argumentojnë se arsyeja se përse malikitë nuk i mbajnë duart njëra mbi tjetrën në namaz nuk mund të reduktohet vetëm në ndjekjen e medhhebit, por për shkak se ata besojnë që kjo është mënyra se si Pejgamberi e ka falur namazin. Kjo është e bazuar në kuptimin që ata kanë për Sunetin, i cili për ata përfshin edhe traditën e gjallë të njerëzve të Medinës, menjëherë pas vdekjes së Profetit. Nëse njerëzit që kanë jetuar në Medinë menjëherë mbas Profetit janë falur në një mënyrë të tillë, atëherë kjo detyrimisht do të thotë se ata kanë ndjekur shembullin e Profetit i cili kishte qenë në mesin e tyre. Për malikitë, kjo traditë e gjallë merr përparësi karshi një hadithi të vetmuar (ahad).

Albani vëren se dijetarët e hadithit nuk kanë arritur të gjejnë as edhe një hadith të vetëm, qoftë edhe të dobët apo të trilluar, që thotë se Pejgamberi nuk i ka mbajtur duart njëra mbi tjetrin gjatë namazit.²⁰ Në vend të kësaj, gjenden libra hadithi që përmbajnë transmetime të shumta ku Profeti përshkruhet se i mban duart njëra mbi tjetrën gjatë namazit. Albani nuk e njeh apo nuk angazhohet me parimin e *‘amel ehl el-Medine* dhe nuk i justifikon dijetarët maliki për faktin se ndjekin një parim që ata e cilësojnë legjitim dhe as nuk e bën ai një gjë të tillë për asnjërin prej medhhebeve të tjera.²¹ Krahas kësaj, Albani nuk pajtohet me shkollën malikite për shkak të këmbënguljes së tij metodologjike se Kurani dhe hadithi janë të vetmet

burime autoritative. Sa herë që Kurani dhe Suneti japin udhëzime specifike, nuk ka nevojë që të përdoren veprimet apo zakonet e njerëzve. Ai thotë se edhe sikur të ketë një opinion të një dijetari apo të një sahabiu, thënie të tilla nuk mund të rrëzojnë thëniet e Profetit.^[36] Ç’është më interesantja, jo të gjithë tradicionalistët e kanë parë me interes që të rrëzojnë argumentet e Albanit kundër medhhebeve, siç është rasti i mosmiratimit nga ana e tij e namazit të malikive me duart lëshuar anash. Më saktë, ata zakonisht bëjnë thirrje që diskutimit t’i jepet fund pasi në dritën e shekujve të dijes mendimi jokonvencional i Albanit është për ta i parëndësishëm.

Përktheu: Arjol Guni

1. Muhammad Nāsir al-Dīn al-Albānī, *Silsilat al-Ahādīth al-Sahīha* (Riyadh: Maktabat al-Ma’ārif, 1995), 190. Që këtu e tutje S.A.S. 2. A. Emon, “To Most Likely Know,” 419. 3. M. ‘Awwāma, *Athar*, 121. 4. M. ‘Awwāma, *Athar*, 121. 5. Muhammad Nāsir al-Dīn al-Albānī, *Al-Hadīth Huja Binafsi-hi fi l-‘Aqā’id wa l-Ahkām* (Riyadh: Maktabat al-Ma’ārif, 2005), 36. Albānī i referohet këtu dallimit midis katër medhhebeve dhe Ibn Tejmijes. Katër medhhebet pohojnë se të shqiptosh divorcing tri herë në një ulje cilësohet si tre divorce, dhe kësaj është i pakthyeshem. Ibn Tejmija ishte kundër katër medhhebeve dhe thoshte se ato llogariten si një, dhe disa asamble të fik’hut në epokën modern kanë marrë opinionin e Ibn Tejmijes si bazë për këtë çështje.
6. S. Lacroix, “Between Revolution,” 64–65. 7. R. Gauvain, *Ritual Purity*, 48. 8. Shiko Wael Hallaq, *Authority, Continuity and Change in Islamic Law* (Cambridge: Cambridge University Press, 2005), 121–140. 9. N. Albānī, *Ādāb*, 188–189. 10. H. A’zamī, *Shudhūdh*, 55–56. 11. E. Hamdeh, “Salafi Polemic,” 20. 12. ‘Amr ‘Abd al-Mun ‘im Salīm, *Al-Fatāwā al-Manhajīyya li-Fadlīl al-Shaykh Muhammad Nāsir al-Dīn al-Albānī* (Cairo: Dār al-Dīyā’, 2008), 66. 13. A. Salīm, *Al-Fatāwā al-Manhajīyya*, 66. 14. N. Albānī, *Kashf*, 94. 15. Anabel Inge, *The Making of a Salafi Muslim Woman: Paths to Conversion* (Oxford: Oxford University Press, 35), (2016). 16. Hamza Yusuf, “The Four Schools (Madhabs) or Albānī,” www.youtube.com/watch?v=FUigJfAcKgE parë për herë të fundit në 28 shkurt të vitit 2018. 17. Muhammad Nāsir al-Dīn al-Albānī, *Asl Ş ifat Ş alāi al-Nabī Min al-Takbīr ilā al-Taslīm Kāanaka Tarā-hā* (Riyadh: Maktabat al-Ma’ārif, 2006), 15. 18. N. Albānī, *Asl Ş ifat*, 18. 19. Muhammad Nāsir al-Dīn al-Albānī, *Al-Tasfiya wa l-Tarbiya wa Hājat al-Muslimīn Ilay-hā* (Riyadh: Maktabat al-Ma’ārif, 2007), 16. 20. Për një diskutim të kësaj pike dhe ‘Amel në shkollën malikite, shiko Yasin Dutton, “Amal v Hadīth in Islamic Law: The Case of Saḍl al-Yadāyn (Holding One’s Hands by One’s Sides) When Doing the Prayer,” *Islamic Law and Society*, 3, no. 1 (1996), 13–40. 21. N. Albānī, *Tasfiya*, 17.

Prof. asoc. Fadil Maloku

Gjuha e urrejtjes në jetën publike

Gjuha e urrejtjes në jetën publike, në fakt është mekanizmi më adekuat kundër komunikimit dhe tolerancës ndër-qytetare të një vendi (pretendent) demokratik. Por, përse dhe si lindi kjo gjuhë e ashpërsuar në përditshmërinë sociale dhe politike të shqiptarëve andej e këndej kufirit? Shkaqet duhen kërkuar si në histori, ashtu edhe në psikologji sociale e sociologji të njohjes. Pse në histori? Shkak, se ne shqiptarët e Kosovës në shekullin e fundit, praktikisht ishim popull i një shteti të huaj. Pse në ne psikologji sociale? Sepse, në rrugëtimin e mbijetimit u ushqye në mënyrë sistematike pamundësia e të qenit i lirë edhe si individ e edhe si entitet; etnik, social, politike, e kulturor. Po, pse në sociologji? Sepse, fenomeni i urrejtjes si mekanizëm mjaft efikas i kontrollit social dhe praktikës manipulative me masën e gjerë, shumë lehtë mund të bëhet një mjet i fuqishëm shkatërrues për të homogjenizuar qytetarët e frustruar dhe të marginalizuar.

Gjuha e urrejtjes e stimuluar nga elitat e ndryshme politike, gjithnjë është prodhuar si shkarkim i energjisë negative, ashtu edhe ridimensionime në hierarkinë e lëvizjeve dhe grupeve të ndryshme sociale. Gjuha publike e urrejtjes, në një shoqëri të pa konsoliduar sa duhet, siç është rasti me Kosovën, shumë lehtë mund t'i nënshtrohet dy rreziqeve ekstreme, të shkatërrorë të gjitha të arriturat e pasluftës, por, njëkohësisht edhe të ridimensionojë (nëse arrin të

Në shoqëritë e tranzicionit, mekanizmi i kontrollit social është përmbetur me faktin se e drejta e kontrollit i është besuar shtetit (që nuk është menaxhuar nga patriotizmi, por nga interesi dhe zhatja për vetën, grupin dhe partinë)

artikullohet me dozë të duhur në publik) dhe padyshim të plotësojë ato të (pa)arritura të mëhershme.

Në shoqëritë tradicionale, mekanizmi i kontrollit social kryesisht ushtrohej përmes normave morale, që ishin normale për shoqëritë që sistemi i kishte tjetërsuar deri në margjinat e skajshme; sociale, politike, kombëtare, kulturore, etj. Në shoqëritë industriale, strategjia e kontrollit social ushtrohet kryesisht përmes nevojës së rehabilitimit të sistemit kapitalist dhe kultivimit të harmonisë sociale; zgjerimit të mekanizmave të sigurisë ekonomike, sociale, politike, kombëtare e

kulturore/shëndetësore, arsimore, etj., të qytetarëve të vet.

Në shoqëritë e tranzicionit, mekanizmi i kontrollit social është përmbetur me faktin se e drejta e kontrollit i është besuar shtetit (që nuk është menaxhuar nga patriotizmi, por nga interesi dhe zhatja për vetën, grupin dhe partinë), i cili në rastin e Kosovës po bëhet gjithnjë e më zhgënjyes, edhe për faktin se praktikatat e kontrollit social (liria e mendimit dhe e qarkullimit është ngulfatur me mashtrimet të njëpasnjëshme nga ana e politikanëve që votat e qytetarëve për një emancipim ekonomik i kanë konvertuar në "shitje të pasurisë së përbashkët", toka, pasuria nëntokësore, super të drejtat për 5% serb lokal, në pasurimin e vetës së tyre dhe grupeve, e klaneve të dyshimta, etj.

Historikisht, prej që shqiptarët janë identifikuar si komunitet, si etni, si komb, e si organizim socio politik, por, jo edhe si individ e familjar, gjithnjë kanë pasur probleme të akomodimit me të tjerët. Jo me fajin e tyre sa me fajin e tjerëve, të cilët u dëshmuar si më të shkathët në krijimin dhe organizimin e jetës së vetës së tyre individuale e kolektive. Dhe jo vetëm kaq, këta të "tjerë" këtë shkathësi dhe organizim politik, social, kulturor, e besa edhe sish ushtarak e "mirëmbajtën" edhe përmes pushtimit dhe imponimit të vullnetit të tyre mbi shtetet, kombet dhe shoqëritë e tjera të shquara sociologjikisht si "periferike", ku në

vorbullën e saj, e gjetën vetën edhe paraardhësit e shqiptarëve të sotëm.

Këta paraardhës tanë, që historia i identifikon herë si pellazgë e herë si ilirë, me indiferencën dhe jo gatishmërinë për ta udhëhequr vetën e tyre mbetën peng (qysh në Iliri e Dardani, e për të vazhduar më tej këtë "traditë" famëkeqe, me Skënderbeun e deri në ditët e shekullit tonë) të ambicieve dhe synimeve të këtyre "tjerëve". Tani, duke u munduar që ta zërthejmë lojalitetin, besimin, apo edhe "aftësinë ose prirjen" e akomodimit të shqiptarëve, ndaj pushtuesve, sunduesve (që shpeshherë ngatërrohen (pa)qëllimshëm me termat dhe konceptet e miqësisë (shih ti edhe epike) dhe aleancave të ndryshme që u "evidentuan" nëpër gjithë katalogët e historisë së qenësimit të tyre si organizëm socio politik. Dhe po më duket që krejt kjo logjikë për një besim blanko, e do shtoja ngandonjëherë edhe skajshmëri të verbër e tyre, që sa herë e donte nevoja ua dëshmonin (hiq pa na e kërkuar) personave, komuniteteve, popujve dhe shteteve të huaja. Dhe se e gjithë kjo temë e shtruar kështu me qëllim të zërthimit të origjinës së kësaj rrjedhje, apo s'po di si ta quaj ndryshe, po më duket që më shumë është tematikë etike se sa antro-pologjike.

Nëse është etike, kjo i bie që "verbëria" jonë individuale, po edhe ajo kolektive sociologjikisht duhet gjurmuar te kodet, normat dhe dosido edhe te perifrazimi i tyre në gjithë historinë e organizimit psiko-social. Por, nëse është antropologjike (gjë që shumë pak ka gjasa argumentuese), atëherë, këtë lloj besimi të verbër që e kanë demonstruar shqiptarët ndaj të huajve, duhet kërkuar te veçoritë biologjike të tyre, që është jo vetëm një adresë e gabuar, por na del edhe si një "dëshmi" antisociale e antihistorike.


Së këndejmi, dioptria sociologjike duket që na jap shpjegimin më të përafërt, e do thosha edhe më të besueshëm për këtë veçori e "produkt" historik të identifikuar si "made in albania". Sociologjikisht, mungesa e një përvoje historike e qeverisjes me vetën e tyre (sepse, me të tjerët/si në perandorinë romake, ashtu atë otomane dhe atë serbe, janë dëshmuar si mjaft të shkathët dhe të zotë). Mendoj që egoizmi, indiferenca, prirja për akomodim të shpejt individual, papërvoja në sundimin e vetvetes, mungesa e përgjegjësisë në qeverisje nga ana e politikanëve vendas. Së këndejmi, përgjigja sociologjike në pyetjen se përse shqiptarët u besojnë aq shumë të huajve, qëndron në historinë e tyre mbijetuese, në mungesën e traditës

qeverisëse me vetën e tyre, në përvojën stereotipie ndaj vetës, në glorifikimin e aftësive të huajve, në...

Shpëlarja e trurit

Jemi duke jetuar në kohë (kaosi apo shturjeje), kur solidariteti ndërmjet njerëzve, komuniteteve, shteteve, vendeve, gjithnjë e më shumë po "korruptohet" me disa pretekte: politike, fetare, kulturore, civilizuese. Vendin e tij, gjithnjë e më shumë po e zë interesi, i cili ka filluar ta ngulfat si parimin e drejtësisë, ashtu edhe atë të moralit dhe shpirtit të individit, duke u metastazuar me turravrap në drejtim të familjes, komunitetit, kombit.

Meqë, interesin e kemi pranuar me vullnetin tonë, si diçka joshëse dhe utilitare, ne në fakt s'kemi ndonjë arsye t'ia shohim për të madhe ndokujt (as mikut, e as armikut) mashtrimin, mendimin, veprimin, gjykimin ndryshe. Andaj, për hair na koftë vetmia sociale, xhelozia urbane, lakmia personale, korrupsioni medial, dhe mbi të gjitha tëhuajsimi në këtë përditshmëri morbide dhe gjithësesi të rrezikshme për gjithë ne. Ndryshe, ...cila është zgjidhja jonë? Padyshim, ndryshimi...



Mihana Goga-Bekteshi

Fëmija, stolia më e bukur e familjes

Fëmija, burimi i lumturisë dhe stolia e vatrës së familjes, është amaneti që Zoti xh.sh. u ka dhënë prindërve të tij. Ata janë përgjegjësit kryesorë para Zotit xh.sh. dhe shoqërisë në lidhje me edukimin e tyre.

Nëse njeriu fillon t'i regjistrujë punët më të rëndësishme të jetës së tij, atëherë do t'i bëhej një listë shumë e gjatë. Mirëpo, nëse ato fillon t'i rendisë sipas rëndësisë dhe përparësisë, sigurisht se në krye të listës do të jenë fëmijët dhe familja e tij. Në Kuranin fisnik thuhet: "O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra e shumë gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës për ju."¹

Familja dhe fëmijët janë më të vlefshme se rehatia dhe se pasuria e njeriut, ngase është fakt se kur

“E kanë pyetur Pejgamberin a.s., se kujt duhet t'i kushtohet më shumë kujdes? Ai është përgjigjur: “Nënës”. E pastaj kujt? – e pyeten shokët e Pejgamberit a.s.. “Nënës” – u përgjigj prapë ai. E pastaj kujt? – pyetën prapë shokët. “Nënës” – u përgjigje prapë ai. E pastaj? – pyetën sahabët. “Babait”

fëmija sëmuret, prindi mbete pa gjumë, ndoshta udhëton prej një vendi në tjetrin, harxhon prej pasurisë së tij, madje nëse nuk ka merr edhe borxh, vetëm e vetëm që fëmija t'i shërohet. Ndaj, kur ai bisedon me fëmijën e vet, e këshillon dhe është shumë i sinqertë.

Në një hadith thuhet: “E kanë pyetur Pejgamberin a.s., se kujt duhet t'i kushtohet më shumë kujdes? Ai është përgjigjur: “Nënës”. E pastaj kujt? – e pyeten shokët e Pejgamberit a.s.. “Nënës” – u përgjigj prapë ai. E pastaj kujt? – pyetën prapë shokët. “Nënës” – u përgjigje prapë ai. E pastaj? – pyetën sahabët. “Babait” – u



përgjigj Pejgamberi a.s.. Nga kjo shohim se roli i nënës në formimin e njeriut në aspektin shpirtëror e fizik është shumë i rëndësishëm. Ajo i jep fëmijës një pjesë të saj ende sa është në mitrën e saj, gjatë zhvillimit embrional. Pas lindjes e ushqen me qumështin e saj dhe prapë ia jep një pjesë të saj. Kontributi i saj në formimin e anës shpirtërore të qenies njerëzore është shumë i madh. Nëna është ajo e cila në shpirtin e fëmijës mbjell gjithë atë që është e ndershme, e bukur dhe e vlefshme. Ajo u bë infermierja jote, kuzhinierja jote, shërbëtorja jote, mësuesja jote e shoqja jote më e mirë. Të gjithë përreth teje mund të të lënë, përveç nënës e cila është me ty dhe për ty. Dashuria e saj është e fortë, e pastër dhe e qëndrueshme, edhe kur ajo është e zemëruar me ty. Kjo është nëna, të cilës nuk i ngjan askush, as nuk mund ta zëvendësojë askush vendin e saj. Ajo tërë jetën lufton për ty, qan për ty, e vendos veten në vendin e dytë, shpreson më të mirën për ty, ndonjëherë mërzhitet shumë nga shqetësimet tua, por kurrë, ama kurrë nuk do të kërkojë asgjë në këmbim, ngase ajo të do shumë.

Përgjegjësitë tona për fëmijët

Fëmija, burimi i lumturisë dhe stolia e vatrës së familjes, është amaneti që Zoti xh.sh. u ka dhënë prindërve të tij. Ata janë përgjegjës kryesorë para Zotit xh.sh. dhe shoqërisë në lidhje me edukimin e tyre. Pra, përgjegjësitë kryesore janë: të kujdesen për mbarëvajtjen e rritjes së fëmijës, duke iu siguruar atyre ushqim, të kujdesen për shëndetin fizik e shpirtëror të tyre, të mos i ushqejnë fëmijët e tyre me të ndaluarën etj.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Paratë që kanë sevapin (shpërblimin) më

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Paratë që kanë sevapin (shpërblimin) më të madh nga pasuria e shpenzuar në rrugën e Allahut, janë ato që shpenzohen për individët e familjes.”

të madh nga pasuria e shpenzuar në rrugën e Allahut, janë ato që shpenzohen për individët e familjes.” Ai na ka paralajmëruar: “Do t’i shkruhet njeriut për gjynah, në qoftë se lë pas dore anëtarët e familjes së tij, për të cilët është i detyruar që të kujdeset.”

T’i vërë emër të bukur fëmijës së tij. “Më ka treguar Is’hak bin Nasër, e këtij Usameja nga Burejda, e ai nga Ebu Burde, se Ebu Musa ka thënë: “Kur lindi gruaja ime, e çova fëmijën tim te Pejgamberi a.s. dhe ai ia vuri emrin Ibrahim. I bëri “tahnik” me hurmë dhe e bekoji, e mandej ma dha mua.”²

Ta edukojë fëmijën e tij dhe të bëhet shembulli më i mirë për të nga aspekti moral. Pejgamberi ynë a.s. na ka treguar qartë për rëndësinë e edukimit të fëmijës, duke na thënë: “Asnjë baba nuk mund t’i bëjë dhuratë më të vyer fëmijës së tij, sesa edukata e mirë që do t’ia mësonte atij.”

T’ia mësojë fëmijës faljen e namazit, si dhe detyrat fetare e morale. Ta shkollojë fëmijën e tij dhe t’i japë atij një edukim të mirëfilltë. T’i duam fëmijët tanë, sepse ata kanë nevojë për dashuri,



po aq sa kanë nevojë për ushqim dhe veshmbathje. Pejgamberi a.s. i donte shumë fëmijët dhe interesohej shumë për ta. Të mos bëjmë dalim ndërmjet fëmijëve, kur shfaqim dashurinë për ta apo edhe kur ndajmë dhurata, të sillemi me barazi dhe drejtësi ndërmjet tyre. Koha do të kalonte gjithsesi, trupi njëlloj do të plakët, por e gjitha kjo do të kalonte pa ndonjë qëllim, nëse qëllimi nuk është dikush për të cilin ia vlen të luftosh, të punosh e të jetosh. Sheh se hap pas hapi, vit pas viti, pas jetës tënde që sa vjen e zvogëlohet, jetë të tjera zmadhohen, ndriçohen jetë të ardhme për të cilat t’i ndihesh me shumë fat.

1. En-Nisa, 1. 2. Sahihul-l-Buhari në gjuhën shqipe, Libri 11. Hadithet: 5351-6226, përkthet nga gjuha arabe dr.Feti Mehdiu, Prishtinë, 2014, fq.63.

Dr. Selim Selimi

Flamuri dhe himni shqiptar (2)

Himni i Flamurit është himni kombëtar i Shqipërisë që nga shpallja e pavarësisë më 1912. Himni, shkruar nga Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni), njihet zyrtarisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si Himni i Flamurit.

Kalorësit e Skënderbeut (sipas Marin Barletit) gjatë fushatës së tij në Pulja, në ndihmë të mbretit të Napolit, mbanin flamuj të vegjël, të kuq me një shqiponjë të zezë dykrerëshe në mes. Shqiponja dykrerëshe është simbol i pushtetit perandorak (bizantin, gjerman, rus). Sundimtarët e mëdhenj dhe të vegjël që u shkëputën nga Perandoria Bizantine vazhduan ta mbajnë këtë simbol pushteti. Kështu mbase ka bërë edhe Skënderbeu.

Sidoqoftë në gojëdhënat e arbëreshëve, ky kumt mbeti i gjallë. Mbi varrin e nipit të Skënderbeut, në kishën e Shën Mërisë së Engjëjve, në

Napoli, është vënë stema e tij, një shqiponjë heraldike me një yll të bardhë e vezullues pesëcepësh mbi të dy krerët. Ndërmjet viteve 1880-1895, Zef Skiroi, e më vonë edhe Anselmio Lorekio, në të përmuajshmen e tyre arbëreshe, e botuan thujse në çdo numër, këtë emblemë si flamur të Shqipërisë, pas vitit 1900, atë e vë edhe Faik Konica në të përmuajshmen e tij "Albania" në Bruksel. Në shtator 1909, së bashku me djelmërinë e qytetit (Vlorës) në organizova në shtëpinë time shfaqjen e dramës "Pirrua" të Mihal Gramenos. Sipas Eqrem bej Vlorës, "ku ngrita për herë të parë flamurin

shqiptar...Në kohën e kryengritjes së malësorëve katolikë, në vitin 1911, në Cetinjë mbërritën vullnetarë arbëreshë për t'u bashkuar me kryengritësit, e që për herë të parë mbanin një flamur kombëtar..."¹

E pra, më 28 nëntor, kryeobjekti i ditës, flamuri si simbol i pavarësisë, me atë pakujdesinë shqiptaro-lindore ishte harruar. Për më tepër, shumica nuk e dinte se si ishte ai, kurrkush më përpara as që e kishte parë, as që e kishte mbajtur. Askush në Vlorë nuk kishte flamur në shtëpi. Shtet formuesit ranë në hall dhe vështruan njëri-tjetrin të hutuar. Atëherë ngrihet miku im, Hydai Efendi dhe thotë se në dhomën e gjumit të Eqrem Beut varet në mur një flamur shqiptar i futur në një kornizë të bukur. Dhe pyeti, se a mund të merrej pa qenë aty i zoti. Ismail Beu i dha leje dhe kështu flamuri që dikur don Alandro Kastrioti ma kishte dhuruar solemnisht në Paris, shtegtoi në konakun fqinj dhe ra në duart e Ismail Qemalit, i cili ia dorëzoi Murat bej Toptanit me porosinë që ta varte poshtë, ndërkohë që vetë qëndronte pranë në dritare. Mijëra njerëz u mblodhën në kopsht duke brohoritur "Rroftë, rroftë!" Një javë pas kthimit tim në Vlorë, çova Murat bej Toptanin dhe Hydai Efendiun tek Ismail Qemali, të ma kthenin atë menjëherë, sapo zonja Marigo Posio, një atdhetare e madhe demokratike ta kishte qëndisur flamurin e ri.

Himni i Flamurit është himni kombëtar i Shqipërisë që nga shpallja e pavarësisë më 1912. Himni,



shkruar nga Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni), njihet zyrtarisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si Himni i Flamurit.

Himni kombëtar ishte një marsh rumun kompozuar nga Ciprian Porumbescu, ndërsa autor i tekstit ishte rilindësi ynë, Asdreni.

Himni kombëtar

HIMNI I FLAMURIT

*Rreth flamurit t'përbashkuar,
me një dëshirë e një qëllim,
të gjithë atij duke u betuar,
të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ai largohet,
që është lindur tradhëtor,
kush është burrë, nuk frikohet,
po vdes, po vdes si një dëshmor!
Në dorë armët dot' i mbajmë,
të mbrojmë atdheun në çdo kënd,
të drejtat tona ne si ndajmë;
këtu armiqtë skanë vend.*

*që kombe shuhen përmbi dhe,
po Shqipëria do të rrojë,
për të, për të, luftojmë ne!
O flamur, flamur, shenjë shtrenjtë
tek ti betohemi këtu,
për Shqipërinë, atdheun e shtrenjtë,
për nder' edhe laudim ne tu.
Trim, burrë qubet dhe nderohet
atdheut kush iu bë thërror.
Për jetë ai do te kujtohet
mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!*

Asdreni

Flamuri dhe himni kosovar

Flamuri i Republikës së Kosovës u adoptua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, menjëherë pas deklarimit të pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Flamuri qe rezultat i një gare ndërkombehtarë për dizajnin e tij, organizuar nga UNMIK-u, i mbështetur nga Kombet e Bashkuara, ku u dorëzuan gati një mijë punime. Versioni i përdorur tani është variant i punimit të dizajnuar nga Muhamer

Ibrahimi. Ai ka gjashtë yje të bardha në një hark, sipër një harte të artë të Kosovës në një sfond blu. Ato simbolizojnë gjashtë grupimet kryesore etnike të Kosovës.

Përpara deklarimit të pavarësisë, Kosova ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe përdorte flamurin e OKB-së për qëllime zyrtare. Serbët përdorin tri kolorin kuq, blu dhe të bardhë, që është baza e flamurit të tanishëm të Serbisë. Shqiptarët kanë përdorur flamurin e Shqipërisë qysh nga vitet 1960 si flamurin e kombësisë së tyre. Të dy flamujt akoma mund të shihen e përdoren brenda Kosovës së pavarur.

Flamuri i Kosovës ka një sfond blu dhe ka të vendosur mbi të një hartë të Kosovës dhe gjashtë yje. Yjet zyrtarisht nënkuptojnë gjashtë grupimet kryesore etnike në Kosovë, shqiptarët, serbët, turqit, goranët, romët (shpesh të grupuar me ashkallitë, egjiptianët) dhe boshnjakët. Jo zyrtarisht, yjet ndonjëherë nënkuptojnë territoret ku ka popullsi shqiptare: Shqipëria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Flamuri i Kosovës i ngjan flamurit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga ana e ngjyrave dhe formave të përdorura (yje të bardha dhe forma e verdhë e vendit në një sfond blu). Flamuri është i pazakontë krahasuar me flamujt e tjerë kombëtarë, për faktin se përdor hartën e vendit si element të dizajnit. Flamuri i Qipros është i vetmi flamur tjetër i këtyllë. Raporti i flamurit u deklarua se do ishte 2:3, por me kalimin e një ligji të protokollit diplomatik në Kosovë në prill 2009, raporti u vendos në 1:1.4 (5:7 kur vendoset në numra të plotë). Ngjyrat dhe ndërtimi i flamurit të Kosovës nuk janë përcaktuar akoma, megjithatë një dokument zyrtar i qeverisë i jep ngjyrat e flamurit duke përdorur CMYK.

Vlerat jozyrtare RGB të flamurit janë nxjerrë manualisht që në vitin 2009. Përdorimi i flamurit të Kosovës rregullohet me ligjin: "Ligji mbi Përdorimin e Simboleve të Shtetit të Kosovës".²



Himni i Kosovës, propozimi me shifrën "Evropa" i cili u miratua në një seancë të veçantë të Kuvendit me 72 vota për, 15 kundër dhe 5 abstenime, është kompozuar nga kompozitori Mendi Mengjiqi, më 11 qershor të vitit 2008. Përveç melodisë, himni i Kosovës, kishte edhe tekst, por një gjë e tillë nuk u lejua. Teksti flet për atdhedashurinë si vend i të parëve.

Teksti i himnit

O mëmëdhe i dashur, vend i trimërisë,

Çerdhe e dashurisë,

N' ty shqipet fluturojnë,

Dhe yjet ndriçojnë,

Vendi i të parëve tonë,

Ti qofsh bekue për jetë e mot,

O nënë e jonë,

Ne të dalim zot,

O mëmëdhe i dashur, vend i trimërisë,

Çerdhe e dashurisë.

1. Eqrem bej Vlora. *Kujtime*. Tiranë, 2003, fq. 313. 2. https://sq.wikipedia.org/wiki/Flamuri_i_Kosov%C3%ABs.

Adnan Shala

Nocioni njeri te Hajj ibën Jakdhani dhe iluminizmi perëndimor

Në diskutimet ndërmjet njerëzve të dijes se si është çështja rreth fundit të civilizimit dhe dijes që përfaqëson ai civilizim, kemi dy mendime kryesore. I pari thotë se civilizimi dhe dija që ai civilizim e përfaqëson janë një cikël rrethorë i cili lind, zhvillohet dhe vdes. Mendimi i dytë është se ai nuk përfundon veçse kalon nga një popull në një tjetër, dhe nuk ngritët civilizimi nga një popull, por ai popull ngritët nga civilizimi. Pra, sipas tyre, dija nuk pranon një shkëputje dhe nëse nuk janë kushtet e domosdoshme që të zhvillohet në një vend dhe te një popull, ai kalon te një vend dhe një popull tjetër. Rreth mendimit të dytë kemi shumë shembuj mbi të cilën ndërtohet ai mendim. Pas grekëve ishin romakët, e dija greke dhe civilizimi grek nuk përfundoi me rënien e tyre, por gjeti jetë të romakët. Pastaj kaloi te bota islame nëpërmjet përkthimeve të ndryshme, e pastaj nga bota islame te bota perëndimore. Nëse e pranojmë si të saktë këtë mendim, atëherë cilat ishin veprat të cilat ndikuan që të zhvillohej aq shumë mendimi perëndimor dhe a ishte pikërisht literatura e botës islame shkaktari kryesor i iluminizmit perëndimor. Njëri nga librat me ndikimin më të madh në mendimin dhe iluminizmin perëndimor është romani i Ibën Tufejlit. Në dukje të parë ky roman duket një roman i thjeshtë, mirëpo mesazhin të cilin e nxorën perëndimorët nga ai ishte shkaku

Njëri nga librat me ndikimin më të madh në mendimin dhe iluminizmin perëndimor është romani i Ibën Tufejlit. Në dukje të parë ky roman duket një roman i thjeshtë, mirëpo mesazhin të cilin e nxorën perëndimorët nga ai ishte shkaku kryesor i revolucionit.

kryesor i revolucionit. Para se të kalojmë te ky revolucion, të ndalemi pakëz te vetë brendësia e romanit.

Ibën Tufejl e fillon romanin e tij duke diskutuar për dy hipotezat se si ka lindur (apo është krijuar) njeriu në botë, të cilat debatohen edhe sot. Sipas të parës nga këto, Hajji u krijua me një proces natyralist, e sot i njohur gjithashtu si “Teoria e Evolucionit”, pa baba ose nënë, nga ndërveprimi i materies nën ndikimin e disa shkaqeve natyrore në një nga ishujt e Indisë. Versioni i dytë bazohet në historinë e lindjes nga një nënë dhe baba (Ademi-Hava) si në mësimet tradicionale. Nga mënyra se si e trajton këtë temë në fazat e

mëvonshme kuptohet se Ibën Tufejl preferoi hipotezën e dytë, megjithëse nuk e shprehu asnjëherë në mënyrë të qartë.

Pasi i përmend të dy versionet, Ibën Tufejl fillon të tregojë për hapat e parë të Hajjit, të cilin e gjen një gazelë kur ishte foshnjë dhe e ushqen me qumështin e saj. Hajji me kalimin e kohës fillon të nxjerrë tinguj, të bëjë lëvizje etj. Duke parë përreth, ai kupton se është ndryshe nga gjallesat e tjera. Kuptimi i parë i Hajjit ishte ndjenja e turpfit. Duke përdorur mendjen, ai filloi të shpikë mjete për ta bërë jetën më të lehtë, para së gjithash ai shpiku shkopinj dhe më pas mjete të thjeshta. Ndërsa Hajji ishte duke u rritur, gazela që e rriti vdes, dhe Hajji filloi të kundroj trupin e saj dhe arrin në përfundim se ajo kishte një shpirt para se të vdesë. Hajji, i cili pas një kohe zbuloi zjarrin, pa një fuqi të jashtëzakonshme në zjarr. Duke kuptuar vetitë djegëse, ndriçuese dhe ngrohëse të zjarrit, Hajji e vëren se kur hedh një peshk në të, zjarri i jep peshkut një aromë dhe shije të jashtëzakonshme. Ai gjithashtu zbuloi vetinë e katërt të zjarrit. Ndërsa mendon intensivisht mbi zjarrin, ai përpiket të lidhë konceptin e nxehtësisë dhe temperaturës me konceptin e «shpirtit» te gjallesat. Duke vazhduar soditjet e tij mbi kafshët, ai fillon të kundroj organet dhe rregullimin e tyre, dhe sesi fenomeni i quajtur «shpirt» zgjat për një periudhë të caktuar kohe pa u shpënuar.

Kur Hajji arrin moshën 20 vjeçe, ai tanimë kishte shumë njohuri, duke përfshi edhe “shpirtin e kafshëve”. Ai vërente që objektet ndryshojnë nga njëri-tjetri me tiparet e tyre të tilla si të nxehta, të ftohta, me ngjyra dhe pa ngjyra. Por ka edhe një ndryshim dhe transformim të vazhdueshëm mes tyre. Kur abstraktohet nga koncepti i “shpirtit”, pra kur nocioni shpirt lihet anash, ai arrinte në përfundimin se bota e gjallë nuk është e ndryshme nga këto objekte. Pra, të gjitha objektet janë të njëjta. Hajji tanimë kishte zbuluar konceptin e materies. Kishte një ishull tjetër pranë ishullit ku jetonte Hajji dhe Ebsal, i cili ishte udhëheqësi midis njerëzve që jetonin atje, shkoi në ishullin ku jetonte Hajji për të adhuruar më shumë Allahun derisa vetë ishte sufi. Derisa lutet, Ebsali takohet me Hajjin, meqenëse Hajji i kuptonte gjërat dhe i emërtonte ato vetëm sipas kuptimit të tyre, meqenëse nuk dinte ndonjë gjuhë, Ebsali gradualisht i mëson gjuhën, dhe më pas ata shkojnë në ishullin ku jeton Ebsali dhe takojnë Selamanin. Hajji përpiqet të shpjegojë përvojat e tij, por askush nuk e kupton atë, përveç Ebsalit dhe Selamanit. Kështu, ata kthehen në ishull me Ebsalin dhe qëndrojnë atje deri në fund të jetës së tyre. Ibën Tufejl përmes këtyre personazheve përfaqëson tre lloje njohurish në romanin e tij. Filozofi është Hajji, i cili i vetmuar kërkon të vërtetën në një ishull, Selamani përfaqësohet si një studiues fetar apo i shariatit dhe Ebsali si një sufi. Por të tre llojet e njohurive sipas Ibën Tufejl përkatësisht filozofia, sufizmi dhe shiati, janë shfaqje të ndryshme të së njëjtës të vërtetë të përjetshme.

Nëse e përmbledhim në një fjalë të gjithë atë që u tha, Hajji arrin të gjitha nivelet e njohurive duke përdorur mendjen e tij. Ai gjithashtu arrin vetë të vërtetën. Hajji kishte mekanizma për të mbledhur të gjithë të vërtetën në një pikë, gjë që e ktheu atë në një njeri që mund të dijë gjithçka dhe nuk ka nevojë për asgjë si ndërmjetësim për ta ditur e kjo

Filozofi është Hajji, i cili i vetmuar kërkon të vërtetën në një ishull, Selamani përfaqësohet si një studiues fetar apo i shariatit dhe Ebsali si një sufi. Por të tre llojet e njohurive sipas Ibën Tufejl përkatësisht filozofia, sufizmi dhe shiati, janë shfaqje të ndryshme të së njëjtës të vërtetë të përjetshme.

ishite pikënisja e një bote moderne. Për të parë se si vepra e Ibën Tufejlit pati ndikim në mendimin modern ose iluminizmin perëndimor është e nevojshme që së pari të shikojmë se cilat gjuhë dhe kur është përkthyer kjo vepër.

Në dorë kemi fakte të mjaftueshme të cilat na bëjnë të mendojmë se kjo vepër është një vepër që hapi rrugët që çojnë në mendimin modern perëndimor dhe madje e përcaktoi atë mendim. Ky efekt ndodhë kur pajtohesh me të, apo duke mbajtur qëndrim kundërshtues ose duke e miratuar atë. Meqenëse mendimi nuk pranon ndërprerje, mendimi modern duhet domosdoshmërisht të kalojë nëpër mendimin ekzistues në mënyrë që të arrijë në mendimin e lashtë grek. Kjo vepër është përkthyer në pothuajse të gjitha gjuhët perëndimore dhe është përkthyer jo vetëm një herë, por nga persona të ndryshëm në të njëjtën gjuhë.

Përkthimet më të njohura:

Norbonnelus Moisiu Ibën Jashua e përktheu në hebraisht në vitin 1349;

Pico della Mirandola e përktheu në shekullin XV në latinisht;



Edvard Pocke e përktheu atë në latinisht në 1671 me emrin "Philosophus Autodidactus" dhe me botimin e tij ishte edhe origjinali në gjuhën arabe. Me vonë e përktheu edhe në gjuhën angleze;

G. Keith në anglisht në vitin 1674;

George Ashwell në anglisht në vitin 1686;

Simon Ockley në anglisht në vitin 1701;

Der naturmensch: oder, Geschichte des Hai ebn Joktan: ein morgenländischer roman des Abu Dschafar ebn Tofail në vitin 1783;

Leon Gouthier në frëngjisht në 1900;

Baba zade Reşid u përkthye në turqisht në revistën Mihrab në 1923, pastaj me titullin "Rizgjimi i Shpirtit" u thjeshtua dhe ribotua nga N. Ahmet Özalp.

Këto pra ishin përkthimet kryesore të kësaj vepre në gjuhët perëndimore. Por kjo vepër si u prit nga lexuesi perëndimor. Shembulli më i mirë i vendit të Hajj ibën Jakdhan në mendimin modern perëndimor është shembulli i Leibnitz. Në Opera Divinia, ai flet me admirim se Hajj ibën Jakdhan është ngritur në nivelin e soditjes teologjike.

Samar Attar gjithashtu shkroi për Ibën Tufejlil "Një mentor arab i harruar i mendimtarëve modernë evropianë". Pra ai i drejtohet atij si mësuesi arab i harruar i mendimtarëve modernë evropian. Lawrence Conrad thotë për këtë vepër: "Asnjë vepër tjetër nga trashëgimia letrare arabe nuk është përkthyer aq sa Hajj ibën Jakdhan, me përjashtim të "Një mijë e një netëve". Në një vend tjetër ai thotë: "Kjo vepër tregoi se si mendja njerëzore mund të arrijë nivelet më të larta të njohurive, të cilat kishin një efekt pozitiv në iluminizmin anglez ose skocez, ka të ngjarë që John Locke dhe mendimtarët e tjerë të kenë ditur për këtë vepër sepse përkthimet e veprës ishin të disponueshme në gjuhët perëndimore."

Përderisa kishte nga ata që e shikoni me admirim veprën e Ibën Tufejlil, të tjerët flisnin për rrezikun që mund të

shkaktojë kjo vepër në mendimin perëndimor. Simon Ockley një mësues i gjuhës arabe në Universitetin e Oksfordit, i cili e përktheu Hajj ibën Jakdhan, ai thotë në shtojcën të cilën e vendose pas përkthimit të veprës se ka ide në këtë vepër që mund të kenë një efekt negativ në Angli, dhe thotë se është një punë e rrezikshme.

Condillac, i cili në vitin 1754 e shkroi veprën "Traité des sensations", ka mjaft argumente për ta konsideruar atë një vepër të shkruar si një reagim kundër veprës së Ibën Tufejlil. Në këtë vepër përveç trajtimeve të ndryshme rreth ndjenjave, ai drejton një kritikë ndaj veprës ku flitet për një djalë rreth dhjetë vjeç që jetonte midis arinjve dhe u gjet në vitin 1694 në pyjet ndërmjet Lituaniës dhe Rusisë dhe për shkak se ai u rrit jashtë shoqërisë, ai jetoi plotësisht si kafshë. Ai nuk mund të fliste, por bënte tinguj të pakuptueshëm. Pasi ia mësuan gjuhën këtij fëmije, ai nuk mund të mbante mend asgjë për jetën që jetonte në ato male, kështu që një person si Hajji nuk mund të arrijë asnjë informacion jashtë shoqërisë, i vetëm dhe se njeriu mëson duke përdorur shqisat, jo mendjen njerëzore.

Edhe pse John Locke dhe Hume ishin empirikë, ekziston një probabilitet shumë i lartë që ata të ndikoheshin nga kjo vepër. Para së gjithash, është e mundur që ideja e "natyrës njerëzore" të vijë nga ky libër. Siç dihet, John Locke, mësoi arabisht në vitet e tij të shkollës së mesme, dhe meqenëse ky libër është një vepër që mbetet në krye të mendimit islam, një student ose mendimtar patjetër do të hasë në këtë punë kur merret me mendimin islam. Por ekziston mundësia që John Locke ta kishte lexuar këtë libër edhe në latinisht, sepse kishte një përkthim të veprës në latinisht madje edhe në anglisht ai pati mundësinë të lexonte, sepse kur ishte 42 vjeç, kjo vepër u përkthye në anglisht. Locke ishte një student i Popocke, dhe kështu që patjetër duhej ta njihnte Hajj ibën Jakdhanin.

Sipas Locke, nuk është e nevojshme të sjellësh koncepte nga lindja ose informacion fillestar për të krijuar njohuri, sepse njerëzit për nga natyrshmëria e tyre mund të krijojnë njohuri nga përvoja duke përdorur mendjen e tyre. Me fjalë të tjera, kur Hajji është vetëm me botën e jashtme, ai zgjidh gjithçka vetë. Pra është shumë lehtë e kuptueshme që ideja e "Natyrës (natyrshmëria) së njeriut u formua nga ndikimi i veprës së Ibën Tufejlil në mendimin modern perëndimor. Ne kemi shumë shembuj të tillë ku mundemi ta bazojmë këtë mendim. Mirëpo ajo që dua të them është se modeli njerëzor në Hajj ibën Jakdhan është një nga arsyet e iluminizmit në mendimin modern perëndimor me interpretime të ndryshme. Njeriu në botën modern synohet të paraqitet në një pozitë të vetëmjaftueshmërisë. Unë nuk mendoj se Ibën Tufejlil tha të njëjtën gjë, por kur mendimtarët modernë po interpretonin mendimin e tij, ata arritën në përfundimin se nëse një person mund të gjejë gjithçka vetëm, ai mund të gjejë gjithçka, përfshirë Zotin, mirëpo njeriu mund të mos e ndjejë se ka nevojë për Zotin. Ne jetojmë në një botë që e kemi ndërtuar vetë. Kjo është motoja e mendimit modern perëndimor. Derisa mendimtarët perëndimor interpretonin veprën në fjalë, në botën perëndimore jo vetëm çështjet fetare, por edhe kërkimi i dijes dhe shkencës zhvillohej nën patronazhin dhe me diktatin e kishës dhe papatit. Shkenca është rruga drejt së vërtetës dhe kjo nuk mund të arrihet pa ndërmjetësimin e kishës dhe papatit, pasi ishte vetë papa ndërmjetësuesi i njerëzve për te Zoti. Pra nën këtë atmosferë e lexonin veprën e Ibën Tufejlil, e cila ju dha atyre një dimension tjetër dhe i mësoi ata se kërkimi i së vërtetës mund të bëhet pa ndërmjetësimin e dikujt. Mirëpo asnjëherë të pretendoj se mund të jetohet dhe të kërkohet e vërteta duke u shkëputur nga burimi i së vërtetës.

Msc. Njomza Sadriu

Hulumtim rreth përmbajtjes kimike të kungullit – bimë shëruese nga mjekësia e Pejgamberit a.s.

“Ne bëmë që një bimë kungulli (jaktin) të rritej deri mbi shtatin e tij (profetit Junus).” (Saffat, 146)

Në këtë punim unë kam bërë një përmbledhje të traditës së Pejgamberit a.s., duke u bazuar në librin “Zad el-Mead” (Ibën Kajim el-Xheuzije), i cili na mëson në lidhje me udhëzimet dhe traditën e tij a.s. në fushën e mjekësisë dhe mënyrës së kurimit që ai praktikoi dhe që ua mësoi njerëzve ta ushtronin dhe në mënyrë specifike për dobinë e përdorimit të kungullit, përbërjen kimike të tij nga aspekti im profesional.

Do të përpiqem të shpalosi pak urtësi që fshihen në këshillat dhe udhëzimet e tij në këtë fushë, urtësi të cilat nuk mund t'i nxjerrin e kuptojnë shumica e mjekëve.

Vetëm ata që kanë njohuri të vërteta mbi shkencën e mjekësisë njerëzore dhe mbi mjekësinë profetike mund ta bëjnë dallimin mes tyre. Profetët ishin njerëzit me mendjen më të ndritur dhe me diturinë më të kulluar e më të thellë. Ata ishin dhe mbeten krijesat më të afërta me të vërtetën. Ata janë njerëzit më të mirë që ka zgjedhur Allahu xh.sh., ashtu si pejgamberi Muhamed a.s. është më i miri ndër të gjithë pejgamberët e tjerë. Dituria, urtësia dhe mbrojtja me të cilat Allahu i kishte pajisur pejgamberët dhe të dërguarit e Tij, bëjnë që ata t'i përkasin një kategorie të pakrahasueshme.

Mjekësia profetike përmban në vetvete një element hyjnor. Ky element e bënë krahasimin e mjekësisë profetike me mjekësinë e doktorëve profesionistë të ngjashëm me krahasimin e mjekësisë profesioniste me mjekësinë amatore. Mjekët më të mirë pajtohen me këtë fakt, pasi shkenca me të cilën ata merren është fryt i përqasjeve, eksperimentimeve, frymëzimeve, vizioneve dhe hipotezave.

Kjo lloj njohurie nuk mund krahasohet me Shpalljen që Allahu i Lartësuar ia zbriti Pejgamberit të Tij, ku i shpjegoi se çfarë i bënte dobi dhe çfarë e dëmtonte. Mjekësia e tyre në krahasim me Shpalljen është njëlloj

sikurse dituria e tyre përballë dijes që sollën pejgamberët. Madje, në Shpalljen e Pejgamberit a.s. gjejmë ilaçe që shërojnë sëmundje të cilat është e pamundur t'i shërojnë edhe mjekët më të mëdhenj, sepse njohuritë dhe përvoja e tyre nuk mund ta arrijnë dijen e Shpalljes, e po kështu edhe vëzhgimet e tyre krahasuese nuk bëjnë punë.

Pejgamberi a.s. na mësoi se si kurohet zemra nga çdo gjë që e sulmon atë. Recetat profetike forcojnë zemrën dhe rrisin mbështetjen e plotë tek Allahu dhe varësinë prej Tij. Pejgamberi a.s. na mësoi të drejtuarit vetëm tek Allahu, të përgjëruarit dhe lutjen me përlësi



vetëm përpara Tij, nënshtrimin dhe bindjen e plotë ndaj Tij, na mësoi që shërimin ta gjejmë nëpërmjet sadakasë, lutjes së sinqertë, pendimit të plotë, kërkimit të faljes, bamirësisë ndaj krijesave, ndihmës së njerëzve në nevojë, përpjekjes për largimin e vështirësive dhe fatkeqësive nga të guditurit me to. Të tilla “ilaçe” dhe mënyra kurimi i kanë provuar shumë e shumë njerëz, të cilët kanë parë më pas fryte që kanë qenë të paarrishme prej dijes dhe përvojës njerëzore.

Pejgamberi a.s. ka thënë se: “Për çdo sëmundje ka ilaç.”

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Stomaku është ena qendrore e trupit, dhe venat janë të lidhura me të. Kur stomaku është i shëndetshëm, gjendja e tij bartet në vena, dhe nga ana tjetër venat do të qarkullojnë njëjtë dhe kur stomaku është i prishur, venat do të thithin prishjen nga ai dhe do të vazhdojnë në qarkullim.”

Ushqimet më të preferuara të Pejgamberit a.s. kanë qenë supa, kungulli, buka e elbit, mjalti dhe përsheshi – popara.

Kungulli (jaktin - në arabisht) nuk tregon vetëm kungullin, por shënon çdo lloj bime tjetër që ka kërcell zvarritës, si shalqiri apo kastravec.

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: “Ne bëmë që një bimë kungulli (jaktin) të rritej deri mbi shtatin e tij (profetit Junus).” (Saffat, 146)

Fjala “jaktin” e përdorur në këtë ajet do të thotë “kungull”, i cili ndryshe quhet (në arabisht) edhe dubba. Në dy Sahihët shënohet se, njëherë, një rrobaqepës e ftoi Pejgamberin a.s. në shtëpi për të ngrënë një vakt që ai kishte përgatitur. Bashkë me Pejgamberin a.s. shkoi edhe Enesi r.a.. Rrobaqepësi u nxori bukë prej elbi dhe një supë me kunguj e pastërma. Enesi rrëfen: “Unë e pashë vetë se si i Dërguari i Allahut a.s. i gjurmonte copat e kungullit nëpër pjatë, dhe që atëherë kungulli u bë shumë i dashur për mua.” Ebu Taluti tregon: - Kur hyra njëherë tek Enes ibën Maliku, ai ishte duke ngrënë kungull e duke thënë (duke iu referuar kungullit): “Ti je një bimë shumë e dashur për mua, sepse Pejgamberi a.s. të pëlqente shumë kur të hante.”

Aisheja r.a. ka treguar se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kur zien perime të ndryshme me mish, hidh më shumë kungulleshka në të, sepse ajo është mjet për forcim që e përmirëson zemrën e pikëlluar.”

Kungulli është bimë e ftohtë dhe e lagësht. Ai është një ushqim që tretet lehtë. Nëse kungulli nuk priset në stomak përpara se të tretet plotësisht, ai prodhon një përzierje të mirë atje, sidomos kur shoqërohet me ushqim të përshtatshëm me të. Për shembull, shoqërimi i kungullit me sinap krijon një sekrecion (lëng) të hidhur, ndërsa kur i hedh kripë, e bën atë të kripur dhe, me substanca tkurrëse, sekrecioni bëhet kapsues. Nëse ha kungull të shoqëruar me ftonj, i ke dhënë trupit një ushqim të mirë. Kungulli është i lehtë për stomakun, sidomos për ata që nuk vuajnë nga këlbaza apo nga i ftohti. Lëngu që përmban ai ndihmon në shuarjen e etjes, nëse e pi atë, dhe në qetësimin e dhembjeve të kokës, nëse e lan kokën me të. Kungulli e zbut stomakun, sido që ta përdorësh, dhe është tepër i dobishëm për ata që kanë temperament të nxehtë. Po ashtu, kungulli i përzier me brumë dhe i pjekur në furrë, bashkë me lëngun e tij të përzier me pije të lehta, ndihmojnë në uljen e temperaturës së etheve, shuajnë etjen dhe shërbejnë si 369 ushqim i mjaftueshëm për trupin. Nëse ai përzihet me reçel ftoi dhe mena, asgjëson vrerin. Po ta ziesh kungullin dhe lëngut të përftuar i hedhësh pak mjaltë dhe natrium, ai do të shkaktojë këlbazë dhe acid. Ndërsa po të vësh si kompresë në kokë kungull të shtypur, ai do të lehtësojë gjendjen e xhungave të nxehta në tru. Lëngu i lëkurës së kungullit i përzier me vaj trëndafil ndihmon kundra tumoreve të nxehta, nëse hidhet me pika në vesh. Lëkura e tij qetëson çibanët e nxehtë të syrit dhe shërben kundra përdhesis. Kungulli është tepër i dobishëm për ata që kanë temperament të nxehtë dhe për ata që vuajnë nga ethet. Megjithatë, nëse ai has në stomak me substanca të prishura, atëherë edhe ai priset, duke krijuar atje një përzierje të dëmshme. Në këtë rast, për të shmangur pasojat, njeriu duhet të përdorë uthull ose gjëra të tjera të

tharta. Në përgjithësi, kungulli është një ndër ushqimet më të lehta dhe më të tretshme.

Kungulli nuk përdoret shpesh kohët e fundit, por ai është një burim i mirë i vitaminave, mineraleve dhe përbërësve të tjerë të rëndësishëm. Ka pak kalori dhe tretet lehtë. Kungulli përmban një sasi të vogël të proteinave, karbohidrateve dhe yndyrave, por ka edhe vitaminat A, C, E dhe K, si dhe vitaminat e grupit B. Gjithashtu kungulli është i pasur edhe me fibra dhe për shkak se përmban numër të vogël të kalorive, preferohet që të përdoret edhe nga personat që janë në dietë. Edhe beta karotina është një nga përbërësit e kungullit. Është konstatuar se beta karotina zvogëlon rrezikun e paraqitjes së kancerit të qafës së mitrës, ezofagut, lukthit dhe fytit. Ajo bllokton veprimin e radikaleve të lira, duke penguar kështu dëmtimin e strukturës qelizore të ADN-së.

Disa nga përbërësit që gjenden në kungull:

Vitamina A është përgjegjës për zhvillimin normal, funksionin riprodhues, shëndetin e lëkurës dhe syve dhe ruajtjen e imunitetit.

Vitamina B5 merr pjesë në proteina, yndyra, metabolizmin e karbohidrateve, metabolizmin e kolesterolit, sinteza e një numri të hormoneve, hemoglobinës, promovon thithjen e aminoacideve dhe sheqernave në zorrë, mbështet funksionin e lëvore veshkave. Mungesa e acidit pantotenic mund të çojë në dëmtim të lëkurës dhe mukozave.

Kaliumi është joni kryesor intraqelizor që merr pjesë në rregullimin e ekuilibrit të ujit, acidit dhe elektrolitit, merr pjesë në proceset e impulseve nervore, rregullimin e presionit.

Magnezi është një kripë minerale absolutisht e nevojshme, por që rezulton i mangët në më shumë se 60% të personave (hipomagnezit). Magnezi është një përbërës ushqyes për të ruajtur dhe rikthyer një shëndet të mirë, praktikisht është një

antibiotik natyral, kurë me një efekt të lartë parandalues, efekt të fortë anti-inflamator, imunostimulues, deponues i energjisë, me veti anti-stres, anti-alergjik, alkalinizues, vepron si antacid (stomaku), si oksigjenues i gjakut, rregullues i vlerës së kaliumit dhe kalciumit, element esencial për më shumë se 325 reaksione biokimike, element bazë për çdo farmaci familjare, një element “pothuajse” i panjohur për shumë mjek, mineral i sigurt, nëse merret me tepriçë, thjesht do të nxirret jashtë pa u bashkuar me përbërës të tjerë.

Konsumimi i 28 gram (rreth 142 cope) të farave të kungullit ju mundëson të përfitoni 23 % të nevojës suaj ditore për hekur.

Në tabelat e mëposhtme kam paraqitur përmbajtjen e lëndëve ushqyese (kalori, proteina, yndyra, karbohidrate, vitamina dhe minerale) për 100 gr. pjesë e ngrënë, të cilat janë prezentë në kungull dhe janë përcaktuar në bazë të eksperimenteve laboratorike:

Një hulumtim i bërë kohëve të fundit tregon për përmbajtjen e farave të kungullit nga një varietet tunizian (Béjaoui) i kungujve (*Cucurbita maxima*), të cilat u analizuan për përbërjen e tyre kryesore kimike dhe për vetitë e tyre të vajit. E shprehur në bazë të peshës së thatë, lagështia e farës ishte 8.46%, ndërsa përmbajtja e proteinave, fibrave, hirit, yndyrës dhe sheqernave totale u vendos përkatësisht në 33.92%, 3.97%, 21.97%, 31.57% dhe 0.11%. Kromatografia me gaz zbuloi se acidet yndyrore kryesore ishin acidet oleike, linoleike dhe palmitike (44.11%, 34.77% dhe

1. Lëndë ushqyese	Sasia
Vlera e kalorive	116.9 kCal
Proteinat	2.6 g
Yndyra	7.9 g
Karbohidratet	9.4 g
Acide organike	0.1 g
Ujë	148.8 g

2. Vitaminat	Sasia
Vitamina A, RE	2100 µg
Retinol	2.1 mg
Vitamina B	6.57 mg
Vitamina C, askorbike	2.6 mg
Vitamina D, kalciferol	0.02 µg
Vitamina E, alfa tokoferol, TE	0.6 mg

3. Elementet kimike (Makronutrientët)	Sasia
Kaliumi, K	283 mg
Kalcium, Ca	52.9 mg
Silic, Si	3.1 mg
Magnez, mg	23.5 mg
Natriumi, Na	7 mg
Squfuri, S	31.2 mg
Fosfori, P	53.6 mg
Klori, Kl	28.2 mg

4. Karbohidratet e tretshme	Sasia
Amidoni dhe dekstrinat	3.3 g
Mono dhe disakaride (sheqerna)	4.9 g

15.97% respektivisht). Vaji i farës u gjet gjithashtu i pasur me tokoferole me një mbizotërim të δ-tokoferolit (42.27%). Marker i sterolit β-sisosterol përbën 39,6% të steroleve totale që përmban vaji i farës së kësaj

varietetit. U zbuluan gjashtë acide fenolike (protokatekuik, kafeik, siringik, vanil, p-kumarik dhe ferulik), ku mbizotëronte acidi siringik (7.96 mg/100 g). Në tërësi, bazuar në veçoritë e vajit të farës, kungulli mund të konsiderohet si një burim i vlefshëm për produkte të reja me shumë qëllime për përdorim industrial, kozmetik dhe farmaceutik.

Kungull i zier është i pasur me vitamina dhe minerale si: vitamina A - 233,3%, vitamina B5 - 12%, kalium - 11,3%, kobalt - 17%, mangan - 14,6%, bakër - 28,1%

Në këtë artikull u përmendën disa nga dobietë e përdorimit të kungullit, përparësitë në shëndetin e njeriut si dhe rëndësia e kësaj kulture në jetën e Pejgamberit a.s..



Agron M. Rexhepi, Ph.D. M.D.

Çrregullimet e peshës trupore

Mbipesha trupore është një gjendje patologjike kronike e organizmit që dita-ditës po merr përmasa epidemiologjike, ndërkaq definohet si akumulim – grumbullim i tepërt i indit dhjamor në trup, e që në vete bart rrezik të madh për funksionimin normal të organizmit të njeriut.

“Ushqimi i përgatitur për dy, është i mjaftueshëm për tre, ...” (Hadith)

Të ushqyerit nënkupton furnizimin e qelizave të organizmit me materie ushqyese të domosdoshme për vazhdimin e jetës. Krijesat e gjalla gjatë tërë jetës së tyre në organizëm marrin materie ushqyese nga ambienti i jashtëm, të cilat i ndryshojnë dhe si të tilla i nxjerrin prapë në ambientin e jashtëm.

Përmes të ushqyerit në organizëm merret energjia, si dhe substancat ushqyese dhe mbrojtëse të domosdoshme për rritje, zhvillim, regjenerim, mbajtjen e funksioneve vitale dhe për punë. Të ushqyerit e rregullt dhe të shëndosh, si në aspektin kohor, sasior ashtu edhe në atë cilësor, në mënyrë sinjifikante ndikon në arritjen dhe ruajtjen e shëndetit të mirë, në rritjen e performancave të sportistëve dhe në përmirësimin e rezultateve sportive, dhe anasjelltas.^{8,12,13}

Sipas nevojës, organizmi i njeriut ka aftësi që materiet ushqyese të përbëra t'i shndërroj në të thjeshta dhe anasjelltas. Një pjesë e këtyre bashkëdyzimeve përdoren për ndërtimin dhe rigjenerimin e qelizave, indeve dhe organeve të organizmit, pjesa tjetër zërthehet, me ç'rast lirohet energjia e nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit dhe për kryerjen e punëve, ndërkaq, pjesa tjetër e bashkëdyzimeve shërbejnë si rezerva të organizmit.

Nga 9 kg yndyra, vetëm 1 kg ndodhet në inde të caktuara, ndërsa pjesa tjetër prej 8 kg paraqet rezervën e organizmit, e cila sipas nevojës mund të shfrytëzohet

(uria, sëmundja). Në personat e trashë (me mbipeshë) rezervat e yndyrës në organizëm janë shumë më të mëdha, mund të arrijnë edhe në 70% të peshës së përgjithshme trupore.^{4,8,12,13}

Pjesa më e madhe e proteinave hynë në përbërjen e qelizave të indeve të ndryshme, ndërkaq vetëm 2 kg proteina mund të shfrytëzohen si rezerva të organizmit pa u shkaktuar pasoja të mëdha për organizëm.^{12,13}

Përkundër yndyrave dhe proteinave, sasia rezervë e karbohidrateve që ndodhet në organizëm është rreth 500 gramë. Kjo sasi, në gjendje të ndryshme të organizmit (p.sh. uria) mbetet konstante falë procesit të glikoneogjenezës (rigjenerimi i karbohidrateve nga rezervat e proteinave dhe yndyrave).^{12,13}

Me kalimin e moshës, organizmi i njeriut pëson disa ndryshime fiziologjike, si p.sh. zvogëlimi i sasisë së përgjithshme të ujit në organizëm (lëngu jashtë dhe brenda qelizor). Kjo gjendje paraqet një pasqyrë fiziologjike të plakjes.¹² Njeriu i ushqyer normal e ka një përbërje të caktuar dhe konstante të përbërjes kimike.

Prishja e baraspeshës së përbërjes kimike nën ndikimin e ushqimit bëhet me tepriçë apo mungesë të materieve ushqyese.

Nëse konsumohet tepër ujë, ai eliminohet nga organizmi, përderisa pakica shkakton zvogëlimin e sasisë së ujit në organizëm (dehidrimi dhe pasojat e tij). Marrja e tepërt e proteinave, karbohidrateve apo yndyrave shkakton rritjen e sasisë së yndyrave në organizëm, përderisa mungesa e tyre shkakton zvogëlimin e proteinave, respektivisht të yndyrave në organizëm. Teprica e mineraleve në ushqim largohet nga organizmi, ndërsa zvogëlimi i tyre e shkakton zvogëlimin e përgjithshëm të

Që të eliminohet faktori i ushqimit si prishës i baraspeshës së përbërjes kimike të organizmit duhet që ushqimi të jetë sa më natyral, i llojllojshëm (llojet e ndryshme të ushqimit përmbajnë lloje të ndryshme të substancave të nevojshme për organizmin) dhe të merret në sasi të caktuar.

tyre në organizëm. Teprica në ushqim e vitaminave të tretshme në ujë nuk shkakton asnjë ndryshim, por eliminohet nga organizmi, përderisa teprica e vitaminave të tretshme në yndyra deponohet në indin dhjamor dhe mund të shkaktojë hipervitaminozë, ndërkaq mungesa e vitaminave në organizëm shkakton çrregullime të ndryshme biokimike. Që të eliminohet faktori i ushqimit si prishës i baraspeshës së përbërjes kimike të organizmit duhet që ushqimi të jetë sa më natyral, i llojllojshëm (llojet e ndryshme të ushqimit përmbajnë lloje të ndryshme të substancave të nevojshme për organizmin) dhe të merret në sasi të caktuar.

Realizimi dhe mirëmbajtja e shëndetit të mirë është qëllimi i përbashkët për të gjitha kategoritë e popullatës. Ndër

faktorët që marrin pjesë në realizimin e këtij qëllimi janë: jeta fizikisht aktive dhe të ushqyerit e rregullt (nga aspekti kohor, sasi dhe cilësor), dhe hidratimi i rregullt i organizmit. Këta faktorë ndihmojnë mbajtjen në ekuilibër të energjisë që organizmi e merr në formë të materieve ushqyese (energji hyrës) dhe të energjisë që organizmi e shpenzon (energji dalës).^{12,13}

Dita-ditës, çrregullimet e peshës trupore po bëhen probleme të mëdha shoqërore, që atakojnë të gjitha vendet dhe të gjitha popullatat, pa marrë parasysh gjininë apo moshën. Mbajtja e peshës trupore në "vlera normale" varet nga ndërlydhja ndërmjet tre faktorëve: oreksit dhe llojit të ushqimit që konsumohet, aktivitetit fizik dhe metabolizmit në gjendje pushimi, respektivisht nga gjendja dhe raporti ndërmjet këtyre tre faktorëve determinon se a do të kemi konservim apo shpenzim të energjisë.

Çrregullimet e peshës trupore mund të lajmërohen në formë të mbipeshës trupore dhe nënpeshës trupore, e që të dyja lajmërohen kryesisht si pasojë e faktorëve psikogjenë, patologic, dhe shprehive të këqija, siç janë: kequshqyeshmëria (nga aspekti kohor, sasi dhe cilësor), jeta fizikisht jo aktive, dhe konsumimi i substancave me veprim të drejtpërdrejt në metabolizmin e njeriut. Pasi që organizmi i njeriut gjithnjë tenton që të ruaj mirëqenien e vetë, në rastet kur kemi shtim të peshës trupore mbi vlera normale, organizmi e

përshpejton metabolizmin dhe bënë krejt çka është e mundur që të rritë shpenzimin e energjisë dalëse, ndërkaq kur kemi të bëjmë me humbje të peshës trupore ndër vlera normale zvogëlohet metabolizmi me qëllim të ruajtjes së energjisë së konservuar. Në rastet patologjike kur ky mekanizëm mbrojtës i organizmit nuk funksionon si duhet, ndërsa oreksi është i rritur dhe aktivitetet fizike janë të pakta, mbipesha trupore me grumbullim të indit dhjamor janë të pashmangshme.

Mbipesha trupore është një gjendje patologjike kronike e organizmit që dita-ditës po merr përmasa epidemiologjike, ndërkaq definohet si akumulim – grumbullim i tepërt i indit dhjamor në trup, e që në vete bart rrezik të madh për funksionimin normal të organizmit të njeriut, p.sh. 15 kg mbi peshën normale do të shkaktojë probleme të shumta shëndetësore.^{3,8,9,11,12}

- Insuficiencia (pamjaftueshmëria) kardiake (sidomos e zemrës së majtë), si rezultat i punës së rritur të zemrës;
- Hipertensioni dhe infarkti i zemrës;
- Diabeti (më se 80% të pacientëve që vuajnë nga sëmundja e sheqerit kanë mbipeshë trupore);
- Sëmundjet veshkore;
- Sëmundjet mushkërore dhe rënia e funksionit respirator në përgjithësi për shkak të vështirësisë së lëvizjes së kafazit të kraharorit gjatë frymë këmëbimit;
- Osteoarthritis-i dhe sëmundjet e tjera degjenerative të nyjëtimeve;

- Disa lloje të sëmundjeve kanceroze;
- Vlerat jo normale të lipideve dhe lipoproteineve në plazmë;
- Çrregullimet menstruale;
- Ngarkesa e madhe psikike;
- Problemet e udhëheqjes së anestezionit gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale;

Humbja e peshës te personat e trashë gjithsesi do të ndikonte në zvogëlimin e nivelit të kolesterolit dhe të triglicerideve në serum, si dhe ndikon në uljen e tensionit arterial.^{3,8,9,11,12}

Te të rriturit, diagnostikimi i mbipeshës (trashësisë) me karakter dhjamor bëhet në qoftë se masa dhjamore e kalon 20% të masës së përgjithshme trupore te meshkujt dhe 30% te femrat, respektivisht perimetri i barkut në nivel të kërthizës te meshkujt mbi 100 cm dhe te femrat mbi 90 cm.^{3,4,12,13}

Faktorët që ndihmojnë në shkaktimin e trashjes janë: konsumimi i tepërt i ushqimit, faktorët gjenetikë (25-30%), social, psikologjikë, ambienti, çrregullimet hormonale, niveli i metabolizmit bazal, temperatura bazale e trupit, niveli i aktivitetit spontan, nivelet e adenozinë trefosfatazës qelizore, nivelet e lipoprotein lipazës dhe enzimave të tjera.

Anoreksia (humbja e oreksit) dhe bulimia (të vjellët me qëllim) janë dy gjendje të tjera patologjike, në të shumtën e rasteve me etiologji psikogjene, që kanë të bëjnë me çrregullimet e peshës trupore të llojit të nënpeshës. Megjithatë shkaqet e këtyre patologjive mund të jenë të shumta si: çrregullimet endokrine, humbja apo braktisja e të afërmeve, ngjarjet traumatike si për individin ashtu dhe familjarët e tij. Anoreksia ka qenë e përshkruar për herë të parë në vitin 1689 nga Morton, kurse bulimia në vitin 1979 nga Russell. Këto dy patologji janë shqetësime të rënda psikologjike që e rrënojnë seriozisht shëndetin e njeriut. Kequshqyeshmëria dhe të vjellët e provokuar shpesh shkaktojnë dëme të vazhdueshme në aparatit tretës si dhe i prishin dhëmbët. Anoreksia dhe bulimia e vazhdueshme shkaktojnë gjendjen e dehidrimit, hipokalieminë, çrregullimin e punës së sistemit kardiovaskular, amenorrenë dhe osteoporozën.

Përderisa mbipesha trupore shoqërohet me patologji të shumta, anoreksia nëse nuk intervenohet me kohë, me siguri të plotë çon në vdekje. Për rrezikshmërinë



e anoreksisë flet mendimi i shumë ekspertëve se vetëm 25% e pacientëve me anoreksi mund të trajtohen suksesshëm, nëse trajtimi fillon në kohë. Hulumtuesit kanë bërë një testim neuropsikologjik në 200 persona në anoreksi dhe kanë gjetur se 70 % prej tyre kishin pësuar dëmtime neuro-ransmetuese, që manifestohej me mos komunikim normal të qelizave të trurit me qelizat e tjera të trupit.

Anoreksia dhe bulimia që nga vitet e 80-ta kanë marrë përmasa epidemiologjike duke atakuar kryesisht vendet e zhvilluara.^{1,2} Studimet tregojnë se 80% e vajzave dhe grave amerikane janë të pakënaqura me trupin e tyre. Sipas statistikave rreth 11 milionë amerikanë vuajnë nga anoreksia, prej tyre 10 milionë janë femra. Shumë nga këta pacientë vuajnë nga anoreksia apo pasojat e saj gjatë gjithë jetës.

Në përgjithësi, edhe pse jo e shëndetshme, shumë modele duke dashur të jenë sa më të bukura tentojnë të jenë sa më të dobëta. Ndërkaq, përmes pamjeve të modeleve në revista, femrat e moshave të ndryshme (12-25 vjeçare, kohët e fundit edhe mbi moshën 30 vjeçare) duke tentuar që të arrijnë këtë pamje, kanë tendencë për të reduktuar ushqimin dhe preferojnë të ushqehen me ushqime të pakta, të thata dhe të lehta. Të përmendim pacienten e mjekut psikiatër Xhorxh Groves, vajzën 23 vjeçare, e cila ishte e gjatë 1.79m dhe peshonte vetëm 25.5 kg. Edhe me këta parametra morfometrik kjo vajzë mendonte se ka ende peshë të tepërt të cilën duhet ta largoj medoemos.


Diagnostikimi i anoreksisë bëhet nëse:

Pesha trupore është 15% nën peshën ideale;

Frika e ekzagjeruar dhe e përhershme për të mos shtuar peshë trupore;

Imazhi i deformuar mbi formën dhe masën e trupit të tyre (kur personi mendon se është shumë i trashë edhe pse në realitet është shumë i dobët);

Mungesa e të paktën tri cikleve menstruale njëra mbas tjetrës.



Bulimia nënkupton humbjen e kontrollit në të ushqyer dhe menjëherë pas të ushqyerit provokimin e të vjellit me qëllim të nxjerrjes jashtë të materieve ushqyese të konsumuara. Pra, bulimiti i japin liri vetes në konsumimin e të gjitha ushqimeve, por përmes të vjellit të provokuar dhe përdorimit të mjeteve laksative nuk lejojnë që ushqimet e konsumuara t'ju nënshtrohen proceseve të plota digjестive në traktin tretës.^{5,6,7}

Diagnostikimi i bulimisë bëhet nëse:

Episodet bulimike përsëriten të paktën dy herë në javë gjatë të paktën tre muajve;

Mos kontrollimi i të ushqyerit;

Provokimi i vjelljes dhe përdorimi i mjeteve laksative, diuretikëve, barnave të ndryshme, dietave dhe aktiviteteve të sforcuara fizike për të penguar shtimin e peshës trupore;

Imazhi për veten e tyre është i ndikuar nga pesha trupore.

Personat të cilët vuajnë nga bulimia mbajnë sekret problemin e tyre, kanë një dëshirë të madhe për të ngrënë gjëra të ëmbla, mund të kenë simptoma depresive, turbullime të gjumit dhe humbje të shpresave.^{5,6,7}

Për t'ju shmangur çrregullimeve të peshës trupore sigurisht se një kujdes të posaçëm duhet kushtuar mënyrës së të ushqyerit, e cila është rezultat i edukimit, arsimimit, mundësive ekonomike dhe shprehisë së individit. Po ashtu, e një rëndësie të posaçme është edhe përcaktimi i peshës ideale dhe kompozicionit të trupit që arrihen përmes matjeve të sakta morfometrike.

Përcaktimi i peshës ideale për individ të caktuar është një punë shumë komplekse. Para se të bëhet çfarëdo veprimi në këtë drejtim duhet që të kuptojmë se sa është individ i nënshtruar me peshën që e ka, si e ndien veten (i dobët apo i fortë) dhe gjithësesi duhet të përcaktohet raporti ndërmjet

masës dhjamore dhe masës muskulore të tij. Në përcaktimin e peshës ideale gjithësesi duhet të merret parasysh dendësia e eshtrave, masa muskulore, masa dhjamore dhe raporti i masës dhjamore me masën muskulore.

Shumë nutricionist mendojnë se mënyra më e mirë e arritjes së peshës ideale është dieta e bazuar në parimet e të ushqyerit të shëndoshë e shoqëruar me shtimin e aktiviteteve fizike. Kjo nuk do të thotë se duhet t'i nënshtrohemi një diete strikte e as të "ndëshkohemi" me aktivitete fizike të sforcuara, por shprehitë e "këqija" në të ushqyer duhet të zëvendësohen me shprehi të "mira", dhe aktivitete fizike të jenë të nivelit mesatar. Llogaritja e kalorive që konsumohen dhe i atyre që shpenzohen, e sipas nevojës ndikimi pozitiv apo negativ në balancën e tyre, po ashtu është faktor i rëndësishëm në kontrollin e peshës trupore.

REFERENCA

1. Anoreksia nervosa. http://id.wikipedia.org/wiki/Anoreksia_nervosa
2. Anoreksia. <http://anorexia.emedtv.com/anorexia/anoreksia.html>
3. Barlow CE, Kohl HWI, Gibbons LW, Blair SW. Physical fitness, mortality and obesity. *Int J Obes.* 1995;19 (suppl)4:S41-S4. Blundell JE, Burley VJ. Evaluation of the satiating power of dietary fat in man. *Obesity in Europe 90.* London: John Libbey, 1990.
4. Bouchard C, Perusse C, Leblanc C, et al. Inheritance of the amount and distribution of human body fat. *International Journal of Obesity.* 1988;12:205-15.
5. Bulimia nervosa. http://en.wikipedia.org/wiki/Bulimia_nervosa
6. Bulimia nervosa, signs, symptoms, treatment and help. http://www.helpguide.org/mental/bulimia_signs_symptoms_causes_treatment.htm
7. Bulimia symptoms. <http://psychcentral.com/disorders/bulimia-bulimia-nervosa-symptoms/>
8. Burke L., Deakin V. *Clinical sports nutrition*, 2000.
9. Obesity and overweight. <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs311/en/>
10. Overweight. <http://en.wikipedia.org/wiki/Overweight>
11. Overweight news, articles and information. <http://www.naturalnews.com/overweight.html>
12. Rexhepi A. *Nutricioni dhe sportistët.* Prishtinë, 2010.
13. Rexhepi A. *Mjekësia Sportive.* Prishtinë, 2008.

Xhamia Qendrore e Kembrixhit

Xhamia Qendrore e Kembrixhit është xhamia e parë ekologjike në Evropë dhe xhamia e parë e ndërtuar qëllimisht brenda qytetit të Kembrixhit, në Angli.

Eko-xhamitë janë gjithnjë e më të zakonshme në Marok dhe Indonezi, por Xhamia Qendrore e Kembrixhit është eko-xhamia e parë në Evropë dhe ka një gjurmë karboni zero. Çdo detaj i xhamisë është projektuar për të minimizuar ndikimin mjedisor.

Xhamia, me brendësinë e saj të ngjashme me pyllin, i bën homazh theksit të Islamit mbi shenjtërinë e botës natyrore dhe urdhrin për të shmangur shpenzimet e kota dhe të tepruara.

Në hyrje të xhamisë ndodhet një kopsht me ulëse për të gjithë komunitetin lokal. Përveç zonave të dedikuara të xhamisë (abdesi, mësimi, zona për fëmijë, morgu), ekziston një kafene, zona mësimore dhe dhoma takimi për përdorim nga komunitetet lokale myslimane dhe jomyslimane.

Xhamia ka qenë një projekt komunitar në çdo fazë të zhvillimit të saj. Shqetësimet e banorëve për parkimin çuan në përfshirjen e një parkingu nëntokësor me 76 hapësira në projekt. Kjo ka ulur ndjeshëm presionin e parkimit rreth xhamive të tjera në Kembrixh.

Qëllimi i saj është të përmbushë nevojat e komunitetit mysliman në Britani dhe më gjerë, duke lehtësuar praktikën e mira në besim, zhvillimin e komunitetit, kohezionin shoqëror dhe dialogun ndër-fetar.

Menaxhimi i përditshëm i xhamisë kryhet nga personeli dhe vullnetarë meshkuj dhe femra, nën drejtimin e drejtorit të xhamisë (pozicioni aktualisht i lirë). Imami



kryesor i xhamisë është dr. Sejad Mekiq, një shtetas britanik me origjinë boshnjake, i cili ka një doktoratë nga SOAS, Universiteti i Londrës. Ai ndihmohet nga imami Ali Tos, i cili ka lindur në Konya, Turqi dhe ka një master në studime fetare nga Universiteti Howard (ShBA).

Xhamia u financua nga mbi 10,000 donacione private dhe publike, vendase dhe ndërkombëtare dhe ka qenë në ndërtim e sipër që nga blerja e tokës në shkurt 2008.

Donatori kryesor ka qenë një konsorcium i agjencive qeveritare në Republikën e Turqisë, së bashku

me një kompani private turke (Yapi Merkezi), dhe Fondi Kombëtar i Katarit. Toka për xhaminë u ble në vitin 2008 dhe zyrtarisht hapi dyert për publikun më 24 prill 2019.

Xhamia është normalisht e hapur për vizitorët nga ora 12:30 deri në 19:30. Ajo mund të strehojë deri në 1000 adhurues. Para hyrjes në kopshtin e xhamisë, të gjithë vizitorët luten të prezantohen me kujdestarin e xhamisë në kabinën e pritjes.¹

Përktheu nga gjuha angleze **Mr. Muzaqete Kosumi**

1. <https://cambridgecentralmosque.org/faq/>

BIK-ut i dorëzohet biblioteka 100 vjeçare e ish-myftiut të Shkodrës dhe Kosovës, Salih Myftiut


Më 3 nëntor, biblioteka e vjetër mbi 100 vjeçare, e ish-myftiut të Shkodrës dhe Kosovës, Salih Myftiut, është dorëzuar në Bashkësinë Islame të Kosovës, gjegjësisht në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame. Dorëzimi i kësaj biblioteke është bërë nga nipi i ish-myftiut, Salih Myftiut përmes veprimtarit nga ShBA, prof. Elez Osmani, i cili i dorëzoi BIK-ut këtë bibliotekë të pasur me Kuran, literaturë e dorëshkrime mbi 100 vjeçare të vjetra. “Këto vepra dhe dorëshkrime kanë një vlerë jashtëzakonisht të madhe dhe po bëhet një rikthim i këtij personaliteti në mesin e shqiptarëve, besimtarëve dhe jo vetëm të besimit islamë, ngase nga shihet përveç dorëshkrimeve që kanë të bëjnë me fenë sa pash unë ka të bëjnë me lëndën e tefsirit, hadithit, akaidit, fikhut, kemi edhe disa shkrime për gjendjen aktuale që ka pasur atëherë në atë kohë populli ynë dhe gëzimin e madh që kanë pasur shqiptarët kur Shqipëria fitoi pavarësinë më 1912 dhe Salih Myftiu

i shkruan edhe këtij gëzimi”- tha Myftiu Tërnavë.

Me këtë rast, Osmani vlerësoi lart kontributin dhe figurën e Salih Myftiut. “Rrugëtimi i këtyre librave është paksa interesant. Salih Myftiu ishte i detyruar ta lëshoj vendlindjen e tij sepse nuk pajtohej me regjimet komuniste, andaj u detyrua ta braktiste, dhe këto libra i ka bartë me vete nga ka shkuar si Egjipt, Stamboll e Evropë dhe kanë përfunduar në Amerikë. Ai aty ka pasur një aktivitet të bujshëm, ku me imam Isa Hoxhën e kanë themeluar “Albanian Islamic Centre” në Nju York. Salih Myftiun të gjithë e njohin, por edhe shkrimet e pakta që janë bërë me të, ishte alim i shquar dhe ka lanë gjithandej një vulë të diturisë së tij. Është një literaturë që është shfrytëzuar në universitet arabe si tefsire, kritikë etj., por janë edhe dorëshkrimet që ai i ka punuar nga thesari i gjerë i diturisë librare”- u shpreh Osmani.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora vlerësoi lart punën dhe

angazhimin e Salih Myftiut, duke nënvizuar se ai ishte një kolos i madh i shkrimit dhe mendimit islam, por ishte edhe një lider apo strateg shpirtëror sepse ishte myfti i Shkodrës dhe Kosovës. “Detyrë e jona tash është që përkundër pak të dhënave që kemi pasur për këtë figurë fetare, tash këto dorëshkrime që i kemi në dorë do të na ndihmojnë që edhe më tutje ta ndriçojmë figurën e këtij dijetari të madh dhe ne si Institucion do ta themelojmë një komision për studimin e këtyre dorëshkrimeve”- u shpreh Bajgora. Në fund prof. Bajgora apeloj te të gjithë ata që kanë dorëshkrime të tilla, që mos të hezitojnë, por t’ia dorëzojnë Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në mënyrë që ne të themelojmë bibliotekat e hoxhallarëve dhe dijetarëve tanë të mëhershëm, që të ndriçojmë sado pak një pjesë të jetës dhe veprës së tyre që mos t’i mbuloj harresa, sepse me kalimin e viteve fitojnë një vlerë dhe peshë shkencore. (R.S.)



Myftiu Tërnavë priti në takim koordinatorin e Qendrës Kulturore të Kosovës në Bursa, z. Rexhep Gyndyz

Më 5 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, priti në takim koordinatorin e Qendrës Kulturore të Kosovës në Bursa, z. Rexhep Gyndyz. Në këtë takim Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin mbi organizimin dhe aktivitetet e BIK-ut, duke theksuar se në vazhdimisht jemi përpjekur dhe kemi dëshmuar se shoqëria jonë kosovare është shoqëri që respekton diversitetin fetar dhe kulturor të të gjitha komuniteteve, ku komunitetet fetare në Kosovë jetojnë në paqe, harmoni dhe dashuri njeri me tjetrin. Ai më pas tha se Kosova asnjëherë nuk do të harroj mërgatën tonë kudo që të jenë, e veçanërisht në Turqi, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh për Kosovën në të

gjitha periudhat. Nga ana e tij, koordinatori i Qendrës Kulturore të Kosovës në Bursa, z. Rexhep Gyndyz shprehu falënderime për Myftiun Tërnavë dhe BIK-un për pritjen.

Në këtë takim po ashtu u diskutua për iniciativën e BIK-ut për

organizimin e 100 vjetorit të shkrimit të himnit kombëtar turk nga Mehmet Akif Ersoj (pejanit). Në takim po ashtu u bisedua për shtimin dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral në të mirë të vendit tonë. (R.S.)



Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e BFI-së së Maqedonisë Veriore, Reisul Ulema hfz. Shaqir ef. Fetahi

Më 5 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Reisul Ulema hfz. Shaqir ef. Fetahin. Myftiu pasi i dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, i njohu ata me aktivitete dhe funksionimin e BIK-ut dhe me sfidat me të cilat po ballafaqohet në

kohën e pandemisë, si dhe me mënyrat se si të përmirësohet jeta e besimtarëve qoftë në aspektin fetar, e po ashtu edhe në aspektin kombëtar. Në anën tjetër, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, Reisul Ulema hfz. Shaqir ef. Fetahi falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen, duke çmuar punën dhe angazhimin

e BIK-ut në promovimin e jetës dhe vlerave fetare si dhe harmonisë dhe tolerancës që mbretëron në mjedisin tonë shqiptar. Po ashtu në këtë takim u bisedua edhe për bashkëpunimin dhe koordinimin për projektet e përbashkëta ndërmjet dy bashkësive fetare dhe në të mirë të popullit tonë. (R.S.)



Myftiu Tërnavë priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Ferenc Kajári

Më 8 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Ferenc Kajári. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje gjeneralmajorit Kajári, të cilin e uroi për detyrën, duke e vlerësuar kontributin e forcës shumëkombëshe në sigurimin e një ambienti të qetë e të sigurt në Kosovë, si dhe i dëshiroi punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij.

Ai më pas e njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Myftiu Tërnavë edhe njëherë shprehu mirënjohjen e tij për misionin dhe përkushtimin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it, duke shprehur kështu vlerësimin dhe respektin e lartë që kanë qytetarët e Kosovës për ta.

Ai më tej theksoi se forcat e KFOR-it deri më tash kanë kontribuar jo vetëm në fushën e sigurisë, por edhe në projekte të



ndryshme infrastrukturore, sikurse edhe në fushën e shëndetësisë në përballje me pandeminë, ku edhe me institucionet e BIK-ut janë zhvilluar shumë projekte të përbashkëta në të mirë të komunitetit.

Nga ana e tij, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor, Ferenc Kajári falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe nëpërmes tij vlerësoi lart punën dhe angazhimin që ka

BIK-u për mirëqenien e të gjithë qytetarëve, duke vlerësuar kështu harmoninë ndërfaqetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet gjithë qytetarëve pa dallim. Ai shfaqti gatishmërinë e tij dhe të KFOR-it për krijimin e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe se bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe KFOR-it do të vazhdojë edhe më tej. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim drejtorin e përgjithshëm të shkollave "Maarif" në Kosovë

Më 8 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim drejtorin e përgjithshëm të shkollës "Maarif" në Kosovë, z. Oğuz Hamza Yılmaz. Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi mirëseardhje mysafirrit dhe shprehu falënderime për popullin, qeverinë dhe presidencën turke për kontributin që kanë dhënë në zhvillimin dhe ngritjen e infrastrukturës dhe trashëgimisë kulturore e historike në Kosovë, si dhe për bashkëpunimin që kanë pasur deri më tani, duke vlerësuar se bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe Fondacionit "Maarif" në Kosovë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij drejtori Yılmaz, theksoi se deri më tani kanë pasur

një bashkëpunim shumë të mirë me Kryesinë e BIK-un, si dhe uroi që ky bashkëpunim të thellohet edhe më

shumë në të mirë të popullit të Kosovës. (R.S.)



Myftiu Tërnavë takoi imamët dhe administratën e KBI-së së Mitrovicës

Më 10 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me kryeimamin e Kosovës, Vedat ef. Sahitin, kanë takuar imamët dhe administratën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Mitrovicës, me të cilët diskutoi për të arriturat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky Këshill.

Fillimisht një fjalë rasti në këtë takim e mbajti kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Enis ef. Rama, i cili falënderoi Myftiun Tërnavë për këtë vizitë dhe për përkrahjen e tij të vazhdueshme dhënë për Këshillin e Mitrovicës.

Myftiu Tërnavë falënderoi të gjithë imamët dhe nëpunësit fetarë të Këshillit të Mitrovicës për kontributin

e tyre të dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare. Theks të veçantë Myftiu Tërnavë i kushtoi edhe mësimbesimit, për të cilin porositi që t'i kushtohet edhe më tej rëndësi të

madhe, ngase e kemi amanet dhe borxh për brezat e rinj.

Në këtë takim u diskutua edhe për tema të tjera me rëndësi për Këshillin e BI-së së Mitrovicës.



Myftiu Tërnavë priti në takim u.d. ministren e Shëndetësisë, dr. Dafina Gexha-Bunjaku



Më 11 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim u.d. ministren e Shëndetësisë, dr. Dafina Gexha-Bunjaku, ku temë diskutimi ishte parandalimi i pandemisë globale COVID-19. Myftiu Tërnavë edhe një herë shprehu mbështetjen e plotë të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës për respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së virusit. Ai më tej tha se edhe ne si BIK me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, në përputhje me masat e reja

anti-covid, kemi njoftuar imamët e nëpunësit fetarë për masat e reja të Qeverisë dhe vendimin e Kryesisë së BIK-ut mbi kryerjen e riteve fetare me xhemat në objektet fetare dhe hapësirat përreth tyre bazuar në manualin anti-covid.

Në anën tjetër, u.d. ministrja e Shëndetësisë, dr. Dafina Gexha-Bunjaku, shprehu mirënjohjen për rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në këtë kohë pandemie, por edhe bashkëpunimin e shkëlqyer me Ministrinë e

Shëndetësisë dhe ka apeluar qytetarët që të kenë kujdes të shtuar për shëndetin e tyre dhe mos të hezitojnë nga vaksinimi.

Në këtë takim, po ashtu u bisedua edhe për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërinstucional, të komunikimit të ndërsjellë dhe ndërveprimit institucional në shërbim të qytetarëve. Theks të veçantë iu kushtua edhe rëndësisë së vaksinimit dhe zbatimit të masave kundër Covid-19, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik. (R.S.)

Myftiu Tërnavë uroi rizgjedhjen e reisit të BI-së së Malit të Zi, Rifat ef. Fejziq

Më 11 nëntor, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka dërguar letër urimi me rastin e rizgjedhjes së reisit të Bashkësisë Islame të Malit të Zi Rifat ef. Fejziq. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë i uroi reisit punë të mbarë dhe të suksesshme në udhëheqjen e këtij institucioni, duke shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton, që edhe më tej të vazhdojë bashkëpunimi i shkëlqyer në të mirë të besimtarëve, vendeve dhe shteteve tona.

Në vazhdim letra e plotë e Myftiut Tërnavë drejtuar reisit Fejziq:

I nderuari Reis ef. Fejziq,

Në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, institucioneve të saja dhe në emrin tim personal, me respekt e kënaqësi ju përgëzoj me rastin e rizgjedhjes tuaj në krye të Bashkësisë Islame në Republikën e Malit të Zi, duke lutur Krijuesin e gjithësisë që të keni shëndet, suksese e mbarësi në misionin tuaj.

Rizgjedhja e juaj në krye të Bashkësisë Islame në Mal të Zi, tregon më së miri



besimin e besimtarëve dhe strukturave të Bashkësisë Islame në punën, angazhimin dhe vizionin tuaj të deritashëm si udhëheqës i Bashkësisë Islame, mision të cilin jam i bindur që me ndihmën e Zotit do ta kryeni me sukses edhe në këtë mandat.

I nderuar Reis Fejziq, bashkëpunimi ynë i deritashëm ka qenë i shkëlqyer, me lejoni që të ritheksoj edhe me këtë rast gatishmërinë e Bashkësisë Islame të

Kosovës dhe timen që bashkëpunimi ynë në të ardhmen të arrij nivele edhe më të larta.

Duke ju uruar e përgëzuar, lus Zotin Fuqplotë që të tju japë shëndet, mbarësi e suksese në misionin tuaj sa të rëndësishëm e fisnik!

Me shpresë që së shpejti t'ju takoj, ju përshëndes me selam!

Kryetari

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Myftiu Tërnavë vizitoi KBI-në e Gjakovës

Më 17 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Gjakovës, në të cilin u prit nga kryetari i këtij Këshilli, dr. Valon ef. Myrta.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin dhe nëpunësit fetarë për kontributin dhe përkushtimin e tyre

dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në Gjakovë. Ai premtoi përkrahjen e vazhdueshme të Kryesisë dhënë për këshillat e BI-së në tërë Kosovën.

Kryetari Myrta e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Këshillin e Gjakovës. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për arritjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky

Këshill, si dhe për tema të tjera me rëndësi për Këshillin e Gjakovës.

Më pas Myftiu Tërnavë, mbikëqyri punimet në restaurimin e xhamisë "Mahmut Pasha" në Gjakovë, të cilat po realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë, si dhe punimet në objektin kolektiv afarist-banesor në Çarshinë e Vogël të Gjakovës.



Myfitu Tërnavë takoi imamët e rajonit të Zhupës

Më 18 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka takuar administratën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren dhe imamët e rajonit të Zhupës, komuna e Prizrenit. Takimi i Myftiut Tërnavë me imamët e këtij rajoni kishte për qëllim organizimin dhe mbarëvajtjen e jetës fetare të besimtarëve në atë pjesë. Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, përmendi rolin dhe rëndësinë e misionit të imamit dhe përgjegjësisë së madhe që bart mbi supë. Gjatë takimit, imamët e kësaj zone informuan për mbarëvajtjen e jetës fetare dhe falënderuan Myftiun për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme për ta dhe rajonin e Zhupës.



Myftiu Tërnavë mori pjesë në hapjen e dyqanit humanitar për familjet nevojtare në Prizren

Më 18 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në hapjen e dyqanit humanitar për familjet nevojtare në komunën e Prizrenit, nga Shoqata Humanitare “Bereqeti”. Me këtë rast Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që t’i falënderojë të gjithë donatorët dhe bamirësit për besimin e thellë në shoqatën “Bereqeti”, ku nëpërmjet saj pasuria e tyre po arrin në dorën e skamnorëve dhe të nevojtarëve. Ai duke folur për aktivitetet e “Bereqetit” tha se ne edhe më do të shtojmë aktivitetet bamirëse. “Bereqeti nuk merret vetëm me ndihma dhe veshmbathje, por po merret aktivisht me ndërtimin e shtëpive, blerjen e banesave të ndryshme për nevojtarët. Deri më tash pas luftës së fundit të Kosovës ka arritur që të ndërtoj mbi 365 shtëpi për skamnorët dhe nevojtarët në Kosovë, ndërsa në këtë kohë vetëm në Prizren janë duke u ndërtuar katër shtëpi dhe kjo argumenton shumë se



kemi një aktivitet të bujshëm”, tha Myftiu Tërnavë, i cili më pas shtoi se vetëm vitin e kaluar kemi ndihmuar mbi 50 mijë familje, ndërsa deri më tash në këtë vit kemi ndihmuar mbi 60 mijë familje. Ndërkaq koordinatori i “Bereqetit”, Kurtish ef. Hoxha, veçoi se përparësi në këtë market do të kenë familjet me jetimë, pleqtë që janë të vetmuar dhe rastet që janë më se të nevojshme dhe ne do të bëjmë furnizimin me ushqim të

atyre që kanë nevojë për veshmbathje dhe gjëra ushqimore e sanitare. Ky dyqan përmban produktet elementare për secilën familje, duke filluar që nga produktet ushqimore e deri tek ato elementare për arsimim. Së fundmi “Bereqeti” ka filluar aksionin një mujor për shpërndarjen e druve për ngrohje dhe stufave në prag të stinës së dimrit. (R.S.)

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryetari i Shoqatës së burgosurve politikë, z. Selatin Novosella

Më 19 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u prit në takim nga Selatin Novosella, kryetar i Shoqatës të burgosurve politikë. Me këtë rast z. Novosella i shprehu mirëseardhje Myftiut Tërnavë dhe çmoi lart kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të BIK-ut përgjatë proceseve historike të vendit.

Ai po ashtu vlerësoi bashkëpunimin mes dy institucioneve dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje në të mirë të qytetarëve tanë.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Novosella për pritjen duke vlerësuar bashkëpunimin e mirë që kanë me të. Ai më pas e njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim, si dhe kontributin e vazhdueshëm të BIK-ut për kultivimin e harmonisë dhe

tolerancës ndërfaqetare në vendin tonë. Ai më pas theksoi se BIK dhe institucionet e saja kanë dhënë një kontribut të veçantë përgjatë proceseve historike që ka kaluar Kosova. “Nxënësit e Medresesë i gjejmë të rreshtuar drejt dhe mirë përgjatë viteve, sikurse janë demonstratat e viteve 68-69, pra ishin pjesë përbërëse e proceseve për

çlirim nga okupatori serb. Kjo neve na gëzon dhe na bën më të fuqishëm. Medreseja dha po ashtu një kontribut tepër të madh përgjatë viteve 1989-99, dëshmitarë për këtë janë shumë aktivistë të çështjes kombëtare, të arsimit shqip, ata të aktiviteteve politike, kulturore” - tha Myftiu Tërnavë. (R.S.)



Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin e BI-së së Ferizajt

Më 25 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë ka qëndruar në Ferizaj, ku ka zhvilluar një sërë vizitash e takimesh. Fillimisht ai u prit nga kryetari i KBI-së së Ferizajt, Fehmi ef. Mehmeti me stafin e tij. Më pas vazhdoi vizitën në fshatin Talinoc, ku po ndërtohet një objekt vakëf, investim nga xhematlinjtë e xhamisë së Talinocit. Më pas ai u prit në vizitë zyrtare nga kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu. Myftiu Tërnavë, u njoh me mbarëvajtjen e jetës fetare në këtë komunë si dhe mori mbështetjen e plotë nga kryetari i kësaj komune, që jeta fetare të zhvillohet normalisht. Myftiu e falënderoi kryetarin Aliu për bashkëpunimin shumë të mirë që ka me BIK-un për realizimin e shumë projekteve të përbashkëta më rëndësi

të madhe për jetën e qytetarëve, si dhe biseduan për mundësinë e thellimit të koordinimit dhe bashkëpunimit të mëtutjeshëm. “Patëm një takim shumë vëllazëror me kryetarin e Ferizajt, z. Aliun, dhe shpreha falënderim për bashkëpunimin shumë të mirë që ka pasur me KBI-

në e Ferizajt dhe që ka në vazhdimësi, ia urova edhe një herë mandatin tjetër që ka fituar në zgjedhjet e fundit në Kosovë.” - tha Myftiu Tërnavë. Nga ana e tij, edhe kryetari Agim Aliu e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, duke potencuar se dera e



bashkëpunimit do të jetë e hapur për BIK-un gjithmonë që në këtë mënyrë të realizohen kërkesat e qytetarëve. Ai po ashtu falënderoi KBI dhe imamët e Ferizajt që po qëndrojnë afër nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.

Më pas, Myftiu Tërnavë vazhdoi inspektimin në terren për të parë nga afër gjendjen aktuale të punimeve në ndërtimin e xhamisë dhe objekteve përcjellëse në Gaçkë, Nikadin dhe Pleshinë të Ferizajt, që dalëngadalë po i afrohen finalizimit. Myftiu

Tërnavë u nda i kënaqur me zhvillimin e punimeve, të cilat po shkojnë sipas planit dhe dinamikave të parapara me projekt dhe falënderoi të gjithë ata që po ndihmojnë në ngritjen e këtyre objekteve që do ta lehtësojnë edhe më jetën e xhematit. Në fund Myftiu Tërnavë vizitoi edhe KBI e Ferizajt ku u njoh nga kryetari Mehmeti për ecurinë dhe mbarëvajtjen e punëve dhe aktiviteteve të KBI, si dhe për jetën fetare e arsimore në Ferizaj. Më pas Myftiu iu drejtua stafit administrativ dhe anëtarëve të

KBI të Ferizajt, të cilët i këshilloi që të jenë edhe më shumë në nivel të përgjegjësive që kanë marrë dhe që këtë amanet të Zotit ta kryejmë me nder e përgjegjësi. “Kërkoj nga ju të jeni unik, kompakt dhe të respektoheni e të duheni mes vete, sepse këto janë mësimet e Islamit që na porosit Kurani dhe fjala e Pejgamberit a.s. dhe të punojnë më shumë në xhemat që ta ngremë vetëdijen dhe moralin në mesin e tyre” - tha Myftiu Tërnavë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë mori pjesë në pritjen e organizuar me rastin e 109-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

Më 28 nëntor, me ftesë të ambasadorit të Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozit, Myftiu i Kosovë, Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në pritjen e organizuar me rastin e 109-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë manifestim morën pjesë personalitetet më të larta të vendit, përfaqësues të partive politike, Trupi Diplomatik i akredituar në Kosovë, personalitete të shquara të botës së artit dhe më gjerë. Ambasadori Minxhozi, falënderoi Myftiun Tërnavë për ardhjen, si dhe u shpreh se kjo ditë e shënuar për kombin shqiptar, festohet bukur kudo ku ka shqiptarë.



Myftiu Tërnavë priti në takim xhematlinjë të dhe imamin nga Mleqani

Më 30 nëntor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim Alush Mehmetin, Egzon Pajazitajn, Gazmend Mehmetin dhe Shpëtim Kryeziun, imam i xhamisë së Mleqanit. Alush Mehmeti, Miftar Pajazitaj dhe Sokol Mehmeti dhuruan 15 ari truall vakëf për BIK-un. Myftiu Tërnavë i falënderoi dhuruesit e këtij trualli, duke shprehur kështu mirënjohjen dhe konsideratën e tij dhe të institucionit të BIK-ut për përkushtimin e tyre që të lënë vakëf një pjesë të tokës së tyre për Bashkësinë Islame të Kosovës. “Tradita e mirë e lënies së tokës



vakëf për nevojat e Bashkësisë Islame është duke u shtuar ditë-ditë, për çka ne si institucion u

jemi tejet falënderues këtyre qytetarëve” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Promovohet monografia “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)”

Më 2 dhjetor, nën organizimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, u promovua monografia “Dijetarë Shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”, i autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra.

Fjalë përshëndetëse mbajti kryetari i Kryesisë së BIK-ut, Naim ef. Tërnavë, si dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku. Ndërsa me referate vlerësuese mbi librin u paraqiten drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, prof. dr. Hysen Matoshi, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora, si dhe historiani i shquar prof. dr. Memli Krasniqi. Po ashtu në këtë promovim morën pjesë edhe atasheu në ambasadën e Turqisë në Kosovë, drejtori i arkivave të Kosovës, profesorë, studiues, dashamirë të librit e të kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Ky libër vlerësohet se paraqet një kontribut me vlera shkencore për historinë e institucioneve, arsimin, kulturën e trashëgiminë islame në veçanti dhe për historinë tonë në përgjithësi. Kjo është vepra e parë me karakter enciklopedik e botuar nga BIK, por është e para edhe në Kosovë dhe në trojet shqiptare, në të cilën përfaqësohen dhe ndriçohen biografitë e 195 personalitetëve shqiptarë.

Mysafirëve iu dëshiroi mirëseardhje drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, prof. Ramadan Shkodra, njëherësh kryeredaktori i shtëpisë botuese “Dituria Islame”, i cili foli për veprimtarinë e kësaj shtëpie botuese, duke potencuar mes të tjerash se deri më tani janë botuar mbi 200 tituj nga fusha të ndryshme fetare, si nga jurisprudenca, historia dhe qytetërimi islam, tefsiri, hadithi dhe fusha të tjera. Krahas këtyre librave kemi botuar edhe një sërë monografish dhe botimesh të veçanta me vlerë për historografinë, kulturën, gjuhësinë dhe letërsinë shqipe. Drejtori Shkodra falënderoi Myftiun Tërnavë për mbështetjen e vazhdueshme që po



jep për botimin e librave fetarë e shkencorë, duke u zotuar se edhe në të ardhmen do të botojnë vepra të këtilla në interes të fesë dhe shkencës. Ai vlerësoi se ky libër përfaqëson dijetarët shqiptarë nga katër vilajetet shqiptare: Kosovë, Shkodër, Manastir, Janinë, që kanë vepruar në periudhën midis viteve 1880-1912. Vitin 1880, autorët e kanë si përkufizim të parë, sepse pikërisht në këtë vit kanë filluar të kompletohen dosjet personale të nëpunësve të institucionit më të lartë fetar-arsimor të perandorisë, përkatësisht të Meshihatit të Lartë Osman, proces ky i cili ka vazhduar deri në përfundimin e Perandorisë Osmane më 1924. Viti 1912, ndërkaq, është marrë si përcaktues përmbyllës i këtij harku kohor, sepse pikërisht në këtë

vit Perandoria Osmane largohet nga trojet shqiptare.

Duke folur për rëndësinë e monografisë “Dijetarë Shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)”, në emër të BIK-ut, institucioneve të saj dhe në emrin e tij kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shprehu mirënjohjen e tij që jeni sot bashkë me ne për të promovuar monografinë “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) – sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman” të autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra, e cila ka parë dritën e botimit dhe tani është në duart e lexuesve, është pjesë e bibliotekave dhe auditorëve tona.

Myftiu Tërnavë tha se ky libër për lexuesin tonë ka një rëndësi të veçantë për historiografinë tonë, ngase kjo është vepra e parë me karakter enciklopedik e botuar nga BIK-u, por ajo është edhe e para edhe në Kosovë dhe në trojet shqiptare, në të cilën përfshihen dhe ndriçohen - mbi bazën e dokumenteve osmane të kohës të pa trajtuara më parë - biografite e dyqind personaliteteve shqiptare të shquar të dijes që i kanë takuar elitës intelektuale të kohës dhe që kanë vepruar në dekadat e fundit të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, shumica sosh, fare pak ose aspak të njohur më parë... Myftiu Tërnavë theksoi se është obligim e amanet yni që të njohim të kaluarën, t'i njohim institucionet dhe pararendësit tanë, t'i vlerësojmë drejt dhe t'u japim vendin e merituar në historinë e popullit tonë. Sikundër që e kemi amanet që t'i korrigjojmë edhe gabimet që për arsye të ndryshme që janë bërë për gjatë kohëve në raport me të kaluarën tonë të begatë islame shqiptare...

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, nga ana e tij uroi për punën që është bërë për të publikuar një vepër kaq të rëndësishme për kulturën, trashëgiminë, arsimin dhe historinë tonë shqiptare. "Është tejet e rëndësishme të kemi prurje të tilla të reja për elitat intelektuale shqiptare nëpër histori, sepse kjo e zgjeron bazamentin e dijes dhe horizontet për ata që ngjizen në procesin e

ndërtimit dhe të ruajtjes së identitetit shqiptar. Në këtë aspekt kemi shumë mangësi në zbardhjen e të vërtetave historike të intelektualëve, shoqatave shqiptare që kanë kontribuar në lëvizjen kombëtare shqiptare në mendimin shkencor të kohës dhe personaliteteve që dhanë gjithçka që kombi shqiptar të formohet nga një bazë e gjerë e me mjete kulturore", shtoi ndër të tjera ministri Çeku.

Dr. Hysen Matoshi çmoi lart këtë vepër, duke vënë në pah vlerën shkencore dhe fetare që ka, si dhe për vendin e merituar që zë kjo vepër në kuadër të veprave historike dhe është një përpjekje serioze për ta ndriçuar gjithanshëm këtë çështje. "Autorët e kësaj vepre, duke i hyrë një projekti ambicioz dhe duke shkelur në një hapësirë të panjohur sa duhet kanë dhënë një ndihmesë të çmueshme të saktësimin të rolit të dijetarëve shqiptarë në korpusin e madh të dijes së gjithmbarshëm të një perandorie që vepruan në një kontekst jo të lehtë të konkurrencës me kombe dhe kultura të tjera..." tha Matoshi.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora vlerësoi se puna e bërë nga autorët Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra është një nismë e mbarë në drejtim të dokumentimit të së kaluarës sonë, veçmas të asaj të periudhës osmane. "Kjo është shpërfaqje e vetëdijes shkencore të autorëve që të përfaqësohen kapacitete intelektuale shqiptare nga të gjitha viset e

asokohshme etnike. Është fakt se këta dijetarë, me origjinën dhe me përcaktimin e tyre etnik-kombëtar, ishin shqiptarë dhe pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore e diturore shqiptare..." - tha Bajgora.

Ndërkaq historiani i shquar prof. dr. Memli Krasniqi, duke iu referuar librit në fjalë tha se ky libër i autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra, dëshmon me të dhëna burimore e arkivore se kontributi i personaliteteve të trajtuara nuk ishte vetëm në shërbim të jetës shpirtërore të banorëve myslimanë të zonave shqiptare, por edhe në krijimin e një elite të re kulturore e politike shqiptare.

Në fund të promovimit, Hatixhe Ahmedi, në emër të autorëve të veprës, falënderoi BIK-un për mundësinë e promovimit së librit, si dhe të gjithë ata që kishin kontribuar në formë të ndryshme, që kjo vepër të botohet sa më e kompletuar. "Ndërsa në fund fare, por jo nga peshë dhe rëndësia, një mirënjohje dhe falënderim të veçantë për gjithë ju që keni ndarë pjesë nga koha e juaj e çmuar që të jeni me ne sot në këtë promovim dhe të na nderoni neve si autorë, botuesin, Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, por mbi të gjitha t'i nderoni dhe t'i respektoni këto personalitete tona që janë përfshirë në këtë monografi" - tha ajo. (R.S.)



Myftiu Tërnavë priti një delegacion nga fondacioni “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”

Më 3 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga fondacioni “Revival of Islamic Heritage Society” e njohur si fondacionin “Ringjallja e Trashëgimisë Islame, të kryesuar nga Mahmud en-Nexhdi dhe Halid Ensari. Myftiu Tërnavë së pari u shprehu mirëseardhje mysafirëve, pastaj i njohu me aktivitetin dhe organizimin e jetës fetare që bën Kryesia e BIK-ut në vend. Myftiu Tërnavë po ashtu falënderoi qeverinë dhe popullin e Kuvajtit që kanë kontribuar shumë për përmirësimin e infrastrukturës së BIK-ut dhe theksoi se Kuvajti vazhdimisht ka ofruar ndihmë dhe mbështetje për shtetin e Kosovës gjatë luftës, por edhe pas përfundimit të saj dhe për

këtë popull të Kosovës asnjëherë nuk do ta harrojë këtë mirësi nga ta.

Nga ana e tij, z. Mahmud en-Nexhdi u shpreh se është shumë i gëzuar që po viziton Kosovën dhe theksoi se populli i Kosovës është një

popull shumë i dashur dhe Kuvajti ka kuptuar nevojat që ka populli i Kosovës dhe është munduar që sado pak të ofrojë ndihmë vëllazërore në të mirë të qytetarëve të Kosovës.



Myftiu Tërnavë mori pjesë në Forumin e Tetë për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Islame

Nën patronazhin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, shejh Abdullah bin Zayed al-Nahyan, më 5 dhjetor, në Dubai, ministri i Tolerancës dhe Bashkëjetesës, shejh Nahyan bin Mubarak al-Nahyan, inauguroi fillimin e punimeve për Forumin e Tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes me temë “Qytetaria gjithëpërfshirëse nga ekzistenca e përbashkët në ndërgjegjen e përbashkët”, i cili do të vazhdojë të mbahet deri më 7 dhjetor.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë ministri i Shtetit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, njëherësh drejtori i përgjithshëm i zyrës “Expo 2020”, Reem bint Ibrahim al-Hashemi, sekretari i përgjithshëm i Lidhjes Botërore Islame “RABITA”, dr. Muhamed bin Abdul Kerim al-Isa, ministri federal për Çështjet Fetare dhe Harmoninë Ndërfetare në Republikën e Pakistanit, shejh Noor al-Haq Qadri, kryetari i Këshillit të Emirateve për Fetva të Sheriatit, shejh Abdullah bin Bayah, shefi i Departamentit të Zhvillimit të

Komunitetit në Abu Dabi, dr. Mughër Khamis al-Khalili, ministra, përfaqësues të qeverisë, liderë fetarë të besimeve dhe sekteve të ndryshme, personalitete të nivelit të lartë, mendimtarë, akademikë, studiues nga e mbarë bota.

Në fjalën e tij të hapjes, shkëlqesia e tij, Nahyan bin Mubarak al-Nahyan, shprehu lumturinë e tij për pjesëmarrje në këtë forum, i cili po mbahet nën patronazhin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, të

cilin ai e cilësoi si të parë për zhvillimin e marrëdhënieve të tolerancës, bashkëjetesës dhe miqësisë me të gjitha vendet e botës dhe i cili është vazhdimisht i angazhuar për të mbështetur kauzat e së mirës, paqes dhe të vërtetës kudo në botë.

“Falë presidentit të shtetit, shejh Khalifa bin Zayed al-Nahyan, zëvendësit të tij, shejh Muhamed bin Rashid al-Maktoum, dhe vëllait të tij shejh Muhamed bin Zayed al-Nahyan, Emiratet e Bashkuara Arabe, në dritën e pranisë së anëtarëve



nga e gjithë bota në “Expo 2020”, vendi është bërë një shtet qytetarie gjithëpërfshirëse, shtet i tolerancës dhe vëllazërisë njerëzore, një shtet i cili përfaqëson paqen si një mjet dhe një qëllim, që merr për bazë tolerancën, bashkëpunimin dhe harmoninë ndërmjet vete, si një qasje dhe një metodë për bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha kombet dhe popujt. Ky shtet vazhdimisht punon për të fuqizuar të gjithë individët dhe të gjitha shoqëritë njerëzore për të kontribuar plotësisht për përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm në botë, duke pasur parasysh se e gjithë kjo është thelbësore. Këto parime janë pjesë e trashëgimisë së pavdekshme që nga ka lënë themeluesi i shtetit, i ndjeri shejh Zayed bin Sulltan al-Nahyan, i cili gjithmonë na porosiste që të punojmë, ngase qetësia ndërmjet qenieve njerëzore, dialogu dhe

komunikimi pozitiv ndërmjet tyre është një mënyrë e sigurt për ta arritur mirësinë dhe prosperitetin në botë.”

Më pas, fjalën e mori kryetari i Këshillit të Fervave në EBA, njëherësh edhe kryetari i Forumit për Promovimin e Paqes, Abdullah bin Beja, i cili para të pranishmëve paraqiti kornizën e këtij takimi global. Ai theksoi nevojën e hulumtimeve, analizave dhe paraqitjeve të botëkuptimeve të drejta rreth ndërtimit të një shoqërie qytetare dhe civilizuese, e cila kërkon përgjegjësi dhe siguron drejtësi, duke respektuar dallimet dhe ngjyrat e çdo shoqërie. “Shembulli i organizimit të “EXPO 2020”, në të cilin po marrin pjesë mbi 190 shtete, të cilat ekspozojnë të mirën që kanë, sjell edhe obligimin parësor të të gjithë liderëve fetarë të familjeve

Abrahamike, që të njihen, të afrohen dhe të respektohen ndërmjet vete, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e shoqërive qytetare.”

Para të pranishmëve foli edhe sekretari gjeneral i RABITAS, dr. Abdulkerim al-Isa, i cili konfirmoi përkrahjen e RABITAS për këtë forum si dhe për vendimet që dalin nga ky forum. Po ashtu, në hapje foli edhe ministri i Tolerancës e Çështjeve Fetare të Pakistanit, Nuredin al-Kadiri.

Në margjinat e forumit, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, zhvilloi disa takime me personalitete të ndryshme nga shtete të ndryshme të botës islame. Këto takime u shfrytëzuan me theks të veçantë për të shtruar kërkesën për njohje të shtetit të Kosovës nga shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë tonë. (B.M.)

Myftiu Tërnavë mori pjesë në takimin e myftinjve në EBA

Më 7 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka përfaqësuar kontinentin evropian në takimin e myftinjve, i cili është organizuar me ftesë të kryetarit të Këshillit të Fervave të EBA-së, njëherësh kryetar i Forumit për Promovimin e Paqes në Botë, shejh Abdullah bin Beja.

Në këtë takim morën pjesë myftinj nga shumë vende të botës, siç janë myftiu i Jordanisë, dr. Abdul Kerim Hadavine, këshilltari i presidentit egjiptian për Çështje Fetare, dr. Usame al-Azhari, myftiu i madh i Indisë, Ebu Bekër Ahmad,

myftiu i Zinhibarit, Salih Omer Kaabi, sekretari i Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut, dr. Kutub Mustafa Sano, si dhe myftinjtë e Bangladeshit, Guinesë, Bregut të Fildishit dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Fetvasë të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Kryetari Abdullah bin Beja, fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje pjesëmarrësve në këtë takim, si dhe para tyre paraqiti një pasqyrë të veprimtarisë së Këshillit të Fervave të EBA-së, si institucioni më i lartë dhe përgjegjës për çështjet e fetvave në këtë vend. Ai gjithashtu i njohu

të pranishmit edhe për metodologjinë dhe veprimtarinë e nxjerrjes së fetvave në këtë shtet. Kryetari Beja theksoi sfidat e institucionit të fetvave dhe nevojën për një koordinim ndërmjet institucioneve të fetvave në nivelin global. Ai vuri në pah rëndësinë e saktësisimit dhe respektimit të rrethit shoqëror dhe kohor për fetva.

Në këtë takim u diskutua edhe rreth rëndësisë së luftimit të çdo lloj ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi, që fatkeqësisht dhe padrejtësisht sot i mveshet Islamit. (B.M.)



Myftiu Tërnavë mori pjesë në akademinë përkujtimore për katër imamët dëshmorë nga Shtimja

Më 14 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë mori pjesë në akademinë përkujtimore për dëshmorët e rënë në Pashtrik, imam Fadil Rashiti nga Petrova, Arben Hyseni nga Godanci, Selim Selimi nga Belinci dhe në Koshare Abedin Murtezi nga Mollopolci i Shtimes.

Në këtë eveniment që u mbajt në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, morën pjesë edhe përfaqësues të KBI së Shtimes, përfaqësues nga Fakulteti i Studimeve Islame, medreseja e mesme "Alauddin", institucione të komunës së Shtimes, FSK-ja, PK-ja, partive politike, bashkëluftëtarë të dëshmorëve, familjarë të dëshmorëve, hoxhallarë etj.

Me këtë rast fjalën hapëse e bëri, kryetari i BI-së së Shtimes, Skender ef. Baftiu, i cili mes tjerash theksoi se ndjehen krenar me veprën dhe sakrificën që treguan këta imamë që ranë për të mos vdekur kurrë. "Si KBI në Shtime jemi përkushtuar që kjo akademi dhe përgatitja e dokumentarit për dëshmorët tanë imamë të jetë një hap i parë i ndriçimit të sakrificës për liri në mënyrë që shumë shpejt të kemi edhe dokumentar apo monografi të tjera"- tha Baftiu.

Ndërsa kryetari i komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, shprehu mirënjohje për Këshillin e BI-së së Shtimes për organizimin e kësaj akademie dhe dokumentarit të përgatitur. "Vitet e krenarisë dhe lavdisë do të mbeten gjatë në kujtesën tonë kombëtare. Ka vetëm një rrugë nëpër të cilën ecën historia e lirisë, e ajo është rruga e gjakut të dëshmorëve të kombit të cilët në kthesën e madhe historike ishin të gatshëm që të falin gjakun për ardhjen e lirisë sonë dhe kujtimi ndaj tyre do të mbetet i freskët prore në mendjet tona"- tha kryetari Aliu.

Ndërsa Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, evokoi kujtime për nxënësit e studentët e tij që tashmë janë dëshmorë. Ai më pas në emër të institucionit të BIK-ut përshëndeti familjarët e dëshmorëve duke lutur



Zotin që atyre t'u falë të gjitha të mirat në dy botët, kurse shëhidëve e të vdekurve t'i gradojë e shpërblejë me xhenet. Zoti në Kuran thotë se ata të cilët kanë rënë dëshmorë për çlirimin e vendit për atdhe dhe fe, për ta kurrë mos thoni se ata janë të vdekur, por ata janë të gjallë dhe gjallëria e tyre është prezentë në vazhdimësi të ne. Ai nuk la pa përmendur edhe sakrificën e nënës shqiptare, të cilat janë gjetur dhe kanë punuar shumë dhe janë motivuese për çlirimin e vendit tonë, andaj Zoti i shpërbleftë me të mirat e Tij. Ato janë krenaria e kombit tonë dhe kontributin më të madh për çlirimin e vendit e kanë dhënë nënat tona.

"Cilësi dhe veçori të Fadilit ishin urtësia, devotshmëria dhe vendosmëria. Ndaj urtësia e tij fliste vetë dhe në fytyrën e tij të urtë kemi vërejtur pakënaqësinë e tij të vazhdueshme që kishte për gjendjen e vështirë që mbretëronte asokohe në Kosovë nga okupimi klasik që i kishte bërë Serbia vendit tonë. Vlen të theksohet se paraqitjen e fundit të provimit në FSI, Fadili e kishte bërë për në akaid në lëndën time, mirëpo ai i hyri një provimi edhe më të madh, provimit që na ka ftuar Zoti xh.sh., që kur e kërkon vatani t'i përgjigjemi. Ai iu përgjigj dhe derdhi gjakun e tij të njomë për të mos vdekur kurrë"- tha Tërnavë, i cili më pas evokoi kujtime edhe nga takimi i fundit që kishte pasur me Arbenin, tashmë dëshmor që ishin takuar në hyrje të Medresesë

dhe e kishte njoftuar se do t'u bashkohej radhëve të UÇK-së, dhe si profesor që ishte e afroji dhe përqafoi dhe si drejtor ia dha disa këshilla. Ai më pas nënvizoi rolin dhe peshën historike që pati Medreseja në të gjitha proceset historike të vendit tonë, e në veçanti në luftën e fundit, ku dha 37 dëshmorë nga ish-nxënësit e kësaj shkolle për të mirën e këtij vendi. Ai përmes këtij tubimi porositi që brezin e ri ta edukojmë më shumë në frymën e mirë kombëtare atdhetare e fetare, ta mësojmë atë për atë që na ka mësuar Zoti dhe Muhamedi a.s..

Në emër të Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, të pranishmit i përshëndeti edhe z. Muhamet Bilalli, i cili tha se falë veprës së tyre ne sot gëzojmë lirinë. "Luftëtarët e lirisë që po i përkujtojmë sot janë bërë pjesë e jetës sonë dhe janë pjesë e lirisë sonë"- tha Bilalli. KBI e Shtimes me këtë rast në fund të kësaj akademie kishte përgatitur dokumentarin "Lulet e shtegut të lirisë" kushtuar këtyre dëshmorëve, ndërsa më pas u ndanë diploma Post-mortum nga FSI për hoxhën Fadil Rashiti dhe nga Medreseja për Arben Hysenin, Selim Selimin dhe Abedin Murtezi. Në Pashtrik ra dëshmorë Fadil Rashiti më 14.12.1998, Arben Hyseni më 14.12.1998 dhe Selim Selimi më 14.12.1998, kurse Abedin Murtezi ra dëshmorë në Koshare më 5 maj 1999. (R.S.)

Shënohet 70-vjetori i medresesë së mesme “Alauddin” në Prishtinë



Më 22 dhjetor, nën intonimin e himnit kombëtar dhe atij shtetëror, në mënyrë solemne është shënuar 70 vjetori i themelimit të Medresesë së Mesme Alauddin në Prishtinë. Në këtë manifestim që u organizua nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Medreseja Alauddin në Prishtinë, morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, ish-president i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, përfaqësuesi i Presidentes së Kosovës, z. Bekim Kupina, ambasadori i Republikës së Turqisë, Çağrı Sakar, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane z. Dominik, kryetar i Prishtinës, z. Përparim Rama, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, drejtori i Institutit Albanologjik, z. Hysen Matoshi, drejtori i Institutit të Historisë, z. Sabit Sylë, drejtori i Arkivave të Kosovës, z. Bedri Zyberaj, drejtor i Shoqatës së ish-burgosurve politik, z. Selatin Novosella, drejtori i medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim Idrizi, përfaqësues të institucioneve qëndrore dhe lokale të vendit, drejtues të institucioneve të Bashkësisë Islame, ish-drejtorë të Medresesë, profesorë, pedagogë dhe personeli i Medresesë.

Mysafirëve iu dëshiroi mirëseardhje drejtor i Medresesë, z. Fadil Hasani, i cili i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e këtij manifestimi dhe çmoi kontributin e shkollës të dëshmuar përgjatë viteve, qoftë në rrafshin fetar

edhe atë kombëtar. Ai më pas theksoi se Medreseja ishte gjithmonë në shërbim të fesë dhe të atdheut, duke kultivuar hoxhallarë, ushtarë, policë dhe shumë profesione të ndryshme.

Këtë manifestim e përshëndeti edhe Myftiu Tërnavë, i cili Medresesë i uroi nga zemra jetë të gjatë, suksese dhe veprimtari të begatë, si dhe përmbushje të plotë të misionit të saj hyjnor, historik e kombëtar. Ai më pas tha se Medreseja Alauddin ishte e para në të gjitha trojet shqiptare, e cila funksiononte vetëm në gjuhën shqipe. Tërnavë tha se fati i Medresesë është i lidhur ngushtë edhe me fatin e popullit shqiptar, sidomos në luftën e fundit në Kosovë. “Nuk është e tepërt të potencohet fakti se fati i Medresesë Alauddin vazhdimisht ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës. Ajo gjithmonë mori frymë me popullin e kjo mori vlerë sidomos në periudhën 1998/99 të shekullit të shkuar me veprimtarinë e saj të suksesshme atdhetare. Bashkësia Islame e Kosovës duke qenë e vetëdijshme për problemet, synimet, rrezikun që i kanosej vendit në të shumtën e rasteve ishte më shumë vizionare se shumë ata të cilët kishin për objektiv vizionin”, tha Tërnavë. Bashkësia Islame tërë infrastrukturën e saj në tërë vendin e ofroi në shërbim të çështjes kombëtare, e në veçanti do të jetë Medreseja “Alauddin” ajo e cila qysh me rastin e largimit të studentëve nga konviktet e tyre më 1989 do t'i strehoj një numër të konsiderueshëm të tyre dhe do të përkujdeset për ta.

Qe këtu e tutje, Medreseja do të jetë pothuajse adresa e të gjitha aktiviteteve politike, shkencore, sindikaliste, artistike, kulturore e sportive në nivel të Republikës së Kosovës. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, në këtë manifestim çojmë, nderojmë, njohim e vlerësojmë me një mirënjohje të veçantë të gjithë drejtuesit, pedagogët, nxënësit dhe të gjithë ata që me angazhimin, punën, përkushtimin, sakrificën, dijen dhe kontributin e tyre punuan për ngritjen dhe zhvillimin e Medresesë, duke e bërë atë një qendër të rëndësishme së veçantë të edukimit dhe arsimit, e cila medrese jetoj e bashkëlidhur dhe e pandarë me fatin e popullit dhe të vendit tonë.

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, tha se besimi shërben si direktivë për çdo hap të jetës.

Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë si shembull për harmoni ndërfaqetare, shembull për demokraci dhe shembull që besimi dhe tradita fetare, çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne. Kryeministri Kurti cili përmendi fjalët e profetit Muhamed rreth kërkimit të diturisë deri në fund të botës, ai tha se në besim, në praktikë dhe në lutje, ka përpjekje për edukim të njerëzimit. “Unë e di që sot, më shumë se një shekull pas, mes medresistëve këtu, ka nxënës po kaq të shkëlqyer dhe edhe më shumë të përkushtuar për dije. Leximi, në formë urdhërore si fjala që hap tekstin e Kuranit dhe këshilla e



Muhamedit për të kërkuar dijen deri në fund të botës, besoj se janë motiv nismëtar për medresistët këtu, bashkë me synimin për emancipim dhe kontributdhënie në shoqëri.” Ai tha se tradita e besimit dhe ajo shqiptare janë në harmoni të ngushtë dhe duhet të mirëmbahen si të tilla. “Si një popull me shumicë myslimane, shqiptarët ditën ta ruajnë Islamit mes tyre edhe gjatë këtyre dy dekadave të fundit, kur për shkak të luftës globale kundër terrorizmit, të ishe mysliman ishte e vështirë sikur ta mbaje një gacë në dorë, saktë siç kishte parashikuar profeti i islamit, Muhamed. Ne duhet ta mirëmbajmë vetën tonë dhe harmoninë ndërfaqetare, shembull për demokracinë dhe shembull që besimi dhe tradita fetare çfarëdo qofshin ato, mund të përjetojnë në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne”, tha Kurti.

Këshilltari i presidentes Osmani, z. Bekim Kupina, në emrin e presidentes Osmani përcolli medaljen presidenciale “Për liri dhe pavarësi” për Medresenë “Alauddin” për kontributin e dhënë ndër vite. “Muret e këtij objekti janë dëshmitarë të kohës së një pjesë të lavdishme të historisë sonë, ku në këtë vatrë diturie, mësimi dhe aktiviteti kombëtar ishin bërë një. Në këtë përvjetor Medreseja Alaudin meriton respekt për kontributin që ka dhënë në procesin e lirisë dhe pavarësisë së vendit. Historia dhe kontributi i Medresesë është njëjtë me historinë e shtetit tonë, ajo nuk mund të shihet ndaras. Rol i kësaj shkolle është për t’u admiruar në krijimin e klimës së tolerancës ndërfaqetare, e cila është e shquar në popullin tonë dhe ajo thjesht nuk është vetëm një shkolle por është një pikë ndalese e secilit prej nesh, monument trashëgimie e



Pranimi i medaljes presidenciale

një periudhe historike. Kjo Medrese është histori në vete” - tha Kupina.

Kryetari i AKR-së dhe ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një fjalë rasti, ka uruar suksese të mëtutjeshme shkollës së mesme. “Ju mësimdhënësit, akademikët e këtij tempulli na keni mësuar si të jetojmë, si të sillemi më njëri-tjetrin, si ta duam njëri-tjetrin”, tha ish-presidenti Pacolli.

Medreseja “Alauddin” i nderoi me mirënjohje ish-drejtorët dhe disa pedagogë me rastin e kontributeve të tyre përgjatë historisë së Medresesë në ngritjen dhe avancimin e saj. Me mirënjohje u nderua ish-drejtori, tani Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ish drejtorët dhe pedagogët, prof. Ekrem Simnica, Bahri ef. Simnica, Jaku ef. Çunaku dhe Sulejman Osmani, ish sekretar i Medresesë Alauddin në Prishtinë.

Po ashtu mirënjohje ndau edhe kryetari i të burgosurve politik z. Selatin Novella, i cili ka zhvilluar aktivitet kohë të gjatë në ambientet e Medresesë Alaudin në Prishtinë. Ai tha se gjithnjë e kam theksuar se kur të shkruhet historiku i Prishtinës do të jetë i mangët dhe jo i plotë pa përfshirjen e rolit dhe kontributit të Medresesë Alaudin dhe kur të shkruhet historia e UCK-së, posaçërisht ku shkruhet për logjistikën e UCK-së, nuk mund të merret me mend se mund të shkruhet par praninë, aktivitetin, sakrificën e Medresesë Alauddin. Kjo shkolle ishte magjja e UCK-së, andaj me

kënaqësi ndaj mirënjohjen më me gëzim në emër të Kryesisë së Shoqatës së të burgosurve politikë për kontributin që Medreseja ka dhënë në Këshillin Republikan për ndihmë emergjente.

Për këtë, ndiejmë mirënjohje të veçantë për krahun e djathtë që e kishte dërguar Zoti për neve si Këshill, e edhe për luftën, që e kishim drejtorin e atëhershëm të kësaj shkolle, Naim ef. Tërnavën, pa mbështetjen dhe pa kontributin financiar të të cilit nuk kemi mundur të funksionojmë. “Medreseja gjatë kohës së luftës ka qenë spital, ka pranuar studentët me ditë e net të tëra dhe i ka strehuar ata të cilat u janë djegur shtëpitë dhe UCK-ja e ka pasur një adresë nëse mbyllen të gjitha rrugët dhe shpeshherë janë mbyll, dera e Medresesë ka qenë 24 orë e hapur për neve” - tha Novosella.

Me ilahinë “Drita e Prishtinës” u paraqit lexuesi i Kuranit dhe ish-nxënësi i kësaj shkolle Egzon Ibrahim.

Po ashtu, në këtë manifestim, kori i medresesë Alauddin dhanë një program të pasur kulturo-artistik me ilahi e kaside, si dhe u shfaq versioni i shkurtuar i filmit dokumentar, i përgatitur para 20 vitesh, që trajton historikun dhe kontributin e Medresesë Alauddin ndër vite që nga themelimi.

Krejt në fund pjesëmarrësit patën rastin të shohin ekspozitën me rastin e shënimit të 70 vjetorit të Medresesë Alauddin në Prishtinë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim ministrin e Kulturës, z. Hajrulla Çeku

Më 23 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ministrin e Kulturës, z. Hajrulla Çeku. Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje z. Çeku dhe më pas e njohu atë me punët dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat që ballafaqohet ky institucion. Myftiu Tërnavë falënderoi ministrin Çeku për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm dhënë për ngritjen e institucioneve të Kosovës. Ai më pas tha se kanë një bashkëpunim shumë të mirë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke veçuar kontributin e BIK-ut që në Kosovë të ketë qetësi, tolerancë dhe respekt ndërfaqet. “Bashkëpunimi dhe toleranca ndërmjet bashkësive fetare paraqet një faktor të stabilitetit në vend. Ne



kemi jetuar pranë njërit – tjetrit, jetojmë me realitetin pa asnjë dallim e diskriminim mbi baza fetare”- tha Tërnavë. Nga ana e tij, ministri i Kulturës, z. Hajrulla Çeku, shprehu falënderime për pritjen dhe njëherësh përgëzoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për

kontributin e tyre që në Kosovë të mbretërojë paqja, respekti e toleranca ndërmjet besimeve dhe etnive të ndryshme. Të dyja palët u dakorduan që edhe më tej të vazhdojnë bashkëpunimin në të mirë të qytetarëve të Kosovës. (R.S.)

Myftiu Tërnavë vuri gurthemelin e xhamisë së re në Uglar të Gjilanit

Më 24 dhjetor, nën këndimin e tekbireve, është vënë gurthemeli i xhamisë së re në fshatin Uglar të Gjilanit. Kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Alban Hysenin, kanë vënë gurthemelin e xhamisë së re, nevojë kjo e kamotshme e këtij fshati. Myftiu Naim ef. Tërnavë, përmendi rëndësinë që ka ndërtimi i xhamive në Kosovë, por edhe përkushtimin e vazhdueshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës që të jetë afër qytetarëve të vendit. “Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të institucioneve të saja dëshiroj t’ju uroj të gjithëve për ndërtimin e kësaj shtëpie të Zotit”, ka thënë Myftiu Tërnavë në vënien e gurthemelit të kësaj xhamie.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, u shpreh i gëzuar me këtë projekt, duke shprehur përkushtimin e mëtutjeshëm për thellimin e bashkëpunimit mes kësaj komune dhe Bashkësisë Islame që t’u



shërbejnë qytetarëve. Në anën tjetër, kryetari i këshilli, Naim ef. Aliu, përmendi rolin tejet të veçantë që qytetarët e kësaj komune, kanë pasur si në ndërtimin e xhamive, ashtu edhe në ndërtimin e shkollave, spitaleve dhe objekteve të rëndësishme. “Në emër të institucionit ju uroj gurthemelin e kësaj xhamie, ju xhema të dashur kenë dëshmuar edhe në periudha të kaluara për

menaxhimin e jetës suaj, për iniciativat që kenë ndërmarrë për të mirën e shoqërisë dhe për të mirën e këtij fshati”, ka potencuar kryetari i KBI-së Aliu. Kjo xhami është duke u ndërtuar falë bamirësve të shumtë, të cilët kanë kontribuar në blerjen e tokës dhe grumbullimit të të hollave për ndërtimin e saj, ndërsa për finalizimin e saj kjo xhami ka nevojë ende për donacione. (A.C.)

Myftiu Tërnavë viziton Këshillin e BI-së së Obiliqit

Më 27 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë vizitoi selinë e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës në Obiliq. Me këtë rast ai u prit nga kryetari KBI-së, Behar ef. Mjekiqi me bashkëpunëtorë.

Kryetari Mjekiqi e njohu Myftiun Tërnavë për jetën fetaro-arsimore, si dhe me mbarëvajtjen e punëve në këtë Këshill. Po ashtu ai falënderoi Myftiun Tërnavë për mundin, angazhimin dhe kontributin e pamasë që po jep në drejtim të konsolidimit të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës me të gjithë këshillat e saj.



Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë përgëzoi punën dhe angazhimet që po bënë Këshilli i BI-së së Obiliqit në të mirë të jetës fetare si dhe potencoi që duhet të foku-

sohemi edhe më shumë të puna dhe veprimtaria e imamit, tek uniteti ndërmjet imamëve dhe punës ekipore brenda institucionit. (R.S.)

Mbahet sesioni shkencor "Kontributi dhe veprat e Mehmet Akif Ersoj - Pejanit"

Më 28 dhjetor, Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë organizoi seminar shkencor me titull "Kontributi dhe veprat e Mehmet Akif Ersoj - Pejanit", me rastin e 100-vjetorit të miratimit të himnit të Republikës së Turqisë, i cili u mbajt në sallën e konferencave të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Në këtë eveniment shkencor mori pjesë kryetari i BIK-ut Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, profesori nga Konja e Turqisë, prof. dr. Alaattin Akoz, drejtori i Institutit Albanologjik, z. Hysen Matoshi, drejtor i Shoqatës së ish-burgosurve politik, z. Selatin Novosella, studiues, profesorë, studentë e dashamirë të dijes.

Mysafirëve mirëseardhje iu dëshiroi dekani i FSI-së, prof.asoc.dr. Fahrush Rexhepi, i cili vlerësoi lart kontributin e kësaj figure kombëtare të dy popujve, shqiptar dhe atij turk. Ai tregoi një thjeshtësi gjatë jetës së tij, fjalës i jepte vlerë të madhe. Ai ishte poet edhe dijetar. Kënaqësia më e madhe e tij ishte të lexonte, jepte



mësim dhe të shkruante. Ishte armik ndaj fanatizmit dhe injorancës, ishte pasionant ndaj kulturës dhe civilizimit. Ai kishte një bindje dhe karakter të jashtëzakonshëm.

Me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtuar edhe kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përshëndeti këtë sesion shkencor në emër të institucionit të Kryesisë së BIK-ut, duke veçuar se Mehmet Akif Ersoji, me krijimtarinë e tij ka zënë vend meritor në antologjinë e intelektualëve e krijuesve të popullit turk, e në këtë rrafsh njihet dhe

çmohet, e madje edhe merret për krenari edhe te populli shqiptar. Pra, përderisa ai ka jetuar e krijuar në Turqi, gjë që e bën poet e intelektual turk, origjina e tij në të njëjtën kohë e bën edhe poet e intelektual tonë, apo thënë më mirë, Mehmet Akif është poet e intelektual i dy popujve dhe si i tillë është në vargun e zinxhirit të gjatë intelektual shqiptarë, të cilët kanë kontribute të çmuara në kulturën turke, e njëkohësisht paraqesin një urë lidhëse të fortë ndërmjet popullit turk dhe popullit shqiptar. "Në këtë përvjetor, Mehmet

Akifi, na rishfaqet edhe njëherë si vlerë e përbashkët kombëtare dhe shpirtërore e dy popujve, duke kujtuar e përcjell te gjeneratat e reja, sepse ai në mënyrën më të mirë përshkruan elementet themelore të unitetit dhe solidaritetit kombëtar, të dëshirës së popullit tonë për pavarësi, atdhe e flamur.”- tha veç tjerash Myftiu Tërnavë.

Në seancën e parë me kumtesa u paraqitën: PHD (c)Besir Neziri, prof. dr. Abdullah Hamiti, prof.dr.Alaattin Akoz, prof.dr.Hysen Matoshi, PHD (c)Melihate Zeqiri.

Ndërsa në sancën e dytë me kumtesa u paraqitën: dr. Nuridin



Ahmeti, prof. asoc. dr. Sulejman Zymer Ramadani si dhe dr. Selim Osmani, prof. ass. dr. Musa Vila, dr. Selimi, kurse fjalën përmbyllëse e Valmire Batatina-Krasniqi, mr. mbajti mr. Ekrem Simnica. (R.S.)

Myftiun Tërnavë priti në takim ambasadorin e Katarit z. Al-Marri

Më 29 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Katarit Ali bin Hamad al-Marri. Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi ambasadorin për këtë vizitë në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike, si dhe e cilësoi atë si tejet të rëndësishme për Kosovën dhe vetë Kryesinë e BIK-ut. Ai më pas e falënderoi mysafirin për punën dhe për kontributin e tij për rritjen e bashkëpunimit dhe për thellimin e miqësisë ndërmjet Katarit dhe Kosovës në të gjithë fushat në dobi të popullit të Kosovës. Myftiu Tërnavë e njohu ambasadorin Al-Marri me punën dhe angazhimin e Kryesisë së BIK-ut dhe institucioneve të saj, si institucioni i vetëm i cili udhëheq mbarëvajtjen e jetës fetaro-arsimore në Kosovë, e më pas u ndal në bashkëpunimin shumë të ngushtë që kanë me Ministrinë e Çështjeve Fetare të Katarit. Myftiu po ashtu e falënderoi ambasadorin për



përkrahjen e shtetit të Katarit gjatë të gjitha periudhave, para, gjatë dhe pas luftës dhënë për shtetin e Kosovës.

Nga ana e tij ambasadori i Katarit z. Ali bin Hamad al-Marri u shpreh i lumtur që po viziton Kosovën dhe përshëndeti punën e Myftiut Tërnavë dhe BIK-ut që po japin në të mirë të Kosovës, me theks të veçantë në kontributin që po jep që Kosova të jetë një vend stabil ku respektohet të

drejtat, liritë, harmonia, bashkëjetesa dhe toleranca fetare ndërmjet komuniteteve.

Myftiu Tërnavë dhe ambasadori i Katarit Al-Marri biseduan edhe për koordinimin sa më të mirë për realizimin e projekteve të ndryshme të BIK-ut në Kosovë, si dhe ranë dakord që në të ardhmen të shtohet edhe më tej bashkëpunimi në të mirë të të gjithëve. (R.S.)

Kryesia e BIK-ut ndau mirënjohje për ish-sekretarin e saj, haxhi Jashar ef. Jasharin

Më 29 dhjetor, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, organizoi një manifestim rasti ku u nderua me mirënjohje si dhe u vlerësua kontributi jetësor i veteranit dhe udhëheqësit të shquar ish-sekretarit të

Kryesisë së BIK-ut haxhi Jashar ef. Jashari. Ai për 42 vite ishte pjesë e BIK-ut dhe kontribuoi në udhëheqjen, ngritjen dhe zhvillimin dhe avancimin e administratës së organeve të Bashkësisë Islame të

Kosovës. Fillimisht mirësearchje mysafirëve iu dëshiroi Ramadan Shkodra, drejtori për Shtyp dhe Kulturë, i cili tha se sot jemi për të çmuar dhe vlerësuar kontributin e haxhi Jasharit që konsiston në 80



vjetorin e lindjes së tij, dhe se kjo ceremoni është organizuar me vendim të veçantë të Myftiut Tërnavë.

Me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili çmoi kontributin dhe punën 42 vjeçare të ish-sekretarit Jashari, duke filluar që nga detyra e tij si arkivist, e më pas edhe në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të Kryesisë së BIK-ut.

“Sikurse dihet, haxhi Jashari për më shumë se 4 dekada ishte pjesë aktive e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Haxhi Jashari gjatë tërë punës së tij në Bashkësinë Islame është angazhuar për të bërë më të mirën për të ngritur e profesionalizuar administratën e Bashkësisë Islame gjë që edhe e ka arritur. Haxhiu i përket nxënësve të Medresesë së Ultë, respektivisht gjeneratës së dytë që e kreu me sukses. Menjëherë pas medresesë më 1965, haxhiun e gjejmë në Bashkësinë



Islame të Kosovës, fillimisht në detyrën e arkivistit e më vonë në detyrën e sekretarit, detyra të cilat i kreu me pedanteri, përkushtim e profesionalizëm deri në 2007.

Një kontribut të çmuar haxhi Jashari ka dhënë edhe në përgatitjen e akteve normative të BI-së, duke nisur nga Kushtetuta, pastaj statutet e ndryshme dhe rregulloret qofshin në kuadër të Kryesisë, këshillave apo edhe të institucioneve siç janë medreseja e FSI e të ngjashme, po ashtu dha kontribut të veçantë në fillet e periodikut islam në gjuhën shqipe, konkretisht në numrat e parë të revistës “Edukata Islame” kur iu bashkua plejadës së prirë nga haxhi Sherif Ahmeti për t’i vënë themelet e periodikut islam te ne, si dhe në cilësinë e sekretarit të Kryesisë së BI-së ka përfaqësuar me dinjitet Bashkësinë Islame në forume e institucionet nga më të ndryshmet ku ka qenë e nevojshme”-tha veç tjerash Myftiu Tërnavë, duke i dëshiruar suksese dhe pleqëri të rehatshme.

Ndërkohë ish-sekretari i Kryesisë së BIK-ut, haxhi Jashar ef. Jashari falënderoi Kryesinë e BIK-ut dhe Myftiun Tërnavë për këtë organizim dhe mirënjohjen që iu nda dhe respektin e treguar. Ai tha se kam pasur përkrahjen e të gjithë kryetarëve të BIK-ut e edhe të Myftiut Tërnavë për t’i çuar përpara proceset në ditët më të vështira gjatë okupimit, por edhe në liri. Ai ka falënderuar të gjithë ata që ka bashkëpunuar me ta deri më tani.

Në fund të këtij takimi Myftiu Tërnavë në emër të Kryesisë së BIK-ut në shenjë mirënjohje për kontributin e tij dhënë në këtë institucion ndau një mirënjohje dhe një dhuratë simbolike për haxhi Jasharin. (R.S.)

Certifikohen tetë hafëzë të rinj të Kuranit nga BIK-u

Më 29 dhjetor, tetë hafëz të Kuranit janë certifikuar me diploma nga Bashkësia Islame e Kosovës pasi kanë kaluar me sukses provimin para komisionit vlerësues. Komisioni profesional i përbërë nga kryeimami

i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe anëtarët hafëz, Safet ef. Hoxha dhe hafëz, Etem ef. Alanka, dëshmuar se hafëzët e rinj ishin të shkëlqyer në testim.

Në këtë ceremoni të ndarjes së diplomave mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përgëzoi hafëzët e rinj duke thënë se Bashkësia Islame është pasuruar me këta hafëz.

Në fund u bë ndarja e certifikatave për hafëzët e rinj të cilët diplomuan edhe zyrtarisht.

Në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës për memorizimin e Kuranit funksionojnë instituti i hivzit në Gjakovë dhe Prizren dhe së shpejti priten të hapen edhe qendra të tjera për memorizimin e Kuranit në Pejë dhe Rahovec për të vazhduar me qendra të tjera në Gjilan Mitrovicë e Vushtrri. (R.S.)



Myftiu Tërnavë priti në takim imamin Bedri Sylë

Më 30 dhjetor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe nga drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, pritën në takim imamin e xhamisë "Ebu Hanife" në Troisdorf të Gjermanisë, Bedri ef. Sylën.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë, shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut për vazhdimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet BIK-ut dhe diasporës shqiptare. Ai falënderoi imamin Sylë për punën dhe angazhimin e tij në diasporë për mbarëvajtjen e jetës fetare në diasporë. Nga ana e tij, imami Sylë, falënderoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për mbështetjen e



vazhdueshme dhënë për diasporën dhe shqiptarët atje.

Gjatë kësaj vizite të imanit Sylë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, ai takoi edhe drejtorin e

Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, të cilin e uroi për detyrën e re, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Filloi rindërtimi i Xhamisë së Pajtimit në Bubavec dhe ndërtimi i Muzeut Kombëtar të Pajtimit të Gjaqeve

Më 1 nëntor, filloi rindërtimi i Xhamisë së Pajtimit në Bubavec dhe ndërtimi i Muzeut Kombëtar të Pajtimit të Gjaqeve. Xhamia e Pajtimit të Gjaqeve në Bubavec të Malishevës ka filluar të rindërtohet, e afër saj ka filluar edhe ndërtimi i Muzeut Kombëtar të Pajtimit të Gjaqeve, i pari i këtij lloji në gjithë Kosovën. Fundi i muajit tetor shënon fillimin e ri për këtë fshat, i cili i kontribuoi vendit që nga kohët më të vështira e që po vazhdon edhe sot. Së shpejti ky fshat do ta ketë muzeun që dëshmon historinë e pajtimit të gjaqeve, e së bashku me të edhe vetë kontributin e imanit Xhevat ef. Kryeziut. Rindërtimi i xhamisë dhe



ndërtimi i këtij muzeu ka filluar me iniciativën e imanit Xhevat ef.

Kryeziut dhe me mjetet e vullnetarëve e bamirësve të ndryshëm.

Departamenti i Gruas i BIK-ut mbajti punëtori



Më 2 nëntor, përfunduan OSBE-së me mision në Kosovë. punëtoritë e Departamentit të Gruas Departamenti i Gruas në BIK në bashkëpunim me organizatën e bashkëpunim me organizatën e

OSBE me mision në Kosovë kanë përfunduar punëtoritë me temat: "Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm", dhe "Kornizën e politikave dhe legjislacionit vendor, roli i institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve që trajtojnë rastet e dhunës në familje". Bashkëpunimi i DG-së me OSBE-në përmes aktiviteteve të ndryshme ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e jetës sociale në shoqëri. Pesëmbëdhjetë punëtori u realizuan në komunat: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren e Vushtrri.

Redaksia e revistës "Dituria islame" mbajti mbledhjen e radhës



Më 3 nëntor, redaksia e revistës fetare, shkencore e kulturore "Dituria islame" mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën u diskutua dhe u analizuan numrat 366,367,368/9 dhe 370. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin kryeredaktori i revistës, dr. Ajni Sinani, sekretari i redaksisë, dr.

Rexhep Suma, anëtarët e redaksisë, prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra, dr. Fahrush Rexhepi, PHD (c) Besir Neziri, mr. Muzaqete Kosumi, Dr.Orhan Bislimaj, mr. Driton Arifi, Bashkim Mehani si dhe Bajram Zeqiri. Hapjen e mbledhjes e bëri kryeredaktori dr. Ajni Sinani, me

lutjen te Zoti që anëtarit të redaksisë dr. Faruk Sinani t'ia lehtësoj gjendjen dhe t'i japë shërim sa më të shpejt dhe të na kthehet në mesin tonë. Kryeredaktori më pas prezantoi rendin e ditës duke vlerësuar punën dhe angazhimin e anëtarëve të redaksisë, punën e kritikës konstruktive të anëtarëve të redaksisë që kanë dhënë deri më tani dhe njëherësh shfaqti bindjen dhe vlerësimin e përgjithshëm të artikujve të publikuar, me theksin e veçantë çmoi prurjet cilësore në numrat e fundit të revistës. Më pas anëtarët e redaksisë paraqitën mendimet e tyre përkitazi mbi artikujt e publikuar në revistë në numrat e fundit. Ata edhe njëherë theksuan vlerën dhe peshën e lartë që përçojnë këto shkrime të lexuesit dhe mbarë opinionit i gjërë. (R.S.)

Drejtori Simnica priti në takim imamin Bahri ef. Boja

Më 3 nëntor, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim imamin e Xhamisë Shqiptare në Londër, Bahri ef. Bojën, njëherësh njërin prej themeluesve të kësaj Qendre.



Drejtori Siminca falënderoi z. Bojën dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që

ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.

Në anën tjetër, Bahri ef. Boja shprehu gatishmërinë e tij dhe të Institucionit që ai drejton për shtrirjen edhe më të gjerë të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të aktiviteteve me Bashkësinë Islame,

respektivisht me Drejtorinë për Diasporë në kuadër të BIK-ut. Ai vlerësoi punën e deritanishme të Bashkësisë Islame, dhe potencoi se për të mirën e të gjithëve, e në veçanti të mërgatës sonë, duhet koordinim i ndërsjellë me Bashkësinë Islame në të gjitha aspektet kontribuuese, kombëtare apo fetare qofshin ato.

Drejtori Siminca priti në takim kryetarin e Qendrës Kulturore “Shtëpia e Paqes”

Më 15 nëntor, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të

Kosovës, Ekrem ef. Siminca, priti në takim kryetarin e Qendrës Kulturore

“Shtëpia e Paqes” të Zvicrës, z. Afrim Berisha. Drejtori Siminca falënderoi z. Berishën dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të BIK-ut që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Në këtë takim gjithashtu u bisedua edhe rreth shtimit të koordinimit me këtë qendër, por edhe me qendrat e tjera në Zvicër.



Kryeimami Sahiti priti në takim ministrin e shtetit të Libisë për çështje ekonomike z. Salama Ibrahim al Guvaiyl



Më 20 nëntor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim ministrin e shtetit të Libisë për çështje ekonomike z. Salama Ibrahim al Guvaiyl, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në vendin tonë. Kryeimami Sahiti falënderoi ministrin Al Guvaiyl për vizitën e vendit tonë dhe të Bashkësisë Islame me ç'rast e njohu ministrin me mbarëvajtjen dhe organizimin e jetës fetare islame në Kosovë. Ministri libian Al Guvaiyl falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen dhe çmoi lart kontributin dhe angazhimin e Bashkësisë Islame për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave islame në Kosovë.

Në të gjitha xhamitë e Kosovës u bënë lutje për të aksidentuarit në Bullgari

Më 26 nëntor me rekomandim të Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, sot në të gjitha xhamitë e Kosovës (në kuadër të ligjëratës së ditës së xhuma), u bënë lutje dhe dua për të aksidentuarit në Bullgari, duke e lutur Zotin që të lënduarit prej tyre t'i shërojë sa më shpejt, ndërsa të vdekurit t'i mëshirojë e t'i gradojë me xhennet.


Duhet theksuar se ditë më parë Kryesia e BIK-ut lëshoi edhe një deklaratë për opinionin më ç'rast

thuhet se “Me dhimbje e pikëllim të madh mora lajmin për 46 jetët e humbura të vëllezërve nga Maqedonia e Veriut në aksidentit e mbrëmshëm tragjik në Bullgari. Ngushëllimet e mia më të sinqerta familjeve të viktimave ndërsa të plagosurve shërim të shpejtë. Bashkësia Islame e Kosovës, bashkëndjen dhembjen me familjarët të cilëve në këto momente të rënda u jemi pranë”. Andaj lusim Zotin e Madhëruar që viktimat t'i marrë në mëshirën e Tij, ndërsa të afërmeve t'u japë sabër e gajret!



Granit Hyseni dhuroi 20 tituj librash të vjetër mbi 120 vjeçar për Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame

Më 26 nëntor Granit Hyseni nga Shalci i Vushtrrisë në mënyrë solemne ka dorëzuar 20 libra të vjetër 120 vjeçar për Bashkësinë Islame të Kosovës, gjegjësisht në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame. Këto libra kryesisht janë literaturë e dorëshkrime mbi 120 vjeçare të vjetra. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë pranoi këtë bibliotekë, duke i konsideruar tejet të rëndësishme për fenë islame dhe i cilësoi si jashtëzakonisht të një rëndësi të veçantë për arkivin e dorëshkrimeve që tashmë Kryesia ka ftuar edhe të gjithë ata që kanë dorëshkrime të vjetra që t'i dorëzojnë në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame. Ai më pas tha se këto libra janë të fushës së akaidit, fikhut, gjuhës, filozofisë e letërsisë arabe. Nga ana e tij, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri



Bajgora vlerësoi këtë hap të qëlluar të z. Granit Hysenit dhe po ashtu apeloj te të gjithë ata që kanë dorëshkrime të tilla mos të hezitojnë por t'ia dorëzojnë Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në mënyrë që ne të themelojmë bibliotekat e fushave

të ndryshme shkencore e edhe të hoxhallarëve dhe dijetarëve tanë të mëhershëm që të ndriçojmë sadopak një pjesë të jetës dhe veprës së tyre që mos t'i mbuloj harresa sepse me kalimin e viteve fitojnë në vlerë dhe peshë shkencore. (R.S.)

Vizita e drejtorit të Diasporës së BIK-ut në Gjermani

Më 26 nëntor, me ftesë të Qendrës Shqiptare në Dusseldorf, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica qëndroi në Gjermani. Kjo vizitë u organizua me rastin e thellimit të

bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Gjermani, (UQISHGJ) të udhëhequr nga kryetari Mensur ef. Halili, njëherësh imam i xhamisë në

Dusseldorf. Drejtori Simnica, u mirëprit nga imami i xhamisë në Dusseldorf, i shoqëruar nga kryetari i kësaj qendre dhe një grup i xhemaatit. Kjo qendër përpos xhamisë, ka edhe objektet përcjellëse, siç janë këndi për

shitjen e librave, mësonjëtorja, bufeja dhe hapësirat të tjera ndihmëse, të cilat e bëjnë qendrën edhe më funksionale dhe më të shfrytëzueshme për bashkatdhetarët tanë.

Drejtori Simnica mbajti një ligjëratë në ditën e xhuma, në të cilën fillimisht i uroi dhe i përshëndeti kryesinë dhe imamin e kësaj xhamie për punën dhe aktivitetin e tyre. “Më lejoni që në emrin tim personal, në emër të Myftiut Tërnavë, si dhe në emër të BIK-ut t’u uroj dhe t’u përgëzoj për punët dhe aktivitetet madhore që po i bëni në xhaminë tuaj, por kam nderin që t’u uroj e përgëzoj të gjithë shqiptarët kudo që gjenden përvjetorin e ngritjes së Flamurit, shpalljes së pavarësisë dhe themelimit të shtetit shqiptar, ngjarje kjo që është më e rëndësishëm për popullin tonë.” Gjatë kësaj vizite, drejtori Simnica mbajti edhe hytben e xhumasë, si dhe i priu namazit të xhumasë. Në mbremje, drejtori Simnica me krytarin e UQISHGJ z. Mensur Halili vizituan Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Dusseldorf me rastin e dy vjetorit të hapjes së saj dhe manifestimit të organizuar me rastin e shënimit të 28 Nëntorit, ditës së flamurit, shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë, në të cilën u pritën nga konsulli z. Arjan Kashtanjeva dhe stafi i tij.

Ndërsa më 27 nëntor, drejtori Simnica, i shoqëruar nga kryetari i



UQISHGJ, z. Mensur ef. Halili vizitoi xhaminë e re “Ebu Hanife” në Troisdorf të Gjermanisë, ku u mirëprit nga kryetari i xhamisë h. Mahir Mustafi, imami i kësaj xhamie Bedri Syla, imam i ri, si dhe anëtarët e kryesisë së kësaj xhamie dhe nga një numër të konsiderueshëm të xhematit.

Së pari drejtori Simnica vizitoi objektin shumë madhështorë. Kjo qendër përpos xhamisë shumë të bukur, ka edhe të gjitha objektet përcjellëse, siç janë biblioteka, këndi për shitjen e librave, mësonjëtorja, bufeja, restoranti, dhomat e gjumit

për mysafirë, zyre pune dhe hapësirat të tjera ndihmëse, të cilat e bëjnë qendrën edhe më funksionale dhe më të shfrytëzueshme për bashkatdhetarët tanë. Drejtori Simnica mbajti ligjëratë pas namazit të jacisë dhe uroi dhe përshëndeti kryesinë, imamin Bedri Syla, të cilin e uroi për detyrën e re dhe xhematin e kësaj xhamie me rastin e aktivitetit në këtë objekt. Drejtori Simnica uroi të pranishmit për qendrën e re dhe për festën e 28 Nëntorit, duke thënë: “Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në emër të BIK-ut në emër të strukturave drejtuese të saj, në emrin e Myftiut të Kosovës, z. Tërnavë dhe në emrin tim, t’ju përshëndes në këtë përvjetor të rëndësishëm për kombin shqiptar, 109 vjetorin e ngritjes së flamurit, shpalljes së pavarësisë dhe themelimit të shtetit shqiptar, ngjarje kjo që është më e rëndësishëm për popullin tonë.” Ai i falënderoi për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm të tyre për vendlindjen dhe për institucionet tona fetare-arsimore, Medresenë “Alauddin” dhe FSI në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite, drejtori Simnica, pa nga afër edhe zhvillimin e mësim-besimit në këtë xhami.



Kryeimami Sahiti u prit nga Myftiu i Stambollit, z. Safi Arpaguş

Më 27 nëntor, kryeimami Sahiti u prit nga Myftiu i Stambollit, z. Safi Arpaguş, i cili i uroi mirëseardhje dhe e falënderoi kryeimamin Sahiti për vizitën. Temë diskutimi në këtë takim ishte bashkëpunimi ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Myftinisë së Stambollit.

Kryeimami Sahiti fillimisht e uroi myftiun Arpaguş për detyrën e re në krye të Myftinisë së Stambollit dhe më pas e njohu atë me mbarëvajtjen dhe organizimin e jetës fetare islame në Kosovë. Ne çojmë lart kontributin dhe angazhimin e institucioneve të Turqisë në mbështetje të projekteve konkrete të



BI-së theksoi mes tjerash kryeimami Sahiti. Në fund të takimit kryeimami Sahiti i dhuroi myftiut Arpaguş, librin Katalogu i dorëshkrimeve arabe në bibliotekën e BIK-ut.

U mbajt samiti i tetë me radhë i produkteve hallall, "Helal Expo 2021"

Nën organizimin e Organizatës për Bashkëpunim Islamik, OIC dhe Republikës së Turqisë, në Stamboll u mbajt samiti i tetë me radhë i produkteve hallall, "Helal Expo 2021", ku mori pjesë edhe Bashkësia Islame e Kosovës, përmes Kosova Halal Institute, si trupë certifikuese e produkteve hallall në Kosovë. Në këtë samit morën pjesë 36 shtete me mbi 378 kompani ndërkombëtare të



profileve të ndryshme me produktet e tyre hallall. "Helal Expo 2021" synon rritjen e vetëdijes së konsumatorit me konceptin e të jetuarit hallall dhe rritjen e shkëmbimit tregtar të produkteve hallall.

Kryeimami Sahiti vizitoi qendrën kulturore İRCİCA

Më 29 nëntor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, gjatë vizitës së tij zyrtare në Turqi vizitoi qendrën kulturore İRCİCA, ku u prit nga zv/drejtori gjeneral, prof. dr. Aboubacar



Senghore, ish-ministër i jashtëm i Gambisë. Kryeimami Sahiti falënderoi z.Senghore për mikpritjen e ngrohtë dhe e njohu për organizimin e jetës fetare në

Kosovë. Nga ana e tij, z Senghore falënderoi kryeimamin Sahiti për vizitën dhe theksoi gatishmërinë e plotë të İRCİCA-s që të bashkëpunojë me Bashkësinë

Islame të Kosovës në realizimin e projekteve të përbashkëta. İRCİCA është organ i organizatës së bashkëpunimit islamik (OİC) me seli në Stamboll.

Kryesia e BIK-ut mbajti mbledhjen e rregullt të saj

Më 30 nëntor, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të kryesuar nga kryetari, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Mbledhja u hap me një këndim të sures El Fatiha për shpirtat e atyre që vdiqën nga aksidentit tragjik në Bullgari, si dhe viktimave që vdiqën nga sulmi kriminal mbi autobusin ku mbetën të vrarë tre persona, dy prej tyre nxënës që ktheheshin nga shkolla në Deçan. Më pas Myftiu Tërnavë shprehu falënderimin e tij për gjithë anëtarët e Kryesisë, si dhe për të gjithë

punëtorët e BIK-ut për kontributin që janë duke dhënë në shërbim të forcimit dhe ngritjes së fjalës së Allahut xh.sh. “Falënderojmë Allahun që na ka mundësuar të jemi pjesëtarë të kësaj feje dhe të japim kontribut që të vazhdojmë në rrugën e Muhamedit a.s., sahabëve dhe pasuesve të tyre dhe kështu do të vazhdojë deri në kiamet. Po ashtu lusim Allahun që sa më shpejtë të kalojë kjo pandemi dhe që bota të kthehet në normalitet të plotë” – tha Myftiu Tërnavë, njëherësh, ai luti

Zotin që të kemi shëndet e prosperitet në shtetin tonë. Më pas mbledhja vazhdoi me rendin e ditës si me leximin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja e fundit e Kryesisë, parapërgatitje për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të BI-së së Kosovës. Kryesia pas analizave dhe shtjellimit aprovoi Projekt-buxhetin e Këshillave të BI-së dhe Kryesisë së BIRK-ut për vitin 2022 si dhe më pas u vazhdoi diskutimi me shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve nga kompetencat e Kryesisë. (R.S.)



Kryeimami Sahiti priti në takim zëvendës drejtorin gjeneral të Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë, Aydın Cem Aslanbay

Më 6 dhjetor, kryemami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim zëvendës drejtorin gjeneral të Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, Aydın Cem Aslanbay të shoqëruar nga drejtoresha për marrëdhënie me jashtë, Aişe Eda Murat, drejtoresha e sektorit të monumenteve kulturore, Şengül Koncagül, mbikëqyrësja e punimeve, Keriman Dursun dhe Hacer Coşkun,

të cilët po qëndrojnë për vizitë zyrtare në vendin tonë. Kjo vizitë ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në realizimin e projekteve të përbashkëta me Bashkësinë Islame të Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore islame dhe atë sociale e shëndetësore.

Kryemami Sahiti falënderoi zv. drejtorin Aslanbay për vizitën dhe për përkushtimin e Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë për të ndihmuar Bashkësinë Islame në ruajtjen dhe restaurimin e

trashëgimisë kulturore islame në vendin tonë duke realizuar një sërë projektesh me rëndësi si në Gjakovë, Pejë, e Syriganë të Skenderajt, e tani edhe me projekte në kryeqytet. Kryeimami Sahiti e falënderoi drejtorin e vakëfeve edhe për bashkëpunimin në fushën humanitare e shëndetësore përmes të cilave kanë përfituar qytetarët e vendit tonë.

Aydın Cem Aslanbay falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen

dhe për bashkëpunimin në realizimin e projekteve nga fusha e trashëgimisë kulturore dhe ajo humanitare e shëndetësore. “Jemi këtu për të theksuar edhe njëherë gatishmërinë tonë për t’ju ndihmuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame si dhe në fushat tjera ku ju keni nevojë, theksoi zv.drejtori Aslanbay.

Pas takimit, kryeimami Sahiti bashkë me delegacionin nga Drejtoria e Vakëfeve vizituan punishtet e restaurimit të dy xhamive me rëndësi të veçantë historike e kulturore në Prishtinë, xhaminë Alaudin si dhe xhaminë e Pirinazit. Më pas kryeimami bashkë me delegacionin nga Ankaraja vazhduan vizitën në Gjilan, ku u pritën nga kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame, Naim Aliu, me ç’rast vizituan edhe projektin e radhës, xhaminë Atik, i cili pritet të fillojë gjatë vitit të ardhshëm. (A.C.)



Kryeimami Sahiti dhe delegacioni nga Turqia vizituan disa xhami të restauruara nga Drejtoria e Vakëfeve të Turqisë

Më 7 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me delegacionin e Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë, të udhëhequr nga zv/drejtori gjeneral, Aydin Cem Aslanbay, kanë vizituar sot disa nga projektet e realizuara në Kosovë që janë restauruar deri më tani dhe që do të restaurohen nga kjo drejtori në bashkëpunim me Bashkësinë Islame.

Vizitat e zv/drejtorit të Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë me kryeimamin e Kosovës, filluan në Mamushë ku vizituan kompleksin e ri të xhamisë në këtë komunë, ku bëjnë pjesë sahat kulla së bashku me objektet përcjellëse që mundësojnë edhe mësim-besimin.

Kryeimami Sahiti dhe zv/drejtori, Aslanbey u pritën nga kryetari i Komunës së Mamushës, Abdülhadi Krasniç, me që rast biseduan për investimet e realizuara nga kjo drejtori në këtë komunë dhe rëndësinë që kanë për besimtarët dhe trashëgiminë kulturore islame.

Të nderuar me vizitën në Këshillin e Bashkësisë Islame të Rahovecit, u shprehën udhëheqësit e këtij këshilli, me ç’rast falënderuan përzemërsisht për investimin e Drejtorisë së Vakëfeve në këtë qytet.



Kryeimami Sahiti duke vlerësuar lart përkushtimin dhe angazhimin e Drejtorisë së Vakëfeve, falënderoi për kontributin që kanë dhënë në këtë komunë si dhe në gjithë Kosovë, duke njoftuar delegacionin nga Ankaraja se ky objekt do të shërbejë kryesisht për mësim-besimin e të rinjve në këtë qytet, të cilët janë mjaft aktiv.

Vizita e delegacionit më pas vazhdoi për në Gjakovë. Në këtë qytet u njoftuan me punimet finale në xhamitë e restauruara, të Sefës, atë të Kusarëve dhe xhamisë së Mulla Jusufit dhe xhaminë e Mahmut Pashës që është ende në proces. Në ndërkohë, në këtë qytet vizituan

edhe Medresenë e Vogël, e cila është restauruar vite më parë, për të ndërtuar afër saj konviktin e qendrës së trajnimeve. Në fund të kësaj vizite në Komunën e Gjakovës, vizituan edhe fshatin Rogovë, ku panë për së afërmi xhaminë e “Hasan Agës”, njërës prej më të vjetrave në këtë zonë, e cila pritet që shumë shpejtë të restaurohet.

Kjo vizitë tre ditore ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në realizimin e projektorëve të përbashkëta me Bashkësinë Islame të Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore islame dhe atë sociale e shëndetësore. (A.C.)

Kryeimami Sahiti dhe delegacioni nga Turqia vizituan xhamitë e restauruara në Pejë e Skenderaj

Më 7 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me delegacionin e Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë, kanë vizituar disa nga xhamitë e restauruara dhe xhamitë projektet e të cilave do të restaurohen gjatë vitit të ardhshëm.

Vizita në ditën e tretë të delegacionit nga Ankaraja në Kosovë, filloi në Pejë, atje ku vizituan njërin prej xhamive kryesore të këtij qyteti, Xhaminë Bajrakli apo siç njihet ndryshe ajo e Çarshisë. Të kënaqur me bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve për restaurimin dhe konservimin e kësaj xhamie u shprehën delegacioni nga Ankaraja dhe kryeimami Sahiti, i cili njoftoi delegacionin për rëndësinë kulturore e historike të kësaj xhamie.

Më pas vizitën e vazhduan në xhamitë të cilat do të restaurohen dhe konservohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Vakëfeve të Turqisë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës; siç janë xhamia “Gjylfatyn”, Xhamia e Kuqe si dhe xhaminë “Abdurrazak Efendi” apo xhaminë e “Sahat Kullës” –xhami kjo që ekziston që nga shekulli XVIII.

Kryeimami Sahiti së bashku me zv.drejtorin Aslanbej vizituan edhe xhaminë e fshatit Syrganë të



Skenderajt, ku është bërë një punë e mrekullueshme në restaurimin e saj. Banorët e këtij fshati së bashku me këshillin e Bashkësisë Islame në Skenderaj falënderuan Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Drejtorinë e Vakëfeve të Turqisë për restaurimin e xhamisë së fshatit, duke thënë se populli turk dhe shqiptar çdoherë kanë qenë afër njëri-tjetrit, ashtu sikurse tani me bashkimin për restaurimin e xhamive dhe në formë tjetra.

Gjatë vizitës në Vushtrri, kryeimami Sahiti dhe zv.drejtori Aslanbej u pritën nga kryetari i Këshillit të Vushtrrisë, Shemsi Rahimi dhe më

pas vizituan së bashku edhe xhaminë Gazi Ali Beu, njëra prej xhamive më të vjetra në këtë qytet.

Delegacioni i Vakëfeve nga Ankaraja ka qëndruar tri ditë në Kosovë, me ç’rast vizituan xhamitë e restauruara dhe që ato do të restaurohen në të ardhmen si në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Pejë, Skenderaj, Vushtrri dhe qytete të tjera. Kjo vizitë e Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë synon rritjen e bashkëpunimit në realizimin e projekteve të përbashkëta me Bashkësinë Islame të Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore Islame dhe atë sociale e shëndetësore. (A.C.)

Kryeimami Sahiti mori pjesë në seminarin “Sfidat institucionale të interpretimit të Islamit në Ballkanin Perëndimor”

Nën organizimin e Bashkësisë Islame në Bosnje, me datë 10-12 dhjetor 2021, në Qendrën Kulturore Islame të Tivarit të Malit të Zi, me pjesëmarrjen e vendeve të rajonit nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut e Sanxhaku, u mbajt seminar për imamët boshnjakë me temën “Sfidat institucionale të interpretimit të Islamit në Ballkanin Perëndimor”, ku morën pjesë edhe imamët boshnjakë nga Kosova, kryesisht nga Prizreni dhe komuna e Dragashit.

Në hapje të këtij seminary mori pjesë edhe kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili në fjalën e tij përshëndeti



falënderoi organizatorët për organizimin e këtij seminari me rëndësi të veçantë për imamët boshnjakë, që ka për synim ngritjen e kapaciteteve profesionale të imamëve për të shërbyer sa më mirë pranë xhematëve të tyre.

Kryeimami Sahiti në fjalën e tij u fokusua në kontributin dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në ngritjen profesionale të imamëve qoftë përmes institucioneve edukativo arsimore të saja, sikur janë medresetë, fakulteti, institutet e hifzit. Ndërsa me qëllim të avansimit

edhe më të madh të imamëve në veçanti dhe gjithë shërbyesve fetar, Bashkësia Islame e Kosovës ka përfunduar edhe projektin e qendrës për trajnime në Gjakovë, i cili pritet të hyjë në funksion, theksoi mes të tjera kryeimami Sahiti.

U mbajt Konferenca shkencore kushtuar 50 vjetorit të daljes së revistës “Edukata Islame”

Më 15-16 dhjetor, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës organizoi Konferencën shkencore “Revista “Edukata Islame” -50 vjet mision në fjalën e shkruar shqipe” kushtuar 50 vjetorit të daljes së kësaj reviste. Në këtë konferencë morën pjesë studiues e hulumtues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe më gjerë.

Mysafirëve mirëseardhje iu dëshiroi kryeimami Vedat ef. Sahiti, i cili në emër të Këshillit Organizativ të kësaj Konference përshëndeti të pranishmit dhe ndër të tjera tha: “Përveç që po organizohet për herë të parë, kjo Konferencë ka edhe një domethënie tjetër, ku këtu u jepet edhe mirënjohje të gjithë atyre që kanë kontribuar për këto 50 vjet për këtë revistë dhe jemi të bindur se nga kjo Konferencë do të dalin përfundime dhe rezultate të reja për revistën dhe periodikun e BIK-ut.”

Më pas kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mbajti fjalim përshëndetëse. Ai më pas e cilësoi historik themelimin e kësaj reviste. “Në vazhden e këtyre vendimeve që mori asokohe udhëheqja e BIK-ut që edhe vendimi për nxjerrjen e revistës “Edukata Islame” e cila që në embrion ishte dizajnuar si revistë fetare islame.

Ai më pas shprehu mirënjohjen më të sinqertë dhe konsideratat më të thella për drejtuesit – kryeredaktorët, redaktorët dhe për të gjithë bashkëpunëtorët e revistës “Edukata islame”. Një mirënjohje të veçantë në këtë përvjetor, gjithësi e meritojnë lexuesit tanë të nderuar nga të gjitha viset shqiptare dhe diaspora, të cilët, me interesimin dhe besnikërinë e tyre për revistën “Edukata islame”, ishin dhe vazhdojnë të jenë garancia më e



fuqishme dhe motivi kryesor për punën dhe angazhimin tonë.

Këtë konferencë në emër të reisit të Malit të Zi e përshëndeti Omer Kajoshaj zv/ kryetari i BI-së së Malit të Zi, i cili uroi këtë përvjetor dhe tha se ne jemi rrit dhe formuar me këtë revistë që nga fëmijëria. “Revista “Edukata Islame” vazhdon të na mësojë, por ajo është sikur yjet e para që shfaqen në qiell e ndriçojnë më së shumti jo vetëm për të treguar rrugën bukurinë e tyre por për të treguar rrugën e udhëtarëve që udhëtojnë në tokë. “Edukata Islame” është ylli polar i ynë dhe është kënaqësi të flasësh për diçka që është me vjetër se ti dhe këtë amanet që e trashëguam nga të parët tanë me besnikëri tua lejme gjeneratave të reja”- tha Kajoshaj.

Kryeredaktori i Edukatës Islame prof. Sabri Bajgora në referatin e tij me temë: “Edukata Islame – Tribunë e mendimit Islam” theksoi se ky vit, 2021, është vit i dy përvjetorëve mjaft të rëndësishëm për BIK-un. Fillimisht është ky i sotmi, pesëdhjetëvjetori i daljes në dritë të numrit të parë të revistën më jetëgjatë islame në trojet

shqiptare - Edukatës Islame, revistë e cila akoma vazhdon të botohet sot e kësaj dite katër herë në vit, si dhe 70-vjetori i fillimit të punës së Medresesë “Alauddin” në Prishtinë.

Kryesia e BIK-ut ka marrë vendim që ish-kryeredaktorëve të deritanishëm t’u ndaj mirënjohje që drejtuan revistën në këto pesë dekada. Fillimisht mirënjohje post-mortum iu ndanë Sherif ef. Ahmetit, Hajrullah ef. Hoxhës, dhe profesorit Qemajl Morina. Me mirënjohje u nderua edhe ish-kryeredaktori Resul Rexhepi dhe kryeredaktori aktual Sabri ef. Bajgora.

Në emër të ish kryeredaktorëve një fjalë rasti mbajti Resul Rexhepi, i cili veç tjerash tha se Edukata Islame ka qenë një fanar i cili ka ndriçuar në tunelin e pafund e pa dritë e paskajë dhe për nja 20 vjet ka qenë e vetmja revistë në gjuhën shqipe, pak më serioze, e cila e ka përcjell mesazhin dhe misionin islamë deri te lexuesi i nderuar.

Në seancën e parë u lexuan këto kumtesa të këtyre referuesve: Ramadan Shkodra, “Revista “Edukata Islame” – historiku, sfidat

dhe perspektiva”; 2. Feti Mehdiu, “Paria islame dhe “Edukata Islame” ndërmjet tradicionales dhe modernes”; 3. Muhamed Mustafi, “Jetësimi i Islamit nëpërmes “Edukatës Islame”; 4. Sadik Mehmeti, “Kontributi i veçantë i Haxhi Sherif ef. Ahmetit në “Edukatën Islame”; 5. Hysen Matoshi, “Kontributi i prof. Qemajl Morinës në revistën “Edukata Islame”; 6. Florim Mellova, “Kontributi i hfz. Avni Aliut në revistën “Edukata Islame”. Në seancën e dytë referatet janë nga: 1. Ahmet Sadriu, “Kontributi i prof. Bajrush ef. Ahmetit në revistën “Edukata Islame”; 2. Isa Memishi: “Prania e prof. Hasan Kaleshit në revistën “Edukata Islame”; 3. Ferdi Kamberi, “Kontributi i akademik Pajazit Nushit në Revistën “Edukata Islame”; 4. Hatixhe Ahmedi, “Ndihmesa e Muhidin ef. Ahmetit në “Edukatën Islame”; 5. Abdulla Rexhepi, “Mendimi filozofik dhe filozofia Islame në “Edukatën Islame”; 6. Sedat Islami, “Ligjërimi fetar në “Edukatën Islame”; Në seancën e tretë referatet janë nga: 1. Resul Rexhepi, “Edukata Islame” shkollë e veçantë e mësimit të fikhut hanefij”; 2. Jusuf Zimeri, “Kontributi i revistës “Edukata Islame” në shpjegimin e fikhut islam”; 3. Ziber Lata, “Kontributi i revistës “Edukata Islame” në fushën e kuranologjisë”; 4. Valmire Batatina, “Prania e temave të tefsirit në “Edukatën Islame”; 5. Azmir Jusufi, “Kontributi i autorëve shqiptarë në fushën e tefsirit në “Edukatën Islame”; 6. Orhan Bislimaj, “Kontributi i “Edukatës Islame” në fushën e akaidit”; Në seancën e katërt referatet janë nga: 1.

Fahredin Ebibi, “Kontributi i revistës “Edukata Islame” në fushën e hadithit”; 2. Sulejman Osmani, “Tematikat e hadithit në punimet e revistës “Edukata Islame” dhe mënyra e aplikimit të standardëve shkencore”; 3. Fahrush Rexhepi, “Përfshirja e artikujve të “sires” së Pejgamberit a.s. në revistën “Edukata Islame”; 4. Naser Ramadani, “Kontributi i revistës “Edukata Islame” në fushën e pedagogjisë”; 5. Isa Tërshani, “Prania e temave të ahlakut në revistën “Edukata Islame”; 6. Rexhep Suma, “Revista “Edukata Islame” urtare në misionin e edukimit dhe thirrjes islame”.

Ndërsa në ditën e dytë, në seancën e pestë referatet janë nga: 1. Selim Bezeraj, “Trajtimi i figurave dhe aspekteve kombëtare në revistën “Edukata Islame”; 2. Çlirim Duro, “Dimensioni kulturor i revistës “Edukata Islame” dhe impakti i saj në studimet shqiptare”; 3. Abdurrahman Maxhuni, “Terminologjia islame në titujt e revistës “Edukata Islame”; 4. Valon Shkodra, “Trashëgimia kulturore e Kosovës në revistën “Edukata Islame”; 5. Arian Pulaj, “Trashëgimia islame e Prizrenit në revistën “Edukata Islame”; 6. Faton Pllana, “Historiografia shqiptare në “Edukatën Islame”. Në seancën e gjashtë referatet janë nga: 1. Abdullah Hamiti, “Kontributi i “Edukatës Islame” për ndriçimin e shkrimtarëve shqiptarë në gjuhët orientale”; 2. Adem Zejnullahu, “Gjuha dhe letërsia shqipe në revistën “Edukata Islame”; 4. Muzaqete Kosumi, “Kontributi i “Edukatës Islame” për tolerancën, mirëkuptimin dhe harmoninë ndërfaqetare”; 5. Teuta

Borovci, “Autoret në revistën “Edukata Islame”; 6. Violeta Smajlag, “Gruaja në revistën “Edukata Islame”. Në seancën e shtatë dhe të fundit referatet janë nga: Haki Sahitaj, “Bota islame në revistën “Edukata Islame”; 2. Ferid Selimi, “Informativiteti – njoftueshmëria në shkrimet e botuara në revistën “Edukata Islame” 3. Bashkim Mehani, “Prezantimi i artit islam në revistën “Edukata Islame”; 4. Ekrem Simnica, “Kontributi i revistës “Edukata Islame” në Diasporë”; 5. Vedat Shabani, “Përkthimi në revistën “Edukata Islame”; 6. Selim Sylejmani, “Islami fe e tolerancës dhe mirëkuptimit midis popujve”.

Në fund të kësaj konference mori fjalën edhe Myftiu Tërnavë, i cili falënderoi bashkëpunëtorët dhe të gjithë ata që kontribuuan në mbarëvajtjen dhe përfundimin e suksesshëm të kësaj konference shkencore, e në veçanti drejtorin për kulturë dhe veprimtari botuese z. Ramadan Shkodrën.

Edhe kryeredaktori i revistës “Edukata Islame”, Sabri ef. Bajgora, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e kësaj konference dhe mundin e tyre dhe kërkoi edhe njëherë nga pjesëmarrësit dhe pendët e tjera që me shkrimet e tyre të kontribuojnë në ngritjen e nivelit të revistës drejt objektivave që ka vendosur para saj. Krejt në fund drejtori për kulturë dhe veprimtari botuese, Ramadan Shkodra, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit të cilët kontribuuan me kumtesat e tyre në këtë Konferencë dhe njëherësh premtoi se me mbështetjen e Myftiut Tërnavë do të mbahen edhe konferenca të tjera dhe aktivitete kulturore. (R.S.)



Kryeimami Sahiti vizitoi KBI-në në Han të Elezit

Më 14 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga zëvendësi i tij, Fatmir ef. Iljazi, kanë vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame të Hanit të Elezit, në të cilin takuan kryetarin Musa ef. Vila, nëpunësit e administratës dhe imamët e këtij Këshilli.

Në takim, kryeimami Sahiti shprehu gatishmërinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për të mbështetur punën dhe aktivitetet e këshillave në përgjithësi, e në veçanti atij të Hanit të Elezit. Në fokus të takimit ishte diskutimi mbi rolin dhe përgjegjësinë e imamit bazuar në rregulloret dhe aktet e tjera normative në mënyrë që imamët të jenë në

shërbim të besimtarëve me një përkushtim edhe më të madh. Gjatë këtij takimi me theks të veçantë u diskutua edhe mbi çështjen e mësim-besimit dhe fuqizimit të Departamentit të Gruas pranë këtij Këshilli. Këto ishin nga temat me rëndësi që u diskutuan dhe u trajtuan në takim.



Kryeimami Sahiti takoi mualimet e Departamentit të Gruas

Më 15 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me mushavirin, Nevzat Sabri Akın, kanë takuar mualimet e angazhuara pranë Departamentit të Gruas, për të vlerësuar punën dhe angazhimin e tyre në fushën e mësim-besimit gjatë vitit 2021. Përkundër vështirësive që na sollti pandemia Covid-19, mualimet gjatë këtij viti ishin shumë aktive gjithandej këshillave të Bashkësisë Islame.

Kryeimami Sahiti shprehu gatishmërinë dhe përkushtimin për të mbështetur edhe më tepër punën dhe aktivitetet e Departamentit të Gruas, duke u mundësuar atyre më shumë hapësirë në davet e mësim-besim dhe



integrim të gruas në institucionet e Bashkësisë Islame.

Gjatë këtij takimi me theks të veçantë u diskutua edhe për trajnimet

dhe punëtoritë e specializuara për avansimin profesional të mualimeve përgjatë vitit 2022.

Kryeimami Sahiti takoi imamët e KBI-së së Klinës dhe të Istogut

Më 16 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me zv. kryeimamin Fatmir ef. Iljazin, vizituan KBI të Klinës, ku u pritën nga kryetari Kadri ef. Berisha dhe imamët e Klinës me rrethinë. Kryeimami Sahiti falënderoi Këshillin

e Klinës dhe imamët për punën dhe angazhimin e tyre në jetën fetare e sidomos në kultivimin e kulturës së bashkëjetesës dhe kontributin e tyre humanitar gjatë periudhës pandemike. Gjatë takimit u diskutua edhe për mësim-besimin, si dhe çështje të tjera me rëndësi për

avancimin e jetës fetare në komunën e Klinës.

Në këtë vazhde të takimeve, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga zv. kryeimami, Fatmir ef. Iljazi, vizituan Këshillin e Bashkësisë Islame të Istogut, ku takuan kryetarin e

Këshillit, Tahir ef. Bekën dhe imamët e kësaj komune.

Kryeimami Sahiti vlerësoi punën dhe angazhimin e imamëve të Istogut në organizimin e jetës fetare edhe përkundër vështirësive të pandemisë Covid-19, mirëpo kërkoi nga ta që gjatë këtij viti të jenë më aktiv qoftë në davet, e sidomos në mësim-besim, ngase mësim-besimi është prioritet. Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe çështje të tjera me rëndësi për një organizim sa më të mirë të jetës fetare në Istog me rrethinë.



Kryeimami Sahiti vizitoi Institutin e Hifzit të Kuranit në Prizren

Më 17 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me mushavirin Nevzat Sabri Akin, vizituan Institutin e Hifzit të Kuranit në Prizren, ku takuan nxënësit që po vijojnë mësimin e rregullave të leximit dhe nxënien e Kuranit përmendsh.

Kryeimami përgëzoi muhafizët-mësuesit për kujdesin dhe përkushtimin e tyre madhor me nxënësit e grup moshave të reja dhe theksoi se BIK-u është i përkushtuar të hapë institute të hifzit të Kuranit edhe në qytete të tjera të Kosovës dhe gjatë vitit të ardhshëm do të futet në funksion



edhe qendra në Pejë dhe Rahovec, meqë objektet kanë përfunduar gjatë vitit 2021. Në fund të takimit

me nxënësit u këndua Kuran dhe u lexua duaja e hatmes së përfunduar nga nxënësit.

Falet xhumaja e parë në xhaminë e re në Gracë të Lipjanit

Më 24 dhjetor, nën këndimin e tekbireve dhe lutjeve kuranore, në prani të përfaqësuesve të Kryesisë së BIK-ut, besimtarëve e banorëve të fshatit Grackë, u fal xhumaja e parë në xhaminë e re në Gracë të Lipjani. Në këtë eveniment, në emër të Kryesisë së BIK-ut dhe Myftiut Tërnavë një fjalë rasti mbajti sekretari i përgjithshëm i Kryesisë Ahmet ef. Sadriu, i cili njëherësh mbajti edhe hytben e xhumasë. Ai duke uruar banorët për këtë xhami të re përcolli edhe urimet e Myftiut Tërnavë për xhaminë e re të këtij fshati dhe më pas tha se sot po bëjmë një hapje gjysmëzyrtare të xhamisë, ngase hapja zyrtare do të bëhet kur do të jetë prezent edhe donatori nga Kuvajti. Ai më pas nënvizoi se xhamitë i

ndërtojnë dhe mirëmbajnë ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, dhe se ai që ndërton një xhami do t'ia ndërtoj Allahu një shtëpi në xhenet. Ai më pas nënvizoi se BIK-u është i

përkushtuar që t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të xhemit që t'u plotësoj nevojën e tyre për ngritjen e xhamive që obligimet e tyre t'i kryejnë sa më lehtë dhe në infrastrukturë të



mirë për falje dhe aktivitete të xhamisë. Ai krejt në fund porositi që mësim-besimit më fëmijë t'i kushtohet rëndësi ku gjeneratat e reja do të formoheshin drejt si në aspektin fetar dhe kombëtar. Ndërkaq kryetari

i KBI-së së Lipjanit, Zaim ef. Baftiu falënderoi Myftiun Tërnavë për kontributin e dhënë në ndërtimit të kësaj xhamie, donatorin, komunën e Lipjanit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar në finalizimin e ndërtimit

të kësaj xhamie, duke nënvizuar se kjo është xhamia e 33 në Lipjan. Në emër të banorëve të fshatit foli kryetari i fshatit prof. Ali Sopa, i cili edhe njoftoi për ecurinë e punimeve të xhamisë. (R.S.)

“Bereqeti” dhe Shoqata Humanitare “Peja” në Nju Jork ndihmuan 447 familje nevojtare

Më 26 dhjetor, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” e cila funksionon në kuadër të Kryesisë së BIK-ut, në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare “Peja” në Nju Jork, me komunitetin shqiptar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në këtë fund vit kanë ndihmuar 447 familje në nevojë, familje të dëshmorëve, veteran dhe kategori të tjera. Përpos familjeve që u ndihmuan në Pejë, Deçan, Klinë e Istog, kësaj radhe do të ndihmohen edhe 50 familje në Mitrovicë dhe 50 familje në Drenas. Kushtrim ef. Kelmendi nga “Bereqeti”, në Pejë, tha se në emër të shoqatës falënderojmë të gjithë donatorët dhe bashkëpunëtorët, që në vazhdimësi i ndihmojnë nevojtarët me pako ushqimore ose më projekte të tjera humanitare, dhe tash po ndihmojmë familjet në nevojë, familjet e dëshmorëve



veteranët e UÇK-së, jo vetëm në Pejë dhe rrethinë, Klinë, Istog e Deçan, kurse edhe këtë vit do të ketë numër më të madh të përfituesve. Shoqata Humanitare “Peja” në vazhdimësi ka ndihmuar qytetarët në nevojë në Kosovë me shpërndarjen e pakove me

gjëra ushqimore për familjet në nevojë. Për fund “Bereqeti” premton se do t'u dalë në ndihmë të gjithë atyre familjeve që kanë nevojë për ndihma që janë në gjendje të vështirë ekonomike. (R.S.)

Kryeimami Sahiti mori pjesë në hapjen e sesionit të radhës së trajnimit për mualime

Më 27 dhjetor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar edhe nga zëvendësi i tij, Fatmir ef. Iljazi, morën pjesë në hapjen e trajnimit të radhës për grupin e tretë të mualimeve të angazhuara pranë Departamentit të Gruas, trajnim ky që udhëhiqet nga trajneri, Bashkim ef. Mehani.

Kryeimami Sahiti tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar për avancimin dhe ngritjen profesionale të mualimeve në nivel vendi. Ai edhe njëherë shprehu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që të mbështes aktivitete të tilla edhe në vazhdim.

Gjatë takimit, kryeimami Sahiti paraqiti edhe planin e trajnimeve dhe punëtoritë e specializuara për



avancimin profesional të mualimeve përgjatë vitit 2022.

Ky ishte grupi i tretë për ciklin e parë të trajnimeve të mualimeve të

Bashkësisë Islame të Kosovës, kurse gjatë vitit 2022, do të mbahen edhe trajnime të tjera me këto grupe, në fushën e mësim-besimit.

Dua e hatmes në Podujevë

Departamenti i Gruas pranë KBI-së në Podujevë organizoi dua të hatmes, me rastin e përfundimit të leximit të Kuranit nga 38 nxënëse.

Ky program nisi me lexim Kurani nga nxënësjja Arlinda Potera, e më pas të pranishmeve iu drejtua me një fjalë përshëndetëse dhe urimi mësuesja Sala Mehmeti-Hajdari.

30 nxënëse ishin prezentë në ceremoni, ndërsa tetë të tjera u bashkëngjitën këtij programi në mënyrë virtuale. Në këtë organizim mori pjesë edhe përfaqësuesja e Departamentit të Gruas pranë Bashkësisë Islame në Prishtinë, znj. Florentina Tërmkollli.

Tërmkollli pasi përshëndeti dhe uroi nxënëset, para të pranishmeve mbajti një ligjëratë mjaft të dobishme.



Pas përfundimit të ceremonisë, ku u mbajt edhe një koktej rasti, u bë edhe shpërndarja e certifikatave për nxënëset që kanë përfunduar hatmen.

Përmbyllja e programit u bë me duan e hatmes nga mësuesja Sala Mehmeti-Hajdari.

Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi ndërmjet Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame dhe Institutit Albanologjik

Më 29 dhjetor, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame në Prishtinë dhe Instituti Albanologjik, kanë nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit, me ç'rast prof. Sabri ef. Bajgora, drejtor i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame si dhe prof. dr. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik e vlerësuan lart këtë Memorandum, i cili do t'u shërbejë dy institucioneve në fushëveprimin e bashkëpunimit të ndërsjellë për realizimin e interesave të dyanshme në fushën kërkimore dhe shkencore. "Ne do të bashkëpunojmë në shumë fusha e sidomos në fushën e letërsisë dhe në fokus të përbashkët do ta kemi trajtimin e trashëgimisë shpirtërore te shqiptarët, sidomos të periudhës së Alamiados apo poezisë së Bejtexhinjve dhe jam shumë i lumtur që ky është memorandum i parë që po nënshkruhet nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame me një Institut tjetër simotër" - tha drejtori Bajgora, i cili njëherësh falënderoi



drejtorin Matoshi për ndihmën dhe gatishmërinë e tij në këtë bashkëpunim, por edhe ndihmesën e tij gjatë periudhës së themelimit të IHISI-së.

Nga ana e tij, prof. dr. Hysen Matoshi drejtor i Institutit Albanologjik theksoi se themelimi i këtij Instituti e begaton skenën shkencore dhe e pasuron një formë të munguar të studimeve në vendin tonë. Besoj se ne, bashkërisht, do të realizojmë projekte me interes të përbashkët për kulturën shqiptare,

e pse jo edhe në sferën e trashëgimisë islame në Kosovë" - tha drejtori Matoshi.

Dy institucionet pajtohen që të bashkëpunojnë për krijimin e një këshilli koordinues për bashkërendimin e punës kërkimore dhe shkencore. Po ashtu, në këtë fushë të veprimit, do të botohen dokumente dhe punime të veçanta nga fushat e interesit të përbashkët në gjuhë, histori, letërsi dhe trashëgimi shpirtërore. (R.S.)

Kuvendi i BIK-ut miratoi projektbuxhetin e Kryesisë për vitin 2022

Më 30 dhjetor, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt, të cilën e kryesoi kryetari i Kuvendit të BIK-ut, dr. Ajni Sinani. Mbledhja filloi me leximin e një pjese nga Kurani, të cilën e lexoi anëtari Artan ef. Zekaj. Më pas, dr. Ajni Sinani, kryetar i Kuvendit, iu shprehu mirëseardhje anëtarëve të Kuvendit, duke i falënderuar ata për punën dhe angazhimin e tyre.

Më pas, një fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili fillimisht e luti Zotin për shëndet e mirëqenie për të gjithë, si dhe për vullnet e kurajë në kapërcimin sa më të lehtë të kësaj pandemie me të cilën jemi duke u ballafaquar. Ai më pas kërkoi nga të pranishmit që të këndojnë nga një Fatiha për shpirtin e ish-myftiut të Kosovës, dr. Rexhep ef. Bojës, i cili u nda nga kjo botë dhe luti Zotin që ta shpërblejë me xhenet për punën dhe aktivitetin e tij dhënë si në institucionet e BIK-ut ashtu edhe në përfaqësimin e Kosovës si ambasador në Riad. Ai po ashtu falënderoi të gjithë nëpunësit e BIK-ut anekënd Kosovës, të cilët janë duke dhënë një kontribut në mbarëvajtjen e jetës fetaro-arsimore dhe janë duke u ballafaquar me sfida të ndryshme në terren.

Ai më tutje shtoi se situata me pandeminë Covid-19 ka bërë që të imponohen disa gjëra dhe të bëhet një riorganizim, në mënyrë që t'u përshtatemi rrethanave të reja, duke marrë kështu vendime jo fort të këndshme për jetën fetare, por që falë Zotit po e përballojmë këtë situatë të rëndë. Myftiu Tërnavë e vlerësoi gjendjen e përgjithshme si të qetë dhe stabile, falë imamëve dhe administratës së këshillave anekënd Kosovës për kontributin që janë duke dhënë për organizimin



e jetës edukativo-fetare në Kosovë. Po ashtu, ai vlerësoi lart edhe kontributin e kuvendarëve dhe njëherazi kërkoi nga ta që edhe më tutje të japin kontributin e tyre për avancimin dhe shtyrjen e proceseve përpara, kështu që amanetin që e kemi mbi supet tona ta çojmë në vend.

Myftiu Tërnavë tha se duhet ta ngremë përgjegjësinë që kemi para Zotit për jetën fetare dhe dobësitë që i kemi duhet t'i eliminojmë. Ai kërkoi nga kuvendarët që të japin kontribut brenda Këshillit ku jetojnë e veprojnë dhe në ato xhami që nuk kryhen – falen pesë kohë namaz të fillojnë sa më shpejtë si dhe t'i kushtohet një rëndësi e

veçantë edukimi dhe arsimit fetar të nxënësve. Pandemia me Covid-19 na ka dezorientuar pak, po ne si Kryesi nuk kemi ndenjur duarkryq kemi vizituar këshillat, kemi zhvilluar takime dhe tubime aq sa na është lejuar me protokoll të pandemisë. Gjendja është shumë më e mirë se çka qenë dhe kjo na gëzon të gjithëve, por kemi shumë detyra dhe punë para vetës. Një punë të shkëlqyer janë duke zhvilluar edhe mualimet anekënd Kosovës dhe po bëjnë një aktivitet të mrekullueshëm në terren.

Ai duke folur për aktivitetet e BIK-ut tha se BIK është lider në organizimin e konferencave dhe sesioneve shkencore, por edhe në



botë po përfaqësohemi mirë dhe vazhdojmë edhe më tej dhe me faktorin ndërkombëtar të kemi raporte shumë të mira dhe ne vazhdimisht luftojmë ekstremizmin, fundamentalizmin dhe indoktrinimin e dukuritë e tjera negative për shoqërinë dhe këto t'i përcillni nëpër këshillat tuaj në komuna, dhe kjo është edhe obligim fetar të luftohet e keqja. Ai nuk la pa përmendur edhe xhematin i cili vazhdimisht ka përkrahur dhe mbështetur BIK-un dhe është shumë dorëdhënës duke e ndihmuar dhe ne po përpiqemi që vazhdimisht të përmirësojmë infrastrukturën e BIK-ut.

Një falënderim të veçantë Myftiu Tërnavë ka bërë për kuvendet komunale dhe qeveritë qendrore dhe institucionet e tjera, duke e cilësuar bashkëpunimin dhe respektin si shumë të veçantë, ngase edhe jemi institucion i besueshëm dhe nga ne kërkohet që t'i zhvillojmë edhe më shumë këto marrëdhënie bashkëpunimi mes organeve komunale dhe qeverisë sonë në të mirë të qytetarëve dhe xhematit tonë.

Myftiu Tërnavë njoftoi kuvendarët që kanë përfunduar shumë projekte infrastrukturore, e disa të tjera janë ende në fazën finale të realizimit, e me këto lehtësohet edhe më shumë jeta dhe aktivitetet fetare. "Falënderojmë Zotin që punët janë duke ecur mbarë e mirë. Ne shprehim falënderime edhe për donatoren, të cilët vazhdimisht nuk ngurrojnë që të na ndihmojnë

me projekte në të mirë të qytetarëve tanë. BIK-u do të vazhdojë në ngritjen infrastrukturore të këshillave të BI-së së Kosovës edhe në të ardhmen" – u shpreh Myftiu Tërnavë.

Theks të veçantë në këtë fjalim, Myftiu Tërnavë i kushtoi edhe aktivitetit të Shoqatës Humanitare "Bereqeti", e cila tanimë është numër një në Kosovë për aktivitetet e saj humanitare në vend, rajon, por edhe në kontinente e tjera dhe falënderojmë edhe donatorët të cilët ofrojnë nga pasuria e tij dhe ia besojnë shoqatës "Bereqeti" që kjo ndihmë të shkojë drejt e në dorën e sigurt të nevojtarët.

Mbledhja më pas vazhdoi me pikat e rendit të ditës, e që ndër to ishte edhe shqyrtimi dhe miratimi i projektbuxhetit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin 2022. Projektbuxhetin para anëtarëve të Kuvendit të BIK-ut e paraqiti drejtori i Financave dr. Islam Hasani, i cili arsyetoi dhe sqaroi këtë projektbuxhet për vitin e ardhshëm. Pas shqyrtimit, Kuvendi i BIK-ut, në mënyrë unanime miratoi buxhetin e Kryesisë për vitin 2022. Në këtë mbledhje u shtruan edhe lëndë të tjera dhe u morën vendime nga kompetencat e Kuvendit.

Krejt në fund, edhe njëherë u përçua mesazhi që imamët dhe të gjithë nëpunësit fetarë të kontribuojnë në respektimin e masave parandaluese të përhapjes së pandemisë Covid-19. (R.S.)

Departamenti i Gruas së BIK-ut organizon një sërë trajnimesh në fushën e mësim besimit

Të hënën, me 06.12.2021, filloi trajnimi për mualimet e inkuadruara në fushën e mësim besimit në xhamitë e vendit. Në grupin e parë në këtë trajnim, prezentuan 34 mualime nga rajoni i Prishtinës. Edhe në grupin e dytë, gjatë trajnimit që u mbajt të enjtën, me 09.12.2021, prezentuan afër 30 mualime nga disa rajone të Kosovës. Trajnimi me grupin e tretë, do të mbahet me 27.12.2021, e hënë.

Këto trajnime, të planifikuara nga Departamenti i Gruas pran BIK, dhe të zhvilluara nga trajneri, z. Bashkim Mehani, kanë për qëllim unifikimin e vizionit të veprimtarisë së mualimeve që mbajnë mësim me nxënës dhe ligjërata me gra, si dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre organizative dhe të mësimdhënies në këtë fushë.

Pjesmarrëset e të dy grupeve, janë ndarë të kënaqura me këtë aktivitet. Ato, po ashtu kanë dhënë kontributin e tyre përmes punës në grupe, për avancimin e mësim besimit, duke trajtuar mundësitë dhe mangësitë që kanë hasur në punën e tyre me përvojë disa vjeçare.

Trajnimi synon t'i përfshijë të gjitha mualimet e vendit, dhe do të mbahet në disa module edhe përgjatë vitit vijues.



Dua hatmeje në Prishtinë

Më 27 nëntor, 11 nxënëse të cilat ndoqën mësimet në Këshillin e BI-së së Prishtinës, përfunduan me sukses leximin e Kuranit. Me këtë rast u mbajt duaja e hatmes dhe një program festiv në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Ky program u organizua nga mualimja Kadrije Dragusha-Ademi, e cila falënderoi të pranishmet për prezencën dhe i uroi nxënëset e saj për suksesin e arritur. "Gjëja më e mirë me të cilën njeriu e përmend dhe e kujton Allahun, është leximi i Kuranit, ngase fjalët e Allahut janë fjalët më të mira, më të bukura, më të vërteta dhe më të dobishme. Kurani është Libri më i mirë që ka zbritur tek i Dërguari më i mirë, Muhamedi a.s.", tha tutje Dragusha-Ademi në falimin drejtuar të pranishmeve.



E pranishme në këtë organizim ishte edhe përfaqësuesja e Departamentit të Gruas në BI, znj. Florentina Tërmkollli, e cila mes tjerash porositi të pranishmet që mësimet e Kuranit t'i ndjekin në vazhdimësi dhe mos të ndalen asnjëherë. Është e rëndësishme të ceket se në mesin e nxënëseve ishte

edhe një 76 vjeçare e cila përfundoi me sukses leximin e Kuranit.

Programi ishte i pasur edhe me ilahi. E krejt në fund nxënëset u pajisën me certifikata dhe nga një dhuratë modeste nga libraria "Dituria Islame" Kujtojmë që kjo është hatmja e tretë që mësuesja Kadrije Dragusha-Ademi organizoi me grupet e nxënëseve për këtë vit.

Dua hatmeje në Kovaçec dhe në Kaçanik

Më 28 nëntor, me rastin e përfundimit të leximit të Kuranit nga 12 nxënëse, u organizua dua hatmeje në xhaminë "Fuat Bey" në fshatin Kovaçec të Kaçanikut.

Programi u hap me lexim Kurani nga teologe Blertona Kriva, më pas fjalën hyrëse mori nikoqirja e kësaj xhamie znj. Bardha Kqiku-Luma, e cila u përkujdes që këto nxënëse të mësojnë leximin e Kuranit. Kqiku-Luma në fjalën e saj falënderoi të pranishmet dhe uroi lexueset e Kuranit me shpresë se ky lexim do t'i përcjell gjatë gjithë jetës. Më pas teologe Merita Leka - Ceka përshëndeti të pranishmet dhe falënderoi teologen në fjalë për punën që po bënë nëpër xhami, si dhe i uroi ato që përfunduan leximin e Kuranit, me lutjet që Zoti t'u japë begati dhe të mira në këtë dhe botën tjetër. Programi ishte i pasur edhe me ilahi, pjesë nga Kurani i Madhërisëm dhe



në fund u bë duaja e hatmes nga teologe Qamile Musliu-Malsiu. Një befasi e këndshme e kësaj ceremonie ishte edhe vendosja e mbulesës nga njëra prej nxënëseve të kësaj xhamie. Për suksesin e arritur të gjitha nxënëset morën certifikata nga KBI e Kaçanikut.

Po ashtu edhe në xhaminë "Gazi Sinan Pasha" në Kaçanik, 24 nxënëse që ndoqën mësimet përfunduan me sukses leximin e Kuranit dhe me këtë rast në këtë xhami u organizua dua e hatmes dhe një program festiv. Hapjen e programit e bëri mësuesja Ajnure Topojani e cila foli për vlerën

e leximit të Kuranit. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe udhëheqësja e Departamentit të Gruas në BIK, znj. Vaxhide Bunjaku, e cila mes të tjerash tha: "Kurani është udhërrëfyes i myslimanit, që leximi i tij na i ngjall zemrat në mënyrë që të bëhemi njerëz sa më të ndërgjegjshëm dhe edukues". Programi ishte i pasur edhe me pika artistike, ku u kënduan Kuran dhe ilahi nga Blertona Kriva, si dhe u lexuan disa hadithe për vlerën e Kuranit nga disa nxënëse. E për suksesin e arritur, nxënëset u pajisën me nga një certifikatë.

Telegram ngushëllimi

6 dhjetor 2021

I pikëlluar për lajmin e vdekjes së mikut të madh të Kosovës, senatorit Bob Dole.

I pikëlluar për lajmin e vdekjes së mikut të madh të Kosovës dhe popullit tonë, senatorit Bob Dole, i cili për tri dekada mbështeti fuqishëm përpjekjet tona drejt lirisë e pavarësisë.

Senatori Bob Dole, në fund të viteve '80, e në fillim të viteve '90, për popullin e Kosovës, ishte shndërruar në shpresë për drejtësi, liri e dinjitet, mision të cilin senatori e vazhdoi edhe pas lirisë dhe themelimit të shtetit tonë të lirë e demokratik.

Senatori Dole paska kaluar në amshim, mirëpo populli ynë do e kujtojë me pietet dhe do ta njoh kontributin historik, si trashëgimi të çmueshme për lirinë dhe mëvetësinë e vendit tonë.

*Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnav*

Reagim

26 nëntor 2021

Kemi mbetë të trishtuar dhe të tmerruar nga akti i sotëm në Deçan, ku nga sulmi kriminal mbi autobusin mbetën të vrarë tre persona, dy prej tyre nxënës që ktheheshin nga shkolla.

Dënojmë aktin kriminal, sepse autorët e tij s'kanë din e as iman. Vetëm të tillët shtijnë mbi të pafajshmit.

Lusim Zotin që viktimat t'i marrë në mëshirën e Tij, familjeve të tyre t'u japë sabër e gajret që ta përballojnë më lehtë dhimbjen dhe mërzinë, ndërsa të plagosurve shërim të shpejtë!

Duke ngushëlluar familjet dhe tërë popullin e Kosovës, ndajmë dhembjen dhe jemi shpirtërisht me ta.

Lusim Zotin që mos të sprovo-hemi më me akte të tilla!

*Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnav*

Telegram ngushëllimi

6 dhjetor 2021

Me dhembje mora lajmin për kalimin në Ahiret të Sabit Zejnullahut, babait të heroit Hakif Zejnullahu

Baca Sabit gjatë gjithë jetës së tij qe një burrë i respektuar me virtyte të larta që shquhej për guxim, sakrificë e atdhedashuri.

Rahmetliu qe një mësues i përkushtuar për brezat e rinj se si duhet ta duam e të veprojmë për atdheun.

Do ta kujtojmë me respekt si një njeri krenar e fisnik me kontribute për lirinë e vendit.

Ngushëllime familjes Zejnullahu!
Zoti e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!

*Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnav*



Mesazh urimi për ipeshkvin Dodë Gjergji

I nderuari ipeshkëv, Dodë Gjergji
Me rastin e festës së Kërshëndellave, me respekt të veçantë kam nderin t'ju dërgoj këtë mesazh urimi Juve, meshtarëve tuaj, si dhe të gjithë vëllezërve të krishterë duke ju dëshiruar në këtë festë më të mirat për ju, e para së gjithash shëndet, mbarësi e lumturi.

Vlerat dhe mësimet hyjnore s'ka dyshim se janë rruga më e mirë për formimin, edukimin dhe fisnikërimin shoqërisë.

Kërshëndella, është moment i veçantë që simbolizon e përkujton lindjen dhe jetën. Kjo festë sipas parimeve kristiane përçon në mënyrën më të mirë mesazhin për ndërtimin e shoqërisë së shëndosh e humane.

Zotni ipeshkëv, festat fetare te ne gjithherë kanë qenë momente që na kanë bashkuar në të mirë, nga të cilat kemi mësuar e kultivuar tolerancën, harmoninë, ndërgjegjësimin për paqen e respektin e dashurinë për tjetrin. Këto vlera e mësimet më së miri dolën në pah edhe në përballje me COVID-19, një ndër sfidat më të rënda me të cilat po përballlet njerëzimi në këto dy vite.


Zotni ipeshkëv, nëpërmjet jush, uroj e përgëzoj edhe të gjithë praninë ndërkombëtare katolike në Kosovë.

Duke ju përshëndetur, edhe njëherë Ju dëshiroj shëndet, mbarësi e lumturi.

Gëzuar e paçi harmoni e gëzime në familjet tuaja!

Prishtinë, 24 dhjetor 2021

*Me respekt,
Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnav*



"A nuk e ke parë, se si
Allahu i drejton retë, pastaj i
bashkon, i bën grumbull ato,
edhe atëherë e sheh shiun se si
rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti
nga retë e mëdha si kodra breshër
dhe me të godit këdo, e ia largon atij
që do. Shkëlqimi i vetëtimës së
dritës së resë gati
sa s'ta merr shikimin."

(En-Nur, 43)